ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 11 SHTATOR 2021. NUMËR 147 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Dokumenti është botuar që më 1915 nga dy bizantinistë të njohur, siç shihet edhe nga kopertina: Révérend Père Louis Petit, augustinian, i cili më vonë do të emërohej arqipeshkëv katolik në Athinë, dhe Vladimir Karabljov [Владимир Кораблёв], ndërsa revista është ajo e studimeve bizantine ruse që ende sot e kësaj dite vijon të botohet. Duhet shtuar se këta të dy, në botimin e *Acta*-ve të manastireve në malit Atos, kanë shfrytëzuar shënimet e hollësishme që kishte marrë peshkopi rus Porfiri Uspenskij [Порфирий Успенский] (1804-1885) kur pati vizituar malin Atos si shtegtar dhe hulumtues, përfshi edhe këtë letër. Meqë ra fjala, është po ky peshkop i cili në shënimet e tij flet edhe për Jan Kukuzelin dhe partiturat e këtij muzikanti durrsak që ruhen në Malin e Shenjtë Atos.



ВЫЗАНТІНА ХРОНІКА
ПАРАРТНМА ТОУ ІѲ' ТОМОУ.
ВИЗАНТІЙСКІЙ ВРЕМЕННИКЪ
Приложеніе къ XIX тому.
№ 1.

ACTES DE L'ATHOS.

V.

ACTES

DE

CHILANDAR

PUBLIÉS

PAR

LE R. P. LOUIS PETIT ET B. KORABLEV.

des Augustins de l'Assomption.

ПЕТРОГРАДЪ.
ТИПОГРАФІЯ ИМПЕРАТОРСКОЙ АКАДЕМІИ НАУКЪ.
Вас. Остр., 9 лин., № 12.
1915.

GJON KASTRIOTI NË ARKIVAT E MURGJVE SERBË

Nga Arben Ndreca

DALLIMET KULTURORE, NJË SFIDË E VËRTETË NË PROCESIN E PËRKTHIMIT

Nga Iljaz Spahiu (fq.8)

Angazhimi im në fushën e përkthimit të letërsisë kineze zë fill në vitin 2012, vit kur fitues i çmimit "Nobel" për letërsinë u shpall shkrimtari kinez Mo Yan. Mes dyshimit dhe pasigurisë së fillimit, por edhe inkurajimit të kolegëve shqiptarë e kinezë, sprova e parë, përkthimi i romanit "Bretkosa" u kalua me sukses...

MISTIKA E ËNDRRËS NË LIRIKËN E FATOS ARAPIT

(fq. 7)

Nga Alisa Velaj

Në opusin poetik të Fatos Arapit gjenden disa lirika kulmore, të cilat i bashkon me njëra-tjetrën **motivi i ëndrrës**. Të shkruara në kohë të ndryshme dhe të dala në dritë në vëllime të ndryshme, po të renditen sipas kohës së botimit, këto lirika ...

SHËNIME PËR LIBRAT

"INFINITI BLU", NJË ROMAN SHKENCOR JO VETËM PËR RININË

(fq. 10)

Prof. Dr. Alfred Çapaliku

"PO SHKON ME BUITË TE ZOJA", PARARENDËSJA E "ANDRRËS SË JETËS"

Nga Mentor Quku (fq. 4)

Është i njohur fakti se Mjeda, duke ndjekur shembullin e Horacit, para se ta botonte një poezi, e mbante diku të fshehur për disa vjet, pastaj e shihte, rishkruante herë pas here deri kur arrinte në versionin përfundimtar...

PYETËSORI "LIBRAT E JETËS SIME"

BASHKIM HOXHA:

Libri që mendoj se është i nënvlerësuar? Veçanërisht librat e autorëve shqiptarë

(fq. 11)

DOSTOJEVSKI "ANA KARENINA" SI FAKT I NJË RËNDËSIE TË VEÇANTË

(fq.22)

BIBLIOTEKË

Ismail Kadare (fq. 16)
Kushëriri i engjëjve

Niko Kacalidha (fq. 15)
Ëndërrtari i natës

Roy Jacobsen (fq. 20)
Një dritare e re

Clarence Day (fq. 21)
Babai kërkon të qepë një komçë

W. Somerset Maugham (fq. 21)
Takimi në Samarra

Klara Kodra (fq. 11)
Mendime fluturuese

Rexhep Ferri (fq. 12)
Renesanca e zezë

Qazim Shehu (fq. 13)
Nga kronika e një gazete

GJON KASTRIOTI NË ARKIVAT E MURGJVE SERBË

Nga Arben Ndreca

Në këto pak më shumë se njëqind vjet pavarësi padyshim që shqiptarët kanë bërë shumë për ndërgjegjen e tyre kombëtare. Pavarësisht nga sukseset e arritura deri tashti në arsim, kulturë dhe shkencë, duhet të pranojmë se kemi mangësi që tashmë mund të quhen të pafalshme në organizimin e bashkërenditjen e studimeve historike.

Kjo nuk do të thotë se përgjatë këtij shekulli pavarësi nuk kemi pasur studime apo studjues të censhëm. Kontributi i tyre është i pakundërshtueshëm dhe vlerësohet, por mungesa e bashkërendimit të punës, të përvojave, të hulumtimeve, të studimeve të të gjithëve ka bërë që në historinë tonë të ketë boshllëqe të mëdha. Këtyre iu duhen shtuar mandej mistifikatorët, denigruesit si edhe të ekzaltuarit që servirin variantin e tyre të historisë shqiptare.

Një rast i bujshëm që flet qartë për mangësitë e bashkërendimit të studimeve tona historike por edhe për pasionin e spekullatorëve, është ai i zanafillës së Gjergj Kastriotit, ose më saktësisht i të et, Gjonit.

Letra që po paraqesim më poshtë, e vitit 1426 dhe që ruhet në Hilandar, është një dokument i stërnjohur për bizantinistët e mbarë Europës por siç u pa edhe gjatë vitit të Skënderbeut, aspak i njohur në Shqipëri. Fatkeqësisht, atë nuk e njihnin as historianët e huaj që bujarisht japin kontributin e tyre për çështjet e historisë shqiptare!

Dokumenti është një dëshmi nëpërmjet së cilës Gjon Kastrioti dhe të bijtë, Stanishi, Konstandini, Reposhi dhe Gjergji i dhurojnë manastirit serb të Hilandarit dy fshatrat, Radostushë dhe Trebishte, bashkë me kishën e Shën Mërisë të fshatit të parë si edhe të ardhurat e këtyre. Në letër tërheq vëmendjen modestia e Gjon Kastriotit kur thotë se i dhuruan manastirit të Hilandarit «aq sa qe fuqia jonë» dhe «shumë i dashuri Zot dhe e Papërlyera Nëna e Zotit i pranoftë këto dhurata tona të vogla, ashtu sikurse monedhën e vogël të vejushës» (Mk. 12, 42-44).

Letrën nuk e ka shkruar Gjoni por logoteti i tij, siç del në rreshtin e parafundit: «Mbasi e shkrova e nënshkrova me vulën e zakonshme të zotëri Gjonit [Ivanit]». Për më tepër, përkthimin dhe shpjegimin gjerë e gjatë të kësaj letre si edhe të disa të tjerave të Kastriotëve lexuesi do ta gjejë të plotë tek revista Shejzat-Pleiades[1].

Letra në fjalë përfundon me një fjali, e cila, e vetme, na tregon shumë. Të gjithë ata që kanë studjuar sadopak rusisht në Shqipërinë e dikurshme do të jenë krejtësisht në gjendje ta kuptojnë atë:

Милостію божіею іоаннь
кастріоть господинь албанскіи.

Shqip mund ta përkthejmë kështu: «Falë hirit të Zotit, Gjon Kastrioti zot arbëror.»

Historiani Dushan Sindik[2] mendon se ky rresht, i cili ne na duket pjesë integrale e letrës, është shtuar më vonë, rreth viteve 1440, nga murgu Nikandër.

Dokumenti është botuar që në 1915 nga dy bizantinistë të njohur, siç shihet edhe nga koopertina: Révérend Père Louis Petit, augustinian, i cili më vonë do të emërohej arqipeshkëv katolik në Athinë dhe Vladimir Karabljov [Владимир Кораблёв], ndërsa revista, është ajo e studimeve bizantine ruse që ende sot e kësaj dite vijon të botohet. Duhet shtuar se këta të dy, në botimin e *Acta*-ve të manastireve në Malit Atos, kanë shfrytëzuar shënimet e hollësishme që kishte marrë peshkopi rus Porfiri Uspenskij [Порфирий Успенский] (1804-1885) kur pati vizituar Malin Atos si shtegtar dhe hulumtues, përfshi edhe këtë letër. Meqë ra fjala, është po ky peshkop i cili, në shënimet e tij flet edhe për Jan Kukuzelin dhe partiturat e këtij muzikanti durrsak që ruhen në Malin e Shenjtë Atos.

Siç e tregon qartë edhe ky botim më se njëqindvjeçar, nga ana e filologëve të vërtetë, të çfarëdolloj kombësie, nuk ka asnjë manipulim. Mungesat janë të dukshme vetëm në



ΒΥΖΑΝΤΙΝΑ ΧΡΟΝΙΚΑ
ΠΑΡΑΡΤΗΜΑ ΤΟΥ ΙΘ' ΤΟΜΟΥ.
ВИЗАНТІЙСКІЙ ВРЕМЕННИКЪ
Приложеніе къ XIX тому.
№ 1.

ACTES DE L'ATHOS.

V.

ACTES

DE

CHILANDAR

PUBLIÉS

PAR

LE R. P. LOUIS PETIT ET B. KORABLEV.

des Augustins de l'Assomption.

ПЕТРОГРАДЪ.
ТИПОГРАФІЯ ИМПЕРАТОРСКОЙ АКАДЕМІИ НАУКЪ.
Вас. Остр., 9 лин., № 12.
1915.

1 Ndreca Arben, «Disa dokumente rreth Gjon dhe Gjergj Kastriotit në sllavishten e vjetër. Pjesa II», tek *Shejzat-Pleiades*, series nova, nr. 1-2, 2019, 47-69.
2 Po aty.

anën tonë. Sa për të tjerët, që i kanë pasur në dorë këto dokumente dhe nuk janë shprehur publikisht rreth kombësisë së Kastriotëve mund të themi se nuk është përgjegjësi e tyre të merren me historinë tonë.

Kjo është vetëm një letër e Gjon Kastriotit nga arkivi i murgjëve serbë në Hilandar, por ndër dokumentet e Hilandarit përsëritet plot tri herë se Gjon Kastrioti është arbër[3].

Në këto njëqind e ca vjet pavarësi duhej të ishte gjendur mënyra e një studjues shqiptar duhej të kishte shkuar deri në Malin Atos për ta parë nga afër këtë dokument e të tjerë!

Ndërkaq, dokumente të tjera presin të lexohen, të studjohen, të shqyrtohen imtësisht në arkivat e Raguzës [Dubrovnikut], Venedikut, Zarës, Shibenikut, Istries, Pulës, Stambollit, sa për të përmendur disa sish, e këtyre iu duhen shtuar arkivat e rregullave të ndryshme si ato të benediktinëve, të dominikanëve, të françeskanëve, të jezuitëve, të bazilianëve duke përfunduar tek arkivat private.

Që të hulumtohet nëpër këto arkiva ka nevojë për një grup të gjerë studjuesish duke filluar që nga niveli universitar, të pajisur me kulturë të gjerë greko-latino-sllave e duke i shtuar këtyre edhe atë osmane; duhet të jenë të pajisur me metoda hulumtimi shkencore; duhet të njohin jo thjeshtë gjuhët e vdekura e të gjalla por edhe paleografinë, epigrafinë, etnografinë, antropologjinë e disiplina të tjera. Këto studime duhet të gjejnë pastaj një tribunë të tyren edhe tek një revistë shkencore studimesh mesjetare. Duhet themeluar edhe një *database* me të dhënat kryesore të studimeve tona në mënyrë që të ketë bashkërendim të punës. Duhet që studentëve tanë t'iu krijohet mundësia të debutojnë me punime diplomash rreth këtyre temave.

Në fund, nuk duhet të mungojë as mbështetja financiare për universitetet sepse kërkimi shkencor kërkon punë dhe vijimësi në kohë.

Epoka që po përjetojmë na i kërkon me ngulm këto ndryshime e përmirësime tepër të nevojshme në programet tona universitare dhe akademike. Në këtë vorbull të madhe të globalizimit ku mungon orientimi dhe përvoja – sepse asnjë vend nuk e ka përjetuar më parë këtë gjendje – edhe ne kemi nevojë ta njohim më imtësisht e me kthjelltësi individualitetin tonë historik. Atëherë do të jemi në gjendje për dialog me këdo e çfarëdo sfide që e ardhmja mund të sjellë me ose pa paralajmërim në brigjet tona.

3 Po aty.

По неизрѣченномоу милосердію владики моего христа азь
грѣшни и недостоини не смѣю нарещисе рабь христа бога моего
ивань кастриѡть и сь сынови моими станишемь и рѣпошемь и
костандиномь и гюргиемь поревнова по господи бозѣ моиемь все-
дрьжителю и помощию прѣчистие владичице наше госпожде бого- 5
родице лаври хиландарские, сьвѣщавши сь сынови моими и прило-
жисмо светомоу монастироу елика соуть приема силѣ нашеи. а все-
благи богь и прѣчиста богомати да вьсь приметь сиа наша малаꙗ
приношениꙗ, ꙗкоже и вдовици ѡнои ·в· лептѣ. и приложихь село
радостоуше и сь црьквѡмь с прѣчистомь богородицомь, еже вь 10
томь селѣ радостоуши, и сь селомь трѣбищемь. и сико приложихь
тѣ ѡбѣ селѣ да соу слободни ѡдь всакихь работ малихь и великихь

81. Original aux archives de Chilandar. Copie de Porphyre Ouspensky. Рук. Хил.
Византійскій Временникъ. Томъ XIV. Прил. 36

81.

6934—1426.

Titre de donation de Jean Castriote d'Albanie et de ses fils.

— 562 —

сь всакѡм ними правинами, ѡсвѣние харача царева и града, а ино
все да иесть светомоу монастироу, ни да има над ними ѡбласти ни
15 кефалиꙗ, ни властникь, ни псарь, ни да имь е ни десетка ни жит-
нога, ни виннога, ни пчелнога, ни динар поклонних, ни травнине, ни
то-овнине, токмо да си црьква оузима все свое правине по законоу
сель тѣхь. и просто рещи да соу слободни ѡдь всѣхь моихь работь
малихь и великихь. и сие мое записание да прѣбиваеть тврьдо и
20 непоколѣбимо. и кого богь изволить по мнѣ намѣстникоу бити ми и
ѡбладати сиею землею или ѡть сыновь моихь или ѡдь соуродникь
моихь, или кого богь изволить, и дрьзнеть и разорить сие мое
записание, еже приложихь прѣчистѣи владичици нашеи госпожди
богородици хиландарьскои, таковагѡ да разорить его господь богь в
25 си вѣкь и вь боудоуши и приложить его сь юдою прѣдателемь. и
да наслѣдить проказоу гиезиевоу и да иесть проклеть ѡть ·тиі·
ѡтьць богоносних. и да ꙗ побие сила чьстьнаго и животворещаго
крьста и да моу иесть соуперница прѣчистаа богородица на страш-
номь испитани. и да иесть проклет и трьклет. аминь. писасе сие за-
30 писание вь лѣто ·҂ѕцлд·

Писахь подписахь ѡбичномь печатѡмь господина ивана.

Милостію божіею іоаннь кастріоть господинь албанскіи.

Në veprën e tij studimore, Mentor Quku merret me çdo aspekt të jetës dhe veprës së dom Ndre Mjedës, duke u ndalur herë pas here në ripunimet e shumta që ai i bënte poezive të veta para se t'i botonte. Disa nga ata shembuj, vendosur në kontesktin e mjedologjisë, studimeve mbi Mjedën, po i botojmë në vijim.

MENTOR QUKU: "PO SHKON ME BUTË TE ZOJA", PARARENDËSJA E "ANDRRËS SË JETËS"

Sikurse bleta prej epshi të vet tuj i hjedhë andej e këndej, nuk ndalet në pleh e në paltë, por kërkon lulishtet, nuk ulet mbo çdo bar, por kërkon lulet: lismen, sherbelën e tjera bimë erëkandshme, ashtu poeti, tuj injorue me sy këtë lulishten e botës nuk do të nguli në sende të përçudshme as s'do të shëmbëllejë zgaqin e shoqënisë, por do të zgjedhi sendet ma të bukura, ma të ndershme, ma të shieshme, por edhe që ma fort përkojnë me arsye e këto do të shfaqi në vjershi të vet; ashtu edhe me shpejti të mendes me u hjedhë në të tana anët, me rrnue gjithshka, me mbledhë, me gjetë shka mund të vëiej në çdo rasë, e, prej gjithë aso sendesh me përftue në mende të vet ndonji hartim të ri: kjo asht puna e poetit.[1]

Është i njohur fakti se Mjeda, duke ndjekur shembullin e Horacit, para se ta botonte një poezi, e mbante diku të fshehur për disa vjet, pastaj e shihte, rishkruante herë pas here deri kur arrinte në versionin përfundimtar, që sipas tij ishte i gatshëm për t'iu paraqitur lexuesit, gjithnjë duke e përdor shqipen e palavruet si t'ishte tue shkrue latinisht. E shqipja i gjegji tue shkëlqye në vargje të tija me të çmueshmen dritë kristalore qi kudo lëshon klasicizmi i kulluet.

Në monografinë prej dhjetë vëllimesh për të, Mentor Quku ndalet herë pas here pikërisht në pararendëset e poezive të Mjedës ashtu sikurse njihen sot, veçanërisht të atyre poezive që përbëjnë vëllimin "Juvenilja". Duke qenë se kjo vepër është botuar e ribotuar disa herë, ne do të bazohemi në botimin e vitit 1927, shtypur në "Gj. N. Vernay", Vienë, risjellë në një botim anastatik në vitin 2017 nga shtëpia botuese "Gjergj Fishta", Lezhë.

Përgatitjen për botim të këtij shkrimi bashkë me shënimet dhe sqarimet e herëpashershme si dhe faksimilet e revistës "Nëntori" ku për herë të parë trajtohet çështja që ne po shqyrtojmë i realizoi **ANDREAS DUSHI**. Përveç citimeve në footnote, çdo pjesë përbërëse e këtij shkrimi është marrë nga monografia dhjetëvëllimshme "Mjeda".

Rasti i parë është ai i kryeveprës së Mjedës, "Andrra e jetës". Quku ndalet gjerë e gjatë në rastin e poemës më të famshme të autorit duke treguar mes të tjerash se ajo kishte një pararendëse, ku personazhi i Tringës është djalë, i quajtur Zef.

1 Ndre Mjeda, "Përmi poezi përgjithësisht", Vepra letrare 2, sh. b. "Naim Frashëri", Tiranë, 1988, fq. 114 – 115.

"Po shkon me bujtë te Zoja", gjendet në fletoren e poezive të AQSH me datën e hartimit: 1890. Ashtu si të tjerat, është bartur në atë fletore nga Mjeda rreth vitit 1902 - 1903, variant i cili është më i hershmi që ne njohim. Edhe kjo poezi, rreth 13 vjet nga datat e hartimit e deri tek ajo e bartjes, sipas zakonit të Mjedës, duhet të kenë njohur disa përpunime të cilat ne sot nuk i njohim. Ne njohim vetëm përpunimin që Mjeda i bëri kësaj poezie në vitin 1904, ku përveç alfabetit, ka ndryshuar edhe emrin e personazhit kryesor, Zefit, duke e bërë Trinka, perzonazh kryesor tek "Andrra e jetës". Ne po i paraqesim të dy variantet në plan krahasues. Në variantin e parë, Mjeda ka përdorë, ashtu si edhe në rastet e tjera, fjalë të huaja, si: adet - zakon. Poezia ka katër strofa katërshe, ku e treta strofë ka pothuaj përpunim të plotë. Poezia është shkruar me vargje shtatërrokëshe dhe përmban një fuqi të jashtëzakonshme.

Kjo poezi u përshkrua dhe u botua në mënyrë kritike, së pari nga Dhimitër Shuteriqi, në "Nëntori", me 29 janar 1963. U përshkrua edhe nga Mark Gurakuqi në gazetën "Mësuesi" më 8 shkurt 1963, duke bërë një përshkrim të shkurtër. Studiuesi tjetër, Rinush Idrizi, ish-student i Mark Gurakuqit, në monografinë e tij "Ndre Mjedja", vlerëson faktin se poezia "Po shkon me bujtë te Zoja" u përfshi më vonë në poemën "Andrra e jetës".

Mendoj se Mjeda është në të njëjtin nivel artistik, si kur harton "Po shkon me bujtë te Zoja", si kur ndërton kryeveprën "Andrra e jetës". Gjendja e tij ka ndryshuar herë pas here, por ndërgjegjja artistike e tij nuk ka njohur luhatje. Nëse ka pasur raste punimesh të dobëta dhe hamendjesh, Mjeda është tërhequr që në fillim. Kur nuk ka qenë i bindur në krijimet e tij, ai nuk ka vazhduar me përpunime e ndryshime. Në rastin e poezisë "Po shkon me bujtë te Zoja", Mjeda është treguar kërkues, duke e përpunuar atë herë mbas here sipas zakonit. Kjo vërehet jo vetëm në fletoren e vitit 1902 – 1903 - 1904, por edhe në faktin se, kur botoi "Andrrën e jetës", ai e përpunoi përsëri atë.

Mark Gurakuqi ka sqaruar talentin gjenial të Mjedës të shprehur në këtë poezi me 16 vargje: «Këtyre katër strofave të përkryeme në thjeshtësin e tyne s'mund t'u shtosh asgja, qoftë edhe nji fjalëzë. E as u heq dor gja"."Nuk e quaj të rastit censurimin e tërë pjesës së tretë, atë të Tringës, në botimin e Beogradit, pjesë e cila është poezia "Po shkon me bujtë te Zoja" (1890). Mund të themi se jo më kot kjo poezi mbeti pa u përfshirë në botimet e ndryshme të veprës poetike të Mjedës. Ajo u hoq në shumë botime të Mjedës, edhe kur bëhej fjalë për botimin e "Andrrës së jetës", në një kohë kur "Po shkon me bujtë te Zoja" kishte zënë vend si pjesë organike e saj.

Zbulimi i kësaj poezie të vogël nga përmasat, por të madhërishme nga arti i saj, na shtyn të mendojmë se Mjeda në Cremona ishte i karikuar me një pasion të fuqishëm që digjej brenda subtilitetit të shpirtit të tij. Ai, që në atë kohë, kishte plane për të hartuar një poemë me subjekt të përafërt me "Andrrën e jetës". Ndryshimet ndodhën, sepse varianti i parë u hartua kur Mjeda ishte në Cremona, ndërsa varianti i përpunuar u realizua kur ishte në Dajç të Zadrimës. Në variantin e përpunar kemi ndërrimin e emrit të personazhit nga Zef në Tringë: Mjeda realizon kështu treshen e famshme të femrave në një shtëpi fshati. Mjeda zëvendëson personazhin e xhakonit me priftin, gjë që reflektohet nga ndryshimi i gjendjes së vetë Mjedës. Nga xhakon në Cremona, në prift me veladon në Nënshat.

Pastaj kemi katundsat me malësorë, aq shumë sa nuk i zë shtëpia, realitet ky i fshatrave të Zadrimës ku jetonte Mjeda. Janë edhe dajat. Mos edhe këtu Mjeda reflekton nga që aty pranë, në fshatrat e Zadrimës, ka njerëzit e nënës?

Fabula është e njëjtë, por varianti i parë është i një poezie të vogël për jetimen që mbetet mbas vdekjes së Zefit, ndërsa varianti i dytë është hapi i parë i një poezie të rinisë, që do të përfshihet më vonë në "Andrra e jetës".



Varianti i dytë është pjesë integrale e poemës "Andrra e jetës". Kjo poezi përbën plotësisht pjesën e tretë, Tringa, me ndryshimin: në vend të vargut të parë të strofës së parë, *Nanë shka paska Tringa*, është vargu *Cicë, shka ká sot Tringa*.

Nga këtej mund të arrijmë në konkluzionin se *Andrra e jetës* ka filluar të hartohet, të paktën të konceptohet në mendjen e autorit, që në vitin 1904. Eshtë alfabeti i variantit të vitit 1904 që nuk lë vend për dyshime, në këtë pikë. Kjo mund të ndihmojë në një të ardhme, kur të gjenden dorëshkrimet e variantit përfundimtar të "Andrrës së jetës", në përcaktimin e afateve dhe të proceseve krijuese të kësaj kryevepre.

Një gje mund të thuhet me mjaft siguri: "Andrra e jetës" nuk duhet të jetë shkruar para vitit 1904, sepse nuk do të kishte kuptim që në fletoren e poezive të bartura (1902 - 1903) dhe të përpunuara (1904) të poezive të Mjedës, kjo poemë të mos përfshihej, ndërsa një poezi me katër strofa, pjesë integrale e kësaj poeme, të zinte vend aty.

"Po shkon me bujtë te Zoja", mbas botimit kritik në "Nëntori" nga Shuteriqi, (1963), nuk u përfshi në asnjë botim dhe përmbledhjeve të poezive të Mjedës, madje nuk u botua asnjëherë deri më sot.

Varianti i parë, në fletoren e vitit 1902 – 1903

Po shkon me bûit te Zoja
Nané a spo shef se Zefi
Priton ala m'u çue!
Thirre që t'viin me mue,
M'u lut si kena adet.

Bii, mos e prek se i lumi
Tesh â tui fol me Zojen;
Ruju se e çil ktu gojën,
Se e lumia Zoj t'bertet.

Nan, pse po vien xhakoni
Me qiri n'dorë tui kndue
E kû po don me e prûe
Zefin m'at ark me mndash?

Sé bii, se sonte Zefi
Po shkon me bûit te Zoja
Merre kto lule e çoja
Zojs per dhunti kiosh.
(1890)

Varianti i dytë, në fletoren e vitit 1904

Po shkon me bûit te Zoja
Nané shka pashka Trinka
Qi po priton m'u çue!
Zgjoje me dalë me mue,
Me *(ruejt)* lëshue baktín e vet

Bij, mos e prek se e njomja
Tesh â tui fol me Zojen;
Len zan e mos çil gojen,
Se e lumia Zoj t'bertet.

Qe prifti, nan', qe dajat
Me qiri n'dorë mbas tij
Katundsa me malsorë
Qi shpìja nuk i xê.

Rri, bij', se sonte Trinka
Po shkon me bûit te Zoja:
Merri kto lule e çoja
S'Lumes dhunti per tê.

Varianti përfundimtar, si pjesë e "Andrra e jetës"[1]

Andrra e jetës
Cicé, shka ká sot Trinka
Që po priton m'u çue?
Zgjoje me dalë me mue,
Me lëshue baktiën e vet.

-Bij', mos e prek, se e njomja
Tash â tui folë me Zojen ;
Lên zân e mos çil gojen
Se e lumja Zojë t'bertet.

Qe prifti, nanë, qe dajat

1 D. Ndré Miedia, "Juvenilia", shtypshkronja "Gj. N. Vernay", Vjenë, 1927, fq. 34 – 35 (nuk bën pjesë te studimi i sipërcituar i Qukut).



NDRE MJEDA

Vjersha të pabotuara dhe variante

Po ia paraqitim këto vjersha lexuesit, duke i nxjerrë nga dorëshkrimet e poetit që ruhen në A.Q. H.Sh., në Fondin Mjeda. Vjershat u nxorën prej një radhoi, ku renditen në këtë mënyrë: «Vaji i bylbylit», fq 1-13; «Uzdaja pa dobi», fq 26-27; «Po shkon me buit te Zoja», fq 36; «Gjuha Shqype», fq 38-42; «Iliria e Epirit (Kangë për mot qi vien) Lissus», fq 42-47. Ruajmë ortografinë e origjinalit (veç theksimit), duke hedhur në shënimet çdo ndryshim që mund të ketë bërë auktori mbi dorëshkrim, kur i ka përpunuar vargjet. Japim edhe shpjegimet e nevojëshme të fjalëve, etj. Për «Vajin e bylbylit», bëjmë krahasimet midis varianteve ekzistuese (v. shënimin 1 të poemthit), dhe nuk japim shpjegime.

Dh. S. Sh.

Vaji i bylbylit

I.

Po shkrihet bora
Dimni po shkon,
Bylbyl i vorfën,
Pse po gjimon?

1) Mbas titullit, M. ka shënuar fjalën: Edit, që do të thotë se poemthi ka qenë botuar dhe se ai e regjistroi në radhuan e vet pas botimit, d.m.th. pas vitit 1887. Nën atë fjalë, M. shënon fjalën: Tieterflim, që sigurisht do të thotë: version i ri. Kemi pra 3 versione: atë të vitit 1887, këtë që po botojmë nga dorëshkrimi i M, dhe që është i mezit të viteve'90, dhe versionin definitiv të vitit 1928. Kur teksti që po japim (v.2) do të krahasohet në shënimet me versionin e vitit 1887, pas shënimit, në parantezë, do të vemë siglën v.1. Kur ky tekst të krahasohet me versionin e vitit 1928, në parantez do të vemë siglën v.3. Kur ky tekst që po japim të ketë përpunime të shuara, që s'kanë lënë gjurmë në versionin 1928 dhe që s'kanë të bëjnë me versionin 1887, do të vëmë në parantezë siglën v.2. Ruajmë ortografinë dhe pikësimin e dorëshkrimit, pa shënuar ndryshimet që mund të ketë me versionet 1887 dhe 1917.

123

Mbas tij, me qiri n'dorë ;
Katundca me malcorë
Sá shpija nuk i xê.

-Rri, bij' se sunte Trinka
Po shkon me bûjtë te Zoja ;
Merri këto lule e çoja
Së lumes dhuntië per tê.

Pesë variantet e "Vaji i bylbylit"[2]

Vaji i Bylbylit njohu disa përpunime dhe disa botime gjatë më shumë se një shekulli. Dorëshkrimin e variantit të parë që pa dritën e botimit tek Shahiri Elierz nuk e njohim. Ky variant që u hartua në vitin 1886 në Portore, u botua në Shkodër në shtypshkronjën e jezuitëve në maj 1888.

Varianti i dytë dhe i tretë i *Vajit të bylbylit* gjenden, që të dyja së bashku në fletoren e dorëshkrimeve të poezive të Mjedës që ruhet në AQSH. Përcaktimi i moshës së këtyre dy varianteve përbën një detyrë me rëndësi të shkencës. Ne mendojmë se ata i takojnë një periudhe gadi dy dekada më vonë mbas hartimit, pra rreth viteve 1902-1903. Për këtë fletore me dorëshkrime të korrigjuara

2 Mentor Quku, "Mjeda 1", Ilar, Tiranë, 2004, fq. 411 – 415.



Pushoj murlani
Me stuhi t'vet: (2)
Bylbyl i vorfën,
Çou, mos rri shkret. (3)

Gjith fusht e malet
Blerimi (4) i mloj;
Livadhi e pema (5)
Gjith kah lulzoj. (6)

Nder pyllna e ograja (7)
N'ma t'mirin vend
Me rreze dilli
Po e gzon gjithkend.

E tui gjimue
Shkon rreth e rreth
Nji prru qi veret
Riedh neper gjeth.

A çil kafazi
Bylbyl, flutro:
Nder pyllna e ograja, (8)
Bylbyl, shpejto. (9)

Kerkush ma hovin
Njatie (10) s ta pret;
Me zeher haejen
Kerkush s ta qet.

Kafaz ke qillen,
Zemrën pengim; (11)
Gjith ka t'do zemra (12)
Shkon fluturim. (13)

Neper lamije (14)
Ke me gjet mel,
Për gjith prendveren
Njajo buk t'del.

2) Me duhi t'vet (v.3). Bari po del.
3) Ça je kap tel.
4) Jeshili.
5) Dul gjethi e pema (v.2). Ka dal gjetht, pema.
6) Ty ma... (v.2). Ka dashur të krijojë një varg tjetër dhe e ka lënë në mes.
7) Nder pylla (v.3). Ne pyyll nner agra.
8) Nder pyje (v.3).
9) Bylbyl, hait shko.
10) Atje (v.3).
11) Epshin pengim (v.3). Qefin sixhim.
12) E gjith ku t'rreshket (v.3). Gjithku.
13) Shkon si vetim.
14) E n'fusha e n'lame (v.2). Nder fusha e lame.

124

të poezive të Dom Ndre Mjedes, u fol në shtyp, gjatë vitit 1963, nga dy studiuesit Mark Gurakuqi dhe Dhimitër Shuteriqi. Pavarësisht se kur i krijoi poezitë Dom Ndre Mjeda, jemi të bindur se ai i hodhi ato në fletoren në fjalë, në një periudhë të mëvonshme. Kjo vërtetohet nga lloji i alfabetit të përdorur nga Mjeda, si dhe për faktin se poezitë që përfshihen në fletore nuk ruajnë radhën kronologjike të hartimit.

Mjeda kur barti poezitë e tij të rinisë në fletoren që ruhet sot në AQSH, bëri disa ndryshime drejtshkrimore, duke përdorur njëkohësisht alfabetin e tij me shenja diakritike. Mendojmë se është pikërisht ky alfabet që na ndihmon të përcaktojmë kohën kur Mjeda i barti dhe kur i përpunoi nga ana drejtshkrimore poezitë e tij të rinisë në fletoren e lartpërmendur. Pasi përshtati rreth vitit 1887 alfabetin e Kristoforidhit, Mjeda i bëri, herë pas here, modifikime alfabetit të tij, derisa i dha formën përfundimtare me botimin e Abetares së vitit 1904. Këto modifikime u bënë kryesisht nën ndikimin e opinionit të albanologëve dhe me qellim kompromisi me shoqërinë rivale "Bashkimi", rreth viteve 1900-1904. Alfabeti i teksteve të poezive të bartura nga Ndre Mjeda në fletoren që ruhet në AQSH është më i vjetër se ai i abetares (1904), por më i ri se ai i përdorur nga poeti në regjistrin e lindjeve të Vigut (1899-1902). Prandaj jemi të mendimit se ky variant i poezive të Mjedës i përket 1902-1903. Mendojmë se fletorja me poezi të bartura të hartuara në rininë e hershme nga Mjeda, ka lidhje me përpjekjen për të botuar poezitë e tij të para. Mund ta quajmë një *Shahiri Elierz të Dytë*, ose një *Para Juvenilje*.

Varianti i tretë, ai i korrigjimeve të bëra nga vetë Mjeda në fletoren e dorëshkrimeve, ka tërhequr vemendjen e studiuesve meqenëse aty poeti, krahas ndryshimeve të tjera, bëri edhe spastrimin e poezive të tij nga fjalët e huaja. Studiuesit që publikuan këtë fletore me dorëshkrime të Mjedës, si dhe ndonjë tjetër më vonë, bënë gabime në vlerësimin e moshës së këtyre dorëshkrimeve e në mënyrë të veçantë të korrigjimeve të bëra nga vetë poeti. Ata shprehën mendimin se fletorja me dorëshkrime të Mjedës, së bashku me korrigjimet e bëra aty, i përkasin periudhës së korrespondencës Mjeda-Meyer (1892-1895), ose aty rrotull. Nga analiza e alfabetit të korrigjimeve të bëra nga Ndre Mjeda, del se ai është plotësisht i njëjtë me variantin përfundimtar, me atë të përdorur për herë të parë në Abetaren e vitit 1904. Kjo vërteton se ripunimet gjuhësore Mjeda i bëri në periudhën 1905-1908. Duke lexuar korrespondencën Mjeda Meyer, nuk gjejmë asnjë provë që të vërtetojë, se poeti ynë u ndikua nga albanologu i njohur për të bërë pastrimin e poezive të tij nga huazimet. Përkundrazi, pikërisht në këtë letërkëmbim ne e shohim bindjen e bile këmbënguljen e Mjedës për të vazhduar përdorimin e gjuhës që flet populli. Në letrën që i dërgon Meyerit nga Krakovi (me 15 janar 1893), lidhur me poezitë e veta. Ndre Mjeda shkruan: "Puristët do të bajshin zhurëm, po t'i shihnin mbasi kanë shumë fjalë turke. Po unë i kam ba për popullin që flet kështu". Bile Mjeda do të vazhdojë të përdorë një gjuhë me huazime edhe kur boton Abetaren (nëntor 1904) dhe Këndimet, libri i dytë (mars 1905).

Është me interes të theksojmë se alfabeti i korrigjimeve në fletoren e Mjedës, ndryshon jo pak, por në rreth 50 për qind të shkronjave karakteristike të tij. Pra kemi arsye të bëjmë fjalë për dy variante të alfabetit të Mjedës, që i takojnë periudhave të ndryshme. Gjithashtu kemi të bëjmë edhe me dy variante të ndryshme të poezive të tij, hartuara në kohë të ndryshme.

Varianti i katërt dhe i pestë nuk kanë probleme të kësaj natyre. Ato i gjejmë, njërin në vëllimin *Juvenilia*, botim i vitit 1917, bere në Vjenë, dhe tjetri po ashtu në vëllimin *Juvenilia*, ribotim, i bërë në vitin 1928, në Shkodër.

Në mes të viteve 1888 – 1897, poemti *Vaji i Blyblylit* njohu disa ribotime në Shkodër, ku edhe u bë popullor. Mendojmë se ato duhet të kenë përsëritur variantin e parë, atë të *Shahiri Elierz*. Ne gjetëm edhe një botim tjetër, bërë në vitin 1916, në variantin e vjetër tek gazeta *Vëllazënia*. Ky variant qarkulloi në mes të lexuesve shqiptarë kudo në Perandorinë Austro Hungareze, gjatë Luftës Botërore, pra edhe në Shkodër. Duket se redaksia e gazetës *Vëllazënia* (organ i shoqërisë Dija në Vjenë), ka shfrytëzuar variantin e parë të poemthit të bërë në *Shahiri Elierz*. Krahas *Vajit të bylbylit*, në të njëjtin numër të gazetës botohet poezia e Bytyçit *Lugati*, e cila edhe ajo përfshihet në *Shahiri Elierz*.

Pati autorë që prirjen e Mjedës për përpunimin e vazhdueshëm të poezive, e keqinterpretuan, duke shkuar deri në mohimin e frymëzimit poetik. E vërteta është se poezia e Mjedës ka karakter të theksuar refleksiv.

Fakti që ai shkroi pak poezi, si dhe që nuk pranoi të

përtrinte poezitë e tij të humbura të rinisë, tregojnë se ai ishte model i ndërgjegjes së lartë artistike. Mjeda pati një jetë të trazuar, plot konflikte e ngacmime, tronditje e situata të acaruara. I pajisur me ndjenja të holla e delikate, por edhe të fuqishme e të pasura. Mjeda u frymëzua, mori letër dhe vetëm në këto rrethana u ul të shkruaj me një frymë. Poezia e Mjedës, për këto arsye, karakterizohet nga tensioni emocional si dhe nga një mikrokozmos ndjenjash. Ndërsa karakteri mediativ i poezisë së Mjedës, i cili rrjedh nga personaliteti i tij, si patriot, shkencëtar dhe filozof, nuk e shuan karakterin refleks të saj. Nxënësit e Mjedës kanë shkruar se poeti kurrë nuk qe i kënaqur për shkrimet e tij. Për Juvenilien ai thoshte: "**Sikur të kishem mundësi me pasë energjinë e hovin e rinisë do t'i bajshe ndryshime**".

Dy variantet e poezive
që i kushtohen stinëve

PRÉNDVÉRA

Filloj toka m'u pertrië,
Mal e fush' â gjith blerim,
E prei bjeshkve tui u shkrië
Ulet uji pá pushim.

Del prei zgjojsh e cénshmja bletë
Dalin thnegelat' per mel;
N'prak të derës' nji plak i shkretë,
O nd'oborr, m'u xémun' del

Kndojn' bylbylat' nder ograja
Tui punú per fole t'vet;
T'shkretin' búlk e mban uzdaja
Me i shkú mbar' njaj mund qi qet.

Kndo, bylbyl, mb' at giuhen' tande
Xéju n'diell, o i ngrati plak,
Flutrò blet' gjith kah të kânde,
Mos u lodhni, thnegla aspak.
Abetare, Vjenë, 1904

PRÉNDVÉRA

Jeni lodhë, dallëndysha t'shkreta,
Jé molis'i ziu bylbyl;
Ah! pushoni n'streh' ku u gjeta,
Pushò n'kopshtë te njaj zymyl.

Mbi krahë tuej prei dhenash tjera
Ju prêndvéren na prûet këtej;
Shlodhn'ju prá, dallëndysha t'mjera
Rri, bylbyl, n'lulzim qi kthej.

Se qe'j prrue prei malit ulet
E t'tanë fushës ushqim i nep;
E nen borë po shperthejn' lulet
Porsi fëmië qi zblohen n'djep.

Fllad i lét me vapë dashtnijet
Puthi pémen gêmb per gémb;
U zgjue pêma, e qe prei shijet
Buloj mbarë neper kopshtë têm.

Ndéj' brîë votres nieri myket:
Vrapó, búlk, kû puna t'thrret;
Tui vrue fushen kau berlyket,
Lyp' mu vûe per lavrë t'vet.
Juvenilja, Vjenë, 1917

***

VÉRA

Mbrrini véra, e tui flakrue
Ndihet' dielli per gjith vend,
E prei drithit tui blérue
Arët'u bane t'gjitha n'shend.

Mih' nd'arnaje katundari
Tui lag' token' me djers' t' vet;
Qysh prei nádjet kosatari,
Tui punu' n' livadhe pret.

Nen vap' t' diellit me hitië
Shko ti, o vajz', o grue shko:
Tui korrë grunin' me çalltië
Dorca dorca ma vêndò..

Njiký mũnd qi shkon sá ndóra
Ká m'u ndërrue shpejt n' pushim:
Kúr t'vin akulli e t'bien bóra
Prei kti mũnd do t'keni pshtim.
Abetare, Vjenë, 1904

VÉRA

Â zvérdhë fusha, e nder grunore
Po vëlojnë korrcat porsi zogj'
Këndojnë katuncat me malcore
Pá u kujtue si dielli i dogj.

Veç n'at arë, porsi nji e tretun
Zi nder petka e n'ftyrë terr,
Korrë nji cucë pá shoqe vetun
Me hie t' vet qi mbrapa e merr.

Tjetra herë ti vet' e treta
Korrshe, o bij', me motra n'shend;
Sivjet vetun tui korrë t' gjeta
Pá nji motrë, pá gazménd.

"Kjenë nji arë qi muell nji ditë
Perendija, e i dha shëndet;
U poq para: e ka goditë
E i ká bájtë te shpija e vet."
Juvenilja, Vjenë, 1917

***

VJESHTA

DALLËNDYSHES

Qe Shtatori tesh ma mbrrini,
E pa m'lânun' nuk po ndale;
Ké me shku'ku lulzon vrrini,
Me dét tjer' me tjera male
Ké m'u falun' kah kendon,
Moj dallndysha, qi shtegton.
Per gjith nádje vet' e ngrita
Tui çil' syt' per me lotue,
Neper bór' e bryma t'shtrita,
Tesh kujtoj se edhè per mue
At' zan' tand e lshon, si parë,
Me m'anku', dallndysh' shtegtarë.

Ndoshta 'j kryq, kúr t'vin prêndvèra.
Ké me gjetun' mbi ket' truell;
Permbi tê, dallndysh' e mjera,
Ndalu 'j herë, se fati të suell.
M' lut pushim, mbat' gjuh' qi ke,
Moj dallndysh shtegtare e ré.
Abetare, Vjenë, 1904

VJESHTA

'Dhe ju po shkoni,
Bylbyla kshtu!
Po tretni këndynaj,
Dallëndysha, ju!

Deken mêndova
Se m' vjen kúr do;
Se m' lêni vetun
S mêndova, jo.

Por, mâ fort zêmren
Ma brén nji idhnim:
Çerdhet qi i lêni
Kujdesit tim.

Ndoshta, kúr t'ktheni
Mue vorri m' mba,
E ju kerkoni
Çérdhen qi s â!

Juvenilja, Vjenë, 1917

Rasti i poezisë *Dimri* trajtohet ndryshe nga studiuesi Quku. Ai paraqet variantin e botuar në 1917 te *Juvenilja* dhe me footnote tregon se si ishte varianti paraprak, ai i vitit 1904 botuar në *Abetare*. Kështu po e paraqesim edhe ne në vijim, vetëm ndryshimet e qenësishme, duke anashkaluar ato që lidhen me shenjat diakritike e diakronike mbi shkronja, objekt i ndonjë tjetër studimi në të ardhmen.

DIMNI[3]

Neper fush' e neper male
Fryn murlani me stuhië;
O murlâ, njat frymen ndale.[4]
Ndal ti, o akull, mos me ngrië,[5]
Mos ma ngrîni ket pikë gjak.
Struku, struku, i shkreti plak.

Po del dimni me kosë ndórë,
Gjeth e bár i ká kositë;
Qet balkoni pjalm e borë.
E plak shkreta, tui merdhitë,
I thotë védit me zâ pak:
Struku, struku, i shkreti plak.

Juvenilja, Vjenë, 1917

3 Ne *Abetare*, titulli paraqitet *Dallëndyshes*
4 *O murla, at' frymen' ndale*
5 *Ndalu akull, mos me ngrië*



Dorëshkrimi autograf i Mjedës

MISTIKA E ËNDRRËS NË LIRIKËN E FATOS ARAPIT

Nga Alisa VELAJ

Foto Qerim Vrioni, 2021

Në opusin poetik të Fatos Arapit gjenden disa lirika kulmore, të cilat i bashkon me njëra-tjetrën **motivi i ëndrrës**. Të shkruara në kohë të ndryshme dhe të dala në dritë në vëllime të ndryshme, po të renditen sipas kohës së botimit, këto lirika krijojnë idenë e një cikli poetik të shkruar me një frymë nga poeti. Kronologjia përfshin poezitë "Duke dalë prej ëndrrës", '"Dikush tani të bën ty ëndërr", "Mos eja në ëndërr", "Gjysëm ëndrre në sy", "Dhe nata u zgjua", "Jemi takuar e ndarë në një ëndërr", "E paëndërrta ime", "Ne jemi në ëndërr" dhe "Një zë i pazë". Poet i dashurisë dramatike, Arapi e ngjiz dhimbjen e tij në këtë "cikël poetik" përmes topikëve **ëndërr** dhe **vdekje**, ndërsa ajo, e dashura e paëndërrt *prej malli e bryme* na shfaqet si një shkrepëtimë hutuese.

Ti ishe një dritë që ecën,
Një këngë që ecën ti ishe.
Mes dashurive të ditës,
Hutim i vegimit mahnitës.

"Duke dalë prej ëndrrës"

Në këto vargje kuptimi i misterit të shenjtë formësohet nga përzierja mes realitetit të ëndrrës dhe realitetit të zhgjëndrrës. E dashura si vegim mahnitës hyn e del nga ëndrrat e subjektit lirik, andej nga ky i fundit ose e mban të ngujuar për ta mbrojtur nga harresa, ose ajo vetë ia pushton pavetëdijen "me kast", duke ia bërë të padurueshme ditën që e sheh me sy ëndrre.

Si ta duroj ditën,
që më sheh me sy ëndrre?

"Mos eja në ëndërr"

Ëndrra është hapësira ku poeti rilind pandërprerë një dashuri të largët, nga frika se një ditë ajo mund t'i vdesë. E paëndërrta e tij nuk është e dashura pa ëndrra, por e dashur reale, ndjenjë e groposur thellë në kraharorin e jetës. E paëndërrta nuk është fanepsje e ardhur nga kushedi cila skutë e pavetëdijes, nga nevoja për të shpikur një dashuri si mungesë e etshme papërmbushjeje. Dashuria ka qenë aq e prekshme dikur diku, sa ardhja vetëm në ëndrra, nëse në njërën anë ia shuan sadopak mallin e pashuar, në anën tjetër e pikëllon pa masë. Pse duhet të vijë vetëm në ëndrra në fund të fundit?! Është ndoshta kjo pyetja hipotetike që e mundon subjektin lirik, ndërsa i lutet dashurisë - të mos i vijë më në ëndërr. Është ajo lloj lutje, si kur i thua dikujt se duhet të bëhet realisht i gjallë dhe jo të mbetet dhimbje e pandërprerë, edhe pse një dhimbje e denjë për t'u jetuar. (*Shumë e denjë dhimbja për t'u jetuar.*)[1] Ëndrra si dëshirim, ëndrra si përmallim, ëndrra si krijim i realitetit të munguar dhe ëndrra që ther në kraharor (e mbetur përherë zhgjëndërr) është trualli ku ngjizet shenjtëria e kujtimit të dashurisë në këto lirika të Arapit.

Misteri i ëndrrës, diku i prekshëm nga lexuesi dhe diku tjetër paksa i pakapshëm e surreal, e ka burimin e vet pikërisht në përsiatjen dramatike të mallit. Mallit si ndjenjë dhe mallit si mendim. Malli si ndjenjë lind dëshirimin e ëndrrës, e thërret atë më ngulm, ndërsa malli si mendim kundërshton jo vetëm takimin në ëndërr, por deri dhe realitetin e një kujtimi që ia bën të padurueshme të tashmen. Në lirikat "Jemi takuar e ndarë në një ëndërr" dhe "E paëndërrta ime" më shumë se me të dashurën, subjekti lirik dialogon me dhimbjen, që duket se është mishëruar në shpirtin e dashurisë. Në poezinë e parë, dyshimi nëse ajo është dhimbja apo dhimbja është ajo, vjen i turbullt edhe për lexuesin model. Reale dhe e dukshme në të dyja krijimet mbetet atmosfera e vdekjes në hapësirën e ëndrrës.

Dora jote, e dalë si prej një ikone,
U zgjat drejt meje:
- Kujdes, tek këmbët tona
gurgullon Akeronti.

"Jemi takuar e ndarë në një ëndërr"

Dikush, prej zhgënjimit të egër,
mbërthen kryqe të reja
I hedh një gjysmë leku
dhe blej kryqin tim.

"E paëndërrta ime"

Ëndrra e dashurisë është më i bukuri sublimim i shpirtit të përndritur, si antipod i realitetit të zbrazët përplot *shpirtra joshpirtëra që shkojnë*[2] e vijnë. Poetit i mjafton edhe një gjysmë ëndrre si arratisje nga ky realitet. Një gjysmë ëndrre, qoftë edhe për t'u ndriçuar përgjysmë nga dielli i dashurisë. Ëndrra, si harresë e vdekjes së dashurisë dhe si ringjallje e dritës së lëmekur, (kur zgjimi nuk është tjetër veç truall i vdekjes) është kryqi në të cilin poeti vdes për të riardhur rishtas në një trajtë tjetër më të përsosur.

Përtej lirikës dashurore, në lirika të tilla si "Gjysmë ëndrre në sy" dhe "Një zë i pazë", motivi i ëndrrës ngjizet brenda kontekstit ekzistencial të lirikës së Arapit. Gjysma e ëndrrës dhe terratisja nga irrealiteti drejt vetes reale mbartin në ashtin e tyre misionin më sublim shpirtëror: kthimin te njeriu. (*Kthehu te njeriu*).[3] Ky kthim/rravgim duhet të ndodhë me patjetër kur vdekja e dashurisë ka bujtur në më të shenjtin habitat të saj.

Rrenës ky diell i janarit
thëllimi i ftohtë shkund e shpërbën
hijen time atje në tokë.

"Një zë i pazë"

Një monolog tragjik i poetit nga qiejt e përtej jetës, përtej ëndrrës dhe përtej hijezimit të shpirtit. Ambiguiteti i fjalës e zbret surrealen "me këmbë në tokë", duke e ritrupëzuar vegimin e fyer të shëmbëlltyrës së dritës në një gjysmë shprese të ringjalljes së saj. Ëndrra bëhet kështu atdheu ku do të ndodhë ringjallja. Por nëse në lirikën dashurore është ringjallje e një kujtimi që mund ta vdesë harresa, këtu është ringjallje e shpirtit të dritës në gjithë skutat e tij më të padukshme.

Përgjysëm u çova në në shpresën time,
si Llazari në varr përgjysëm.
"Gjysmë ëndrre në sy"

Shohim se ëndrra si rravgim drejt një plotnie apo paplotnie shpirtërore (sipas kahjes së leximit) është idili më i thellë i Arapit. Aksioma aq kuptimplote

1 Varg i poezisë "Dhe nata u zgjua".


Foto Qerim Vrioni, 2004

2 Varg i poezisë "E paëndërrta ime".
3 Varg i poezisë "Një zë i pazë".

(Vijon në faqen 9)

DALLIMET KULTURORE, NJË SFIDË E VËRTETË NË PROCESIN E PËRKTHIMIT

Nga Iljaz Spahiu
Sinolog, Përkthyes i Gjuhës Kineze

Angazhimi im në fushën e përkthimit të letërsisë kineze zë fill në vitin 2012, vit kur fitues i çmimit "Nobel" për letërsinë u shpall shkrimtari kinez Mo Yan. Mes dyshimit dhe pasigurisë së fillimit, por edhe inkurajimit të kolegëve shqiptarë e kinezë, sprova e parë, përkthimi i romanit "Bretkosa" u kalua me sukses dhe u bë shtysë për përfshirjen time të mëtejshme në fushën e përkthimit. Nënshkrimi në vitin 2015 i marrëveshjes "Për përkthimin dhe botimin reciprok të 50 titujve nga kinezishtja ne shqip dhe nga shqipja në kinezisht", shënon një moment të rëndësishëm e bashkëpunimit në fushën e botimeve. Pasi duhet thënë se, pavarësisht marrëdhënieve speciale mes dy vendeve, shkëmbimeve intensive në fushën e kulturës, arteve, kinematografisë, e fusha të tjera, libri, sidomos veprat letrare të pas viteve 80-të, iu kanë munguar lexuesve të dy vendeve. Qysh pas nënshkrimit të këtij programi, duhet thënë se tregu i librit kinez është gjallëruar dukshëm, janë përkthyer dhe botuar mbi 40 tituj librash, te cilët për fat të mirë cekin pothuajse te gjitha temat, duke zgjuar interesin e lexuesit vendas për letërsisë kineze, për kulturën, filozofinë, ekonominë, modelin e zhvillimit ekonomik dhe qeverisjes.

Do të desha të ndaj disa opinione rreth përkthimit, ose më mirë për eksperiencën time në këtë udhëtim të vështirë. Po përmend shkurtimisht disa nga sfidat, vështirësitë kryesore me të cilat u përballa gjatë procesit të përkthimit, të tilla si, dallimet kulturore, në mentalitet, mënyrën e jetesës, traditat sociale, sfondin historik, njohja e gjuhës amtare, etj.

Thuhet shpesh se përkthimi nuk është thjesht transformim gjuhësor, por është më tepër transformim ndërkulturor. Ku konsistojnë këto dallime, të cilat hasen më shumë dhe fare qartë gjatë përkthimit të veprave letrare.

Së pari, në mënyrën e jetesës, të cilat shprehen në mënyrën e jetesës, pasi ambienti i ndryshëm natyror sigurisht çon edhe në dallime në mënyrën e jetesës, e cila është edhe një nga shprehjet e kulturës. Kështu, dallimet në kulturën e të ushqyerit mes dy popujve tanë shqiptarë e kineze, sjellin edhe dallimet në mënyrën e të shprehurit gjuhësor. Për shembull, kinezet historikisht kane pasur orizin si ushqim baze, kurse shqiptaret bukën. Prandaj edhe kinezët thonë "chifan" (ha oriz), kurse shqiptaret "ha buke"(chi mianbao). Ose për të treguar një punë jetike për njeriun, në shqip thuhet "buka e gojës", kurse në kinezisht "tasi orizit" (fanwar). Janë të shumta shprehjet idiomatike ose metaforat të cilat kanë në qendër këto dy lloj ushqimesh, si "I heq bukën e gojës" në shqip dhe "I heq tasin e orizit" në kinezisht.

Po kështu mund të përmendim emërtimet e një sere gatimeve krejt të ndryshme dhe të panjohura në vendet respektive, të tilla si jiaozi (një lloj ravioli), gongbaojiding, huoguo(Hot pot), doufu(djath soje) etj, të cilët nuk kanë ekuivalentin e tyre në gjuhën shqipe, por që janë mjaft të famshme në kulinarinë kineze.

Dallimet kulturore shfaqen edhe në zakonet dhe traditat sociale, të tilla si festat tradicionale, festat fetare, qëndrimi ndaj kafshëve etj. Përmendim këtu Vitin e ri kinez, ose Festen e Pranverës, që përkon me kalendarin hënor (guonian, chunjie), Festa e Mesvjeshtës (zhongqiujie), ose një sërë ritesh për këto festa, si vendosja e shiritave zbukurues në anët e derës (duilian), zbukurime me letra (jianzhi). Po kështu edhe orientimi i shtëpive sipas *fengshui* , pra orientimit sipas pozitës gjeografike, drejtimit të maleve e lumenjve. Të gjitha këto është e nevojshme të shoqërohen me një shpjegim, për ndryshe e bën konfuz lexuesin dhe ia vështirëson leximin e mëtejshëm.

Një drejtim tjetër i dallimeve kulturore shfaqet edhe për shkak të sfondit historik Për shembull, një ndër shkaqet që unë zgjodha romanin "Bretkosa" për të përkthyer të parin, është se pasi u njoha me përmbajtjen e tij, isha i bindur se për shkak të ngjashmërisë së sistemit, terminologjia e përdorur aty dhe përmbajtja e tij do të ishin shumë më të pranueshme dhe kuptueshme për lexuesit shqiptare. Kështu terma të tillë si kooperativë, Fletë-rrufe (dazibao), lufta e klasave, etj janë po aq familjare edhe për lexuesit tanë.

Këto dallime pra, kërkojnë nga përkthyesi që për të përcjellë në mënyrë sa më të plotë dhe më të saktë informacionin e brendshëm të veprës origjinale, duhet të kuptojë thellë edhe veçoritë dhe dallimet kulturore të dy gjuhëve, si dhe të harmonizojë sa më mirë përmbajtjen kulturore.

Si mund të trajtohet dhe zgjidhet problemi i dallimeve historike e kulturore? Nëpërmjet përkthimit transliteral, pra duke lënë fjalën siç shqiptohet në gjuhën kineze por duke i shtuar sqarimin përkatës. Duke qenë se siç thashë edhe më sipër për shkak të dallime kulturore ka shumë fjalë që nuk mund të përkthehen, për të ndihmuar lexuesin që të kuptojnë përmbajtjen, domethënien kulturore, gjatë përkthimit përdoret kjo mënyrë përkthimi. Kështu qoftë në veprat letrare, por sidomos në librin "Konceptet bazë të mendimit dhe kulturës kineze", hasen dendur fjalë të tilla, si "gongfu, yinyang, bagua, dao," e shumë nocione të tjerë kulturorë e filozofikë, të cilët janë lënë siç shqiptohen, por duke shpjeguar përmbajtjen e tyre. E njëjta gjë vlen edhe për shumë fjalë tipike nga shqipja si besa, kanuni, etj.

Po kështu është përdorur edhe mënyra e përshtatjes, sidomos për shprehje idiomatike ose proverba, pra duke përshtatur kuptimin e tyre dhe

Nobelisti Mo Yan dhe përkthyesi Iljaz Spahiu

shprehje të përafërta nga gjuha shqipe. Por në fakt, unë në shumë raste kam synuar, siguristi kur ka qenë e mundur edhe përkthimin e lirë, pasi shprehja e përkthyer ka tingëlluar mjaft e bukur dhe madje ka ndihmuar edhe në pasurimin e gjuhës shqipe.

Nga sa më sipër mund të thuhet pra se për përkthyesin "Njohja e dy kulturave është madje më e rëndësishme se përvetësimi i dy gjuhëve". Kjo vlen sidomos për përkthimin e veprave letrare, dhe për më tepër nga Kina, një vend me një kulturë dhe civilizim të lashtë dhe krejt të ndryshëm nga ne.

Diçka tjetër që dua të theksoj është rëndësia e përkthimit sidomos veprave letrare drejtpërdrejt nga origjinali. Në krahasimin që kam bërë me versionin anglisht të "Klani i Sorgumit të Kuq", për shembull, vura re pasaktësi që çojnë edhe në keqkuptime e deformime të thella. Kështu në anglisht raki meli (gaoliangjiu) është përkthyer *wine* verë sorgumi, kur së pari aty tregohet se bëhet fjalë për një pije që prodhohet nëpërmjet distilimit, dhe së dyti, kinezët në traditën e tyre më parë nuk kanë prodhuar madje as e kanë përdorur verën, por pije, raki të prodhuar kryesisht nga drithërat. Ky është vetëm një shembull, por është e sigurt se nëpërmjet përkthimit nga origjinali përkthyesi përcjell edhe ndjenjat personale ndaj vendit, gjuhës e kulturës së tij, përjeton ngarkesa emocionale e ndryshme. Dhe po kështu vetëm duke njohur gjuhën përkatëse, ai arrin të depërtojë në botën e ndjenjave të autorit, në karakterin e tij stilistik dhe të transmetojë sa më mire që të jetë e mundur, këtë botë me ndjenja të huaja, këtë mënyrë dhe këtë stil me mjetet e gjuhës amtare, duke ruajtur gjithmonë personalitetin e autorit.

Pra si përfundim mund të them se gjatë përkthimit konstatova disa kërkesa që për përkthyesin janë të domosdoshme, si njohja e gjuhës së huaj nga e cila përkthen, njohja shumë e mirë e gjuhës tënde, gjuhës amtare, stilistikën e metaforat, të ketë njohuri sa më të plota nga fusha të ndryshme, dhe më kryesorja ajo që thashë më sipër njohja nga afër e kulturës, traditave, filozofisë, mentalitetit te popullit përkatës. Pra përkthimi mund të thuhet se ia ka arritur qëllimit kur në të nuk ndjehet e huaja.

Përkthimi dhe botimi i librave është pjesë e rëndësishme dhe e pazëvendësueshme e shkëmbimeve kulturore e njerëzore. Ndryshe nga arti, sporti, apo çdo produkt tjetër, vlera e librit qëndron në faktin se ai kalon nga brezi në brez, zbukuron dhe pasuron botën shpirtërore të njeriut. Prandaj përkthyesit janë ura lidhëse mes civilizimeve të ndryshme, që ndihmojnë në zbutjen e dallimeve kulturore, nxisin njohjen e mirëkuptim reciprok. Pushkini thotë se "Përkthyesit janë kuaj karroce të qytetërimit"

Kurrë Nobeli nuk u meritua si këtë herë. *Corriere della Sera*

MO YAN

Bretkosa

蛙 (Wa)

roman

Përktheu nga kinezishtja

ILJAZ SPAHIU

Onufri

(Vijon nga faqja 7)

e Gëtes, se as në ëndërrimet më të bukura njeriu nuk ia kalon dot natyrës do të rifunksionalizohej në këtë abstragim: vetëm në ëndërrimet më të bukura të shpirtit, natyra e tij do ta rilindë vetveten përmes vdekjesh fenikse.

Përpos poezive ku motivi i ëndrrës del i drejtpërdrejtë apo vetëzbulohet në një lexim denotativ, Arapi ka një numër të konsiderueshëm lirikash minimaliste apo poezish të shkurtra në të cilat gjendja e ëndrrës vjen si atmosfera ngjizëse e vetë poezisë. Përmendim "Te gryka e Akerontit në Bistricë", "Qiriri" "Në vorrezën e fshatit", "Këmbana funeralesh të mëdha", "Asgjë, e dashura ime, asgjë", "Udhës shkon një qiparis", "Burri i rrugës", "Manjolat" etj. Janë lirika ku imazhet e vargjeve sendërtojnë para syve të lexuesit shpirtin e dritës tek luhatet si flakë e qiririt, herë drejt shuarjes e një vdekje që duket si e pashmangshme, herë duke u përtërirë me një guxim të pashoq. Shenjuesit tekstorë të shuarjes së dritës në katër poezitë e para janë: 1. *botë e nëndheshme, terr-*: 2. *fundi i qiririt digjej, flaka ndizej më shumë-*:3. *vaji i kumrive, këmbana e thyer, kryqet fundosen-*: 4. *mbi copën e diellit që ka rënë atje poshtë.* Shenjuesit tekstorë të guximit të dritës dhe ringjalljes po në këto poezi janë: 1. *kandile të ndezur-emrin e saj-*: 2. *ikte vdekja e dritës me një mall pafund-*: 3. *të vdekurit falen te unë-:* 4. *këmbana funeralesh të mëdha.* **Shëmbëlltyra e vegime poetike ku çdo fjalë është në vendin e vet dhe në funksionin e plotë të së tërës.** Qoftë kur kjo **e tërë** është subjektive, si në rastet kur vargjet na vijnë në formën e "përçartjeve monologuese", qoftë edhe kur kjo tërësi ngjizet në formën e një narracioni lirik.

Procedimi i mësipërm i teknikave poetike të Arapit në këtë grup lirikash të ndërmend dy nga parimet bazë të imazhinizmit: trajtimin e drejtpërdrejtë të "sendit", qoftë ai subjektiv apo objektiv dhe mospërdorimin absolutisht të asnjë fjale që nuk ka kontribuar gjatë paraqitjes.[4]

Dielli im dy copësh u thye:
njëra është natë, -
e tjetra po shuhet.

Trajtimi i "sendit", thelbit poetik apo "ndodhisë poetike" (*thyerja e diellit*) është njëherazi subjektive dhe objektive. Objektive, sepse rrëfehet në vargje ajo çka po ndodh në natyrë. Subjektive, sepse uni lirik nuk rrëfen për një diell larg tij. Sintagma dielli im e rrok fuqishëm subjektivizmin përmes përemrit pronor "im". Dielli i tij (referuar unit lirik) është peizazhi shpirtëror diku i përnatur sa hap e mbyll sytë dhe diku tjetër i shtrirë në hapësira ku drita është në shuarje e sipër. Kallëzuesi i parë në të tashmen e dëftores (është natë) na dëften një veprim plotësisht të kryer. Drita është errësuar pa kthim tanimë. Kallëzuesi i dytë ka përpara pjesëzën *po* (po shuhet), duke na treguar për një veprim që po ndodh para syve tanë në të tashmen, por që nuk është një veprim i kryer. Ky veprim i dëftyer për lexuesin e poezisë është në process, në kryerje e sipër. Kemi imazhe zinxhir që i paraprijnë njëri-tjetrit dhe çdo imazh jetësohet për hir të imazhit tjetër. Si pikënisje kemi një diell që thyhet, një imazh mëmë që ngjiz dy imazhe të tjera: imazhin e menjëhershëm statik të natës dhe imazhin lëvizës të procesit të shuarjes së dritës së diellit. Një kataklizmë shpirtërore e vizualizuar mjeshtërisht në vetëm tri vargje dhe dhjetë fjalë.

Limfa poetike e Arapit ngjiz përfytyrime trajtash irreale prej shenjuesish tekstorë realë dhe anasjelltas, formëson në imagjinatën e lexuesit një pamje shumë të kthjellët prej shenjuesish irrealë në kohë dhe hapësirë. Poezia me vetëm katër vargje "Burri i rrugës" përcjell dramën e njeriut modern në vetminë e tij të vetizolimit. Burri i rrugës është njeriu mjegullor, i cili jeton në mjegullën që ka filluar të përhapet edhe brenda mendjes së tij. Ai sa vjen e bëhet fir për të tjerët dhe për lexuesit, duke u shndërruar në një tymnajë ekzistence. Ai është dhe nuk është aty si imazh, pasi sa fillon të jetë shndërrohet saora në një të panjohur, pa qenë për asnjë çast i njohur më parë. Burri i rrugës është odiseja tragjike e rrugës pa cak e zanafillë të burrit askurrë të përcaktuar si trajtë reale. Dilema se ç'është në të vërtetë ajo siluetë burri që dialogon pa zë më të tjerë zëra po aq të panjohur, e bën këtë poezi minimaliste nga më mistiket dhe modernet në poezinë shqipe. Ndërkohë pamje të kthjellëta, por prej shenjuesish irrealë sjellin poezitë "Udhës shkon një qiparis" dhe "Manjolat". Habia mitike zhvoshket sapo ia beh në përfytyrimin e lexuesit qiparisi që shkoka udhës njëlloj si një qenie frymore dhe manjolat që u ndezkan nga zoti i diellit. Në një meditim normal qiparisi është i palëvizshëm, ndërsa lulet çelin pa qenë nevoja të ndizen si të jenë yje.

Shpirtëzimi i botës bimore vjen në sinkron të plotë me motivin e ringjalljes së dashurisë. Irrealja në funksion të dramës së reales dhe çmitizimi në funksion të mitit modern krijojnë një pamje tejet simbolike gjithashtu. Surrealja është realja e shumëdëshiruar dhe e fortëndërruar në lirikën "Udhës shkon një qiparis". Këtu *qiparisi* nga simbol i vdekjes kthehet në simbol të jetës. (*Po ti ecën udhës së gjerë të qytetit,/spërkat e shpërndan hutimin e blertë*). Ndërsa në lirikën "Manjolat" poeti kërkon t'i përngjasë zotit të diellit dhe si një dishepull drite përpiqet të kthejë në jetë një shpirt që është duke vdekur te këmbët e tij me lutjen drithëruese: "Jeto, qoftë midis hijesh, ia vlen...".[5] Reale apo irreale, imazhet poetike në këto poezi antologjike të Arapit, i mëshojnë fuqishëm idesë se ai mbetet nga poetët më modernë të gjuhës shqipe, në kuptimin më bashkëkohor të këtij koncepti.

Vlorë, gusht-shtator 2021

4 The Selected Letters of Ezra Pound, ed. D.D.Paige (1950; rpt. London: Faber, 1982).
5 E gjithë fjalia është perifrazim i vargjeve të Arapit në poezinë 'Manjolat", ndërsa lutja mes thonjëzash është varg i cituar drejtpërdrejtë nga kjo poezi.

"Infiniti blu", një roman shkencor jo vetëm për rininë

Prof. dr. Alfred Çapaliku

Pas vlerësimit të romanit shkencor "Pika trëndafil" si libri më i mirë i vitit 2019 në letërsinë për fëmijë dhe për të rinj, çmim i akorduar nga Ministria e Kulturës, autorja Mimoza Hafizi është paraqitur me një vepër të re të po këtij zhanri, titulluar "Infiniti blu", shtypur nga Shtëpia botuese Albas, Tiranë 2020.

Tre kapitujt zhvilluar në tri vende të ndryshme, por me të njëjtin qëllim, popullarizimin e shkencës, organizojnë planin e minisubjektit. Veprimi nis më 2013 tek Instituti i Astrofizikës në Paris - Francë, vijon më 2016 tek Instituti i Studimeve të Përparuara në Princeton - SHBA dhe përmbyllet më 2020 në Universitetin Gôttingen - Gjermani.

Po ashtu tri janë pyetjet bazë që marrin përgjigje në prologun, në epilogun dhe në recto - versot e romanit:

1. A është e pafund bota?
2. Sa thellë ka depërtuar imagjinata dhe dija shkencore?
3. A mundet mendja jonë të kuptojë infinitin?

Tre janë edhe personazhet kryesore që vërtisin ngjarjet:

1. Dona, mesogrua e pashme shqiptare, astrofizikane e njohur në Francë, që dijet e saj i bën pronë të gjimnazistëve në atdhe,
2. Marina, vajza e saj e çlirshme, studente postmaster për matematikë në Gjermani, me një simpati afruese për një djalë të ri studiues, francez.
3. Profesor Martini, që 80 - vjetorin e feston mes të rinjve e të rejave në konferencën luks kushtuar atyre: "Valët gravitacionale janë kapur".

Nëna dhe e bija kanë përjetuar me intensitet të njëjtën dhimbje gjurmëlënëse, të paanashkalueshme. Dona vuan humbjen e bashkëshortit, profesor i çmuar historie. Marina ndjen mungesën e babait, studiues i Rilindjes evropiane. Për të dyja Maksi rri i pazevendësueshëm dhe i pakrahasueshëm. Maksi vazhdon që të jetë një burim frymëzimi te hapat e dy femrave në hapësirë dhe në kohë. Maksi dashurues etern i ngjyrës blu, sa është pikë referimi në horizontin e ngjarjeve si kimerë e lëvizshme; aq është energji pozitive në sistemin mikrovalor kozmik, si lëndë rezistente ndaj vrimave të zeza të universit të pafund. Dona, doktoruar në kozmologji, ndjen pranë interesimin e kolegëve të skuadrës së madhe të misionit hapësinor Plank, Gabrielit dhe Davidit, me të cilët rri në komunikimin e monitorit e të WhatsApp-it, me frekuencën dhe amplitudën e frymëmarrjes së shpirtërave binjakë. Marina rrethohet nga ngrohtësia dhe interesimi i bashkëmoshatarëve të motivuar për punë kërkimore, por edhe të hapur për të shijuar jetën. Shkëmbimet e ideve me Morganin në kopjuter, për doktoraturën, i bëhen asaj si pa kuptuar sistola dhe diastola të zemrës.

Ndërsa Profesor Martini, pa moshë, evergreen si të kishte pirë eliksirin, gjeneron ide të reja, me praninë e gjeneratave në ardhje dhe me shprehjen e respektin të thellë ndaj tij të Prof. Paul-it dhe Prof. Russell- it, bashkëreferues në takimin e shumëpritur. Studentët që popullojnë auditorin universitar, me intuitë shkencore i bëjnë jehonë duartrokitjesh çdo postulati dhe çdo formule të tij. Përvoja matëse e shkencëtarit flokëbardhë Martin kap tre mijëvjeçarët e fundit të Tokës, qysh nga Pitagora, Euklidi dhe Arkimedi, gjer tek gjurma e Armstrongut në Hënë, sonda eksloruese në Mars dhe Sfondi Mikrovalor në Kozmos.

"Një histori e ndritur ka kaluar zenitin e vet. Një histori e re sapo ka filluar."
Faqe 130.

Kështu shkruan me bindje shkencëtarja e yjeve Mimoza Hafizi.

Është fjala për arritjen e fizikës në mikrobotë. Jo thjesht prej shpikjeve mahnitëse të nanoteknologjisë, por në radhë të parë prej kontributeve sui generis të nobelistëve Max Planck, Albert Ajnshtajn, Niel Bohr, Warner Heisenberg, Paul Dirac, Wolfang Pauli, Lois De Broigle, Arthur Comton, Erwin Schròedinger, Max Born dhe i shumë të tjerëve, që do të vijnë ngarkuar me materjen e hirtë. Shpaloset një enciklopedi e të përjetshëmve.

"- Panorama e Sfondit Mikrovalor Kozmik vjen drejtpërdrejt nga viti 380000 pas krijimit." - Profesor Martini duket se nuk ka asnjëfarë hezitimi për të çmuar aftësinë depërtuese të valëve gravitacionale".
Faqe 142.

Këtë opinion shpreh saktë fizikania profesioniste Mimoza Hafizi.

Romani shkencor "Infiniti blu" është libër me shkronja, i lindur nga matrica e numrave. Ai libër librash synon si target lexuesit e rinj, me qëllimin fisnik që t'i frymëzojë për të hyrë nëpër observatorë jo si diletantë, por si konkurues, atje ku bota reale dhe virtuale shkrihen në një. Prandaj në 320 faqet e tij poliedrike, shoqëruar me figura dhe me formula, "Infiniti blu" sa është informues kurioz, në të njëjtën kohë është edhe formues serioz.

Në këtë mision të mundshëm, përmes një prerjeje të artë, letërsia dhe shkenca takohen si dy motra:

GIACOMO LEOPARDI
(1798 – 1837)
INFINITO - PAFUNDËSI

"... Cosi tra questa
Immensità s'annega il pensier mio:
E il naufragar m'é dolce in questo mare."
Faqe 86.

"... Kështu
Mes kësaj pafundësie shkimet mendimi:
Dhe mbytja më vjen e ëmbël në këtë det."



MENDIME FLUTURUESE

Poezi nga Klara Kodra

HËNA E 25 QERSHORIT 2021

Hëna e plotë na ndrin si të ishte ditë
Flakë e kuqe në qiell si luleshtrydhe
Luleshtrydhe që mbi ne pikon dritë.

JOLËS

Në breg të liqenit dikur të humbi kuklla.
Ti e kërkove gjatë e ta gjeje s'munde.
Pse je ndalur këtu? Ç'pret të gjesh sot?
Mbase fëmijërinë që s'do ta gjesh dot?

NDARJA

Rruga drejt njeri – tjetrit
si akull i ngrirë.
Dy zemra rrëzohen
Në rënie të lirë.

KUR TI VJEN NË ËNDËRR

Kur ti vjen në ëndërr,
Ma sjell fjalën e ëmbël,
Ma sjell fjalën e hidhur,
Unë kërkoj lakun
Ty për të të lidhur.
Laku këputet ....
Zgjimi është më i hidhur.

URA DREJT VËLLEZËRVE ARBËRESHË

Ura e ndërtuar mbi valë me fjalë
Në zemër e mendje na lëkundet ngadalë
Uji është shkrirë me gjak në këtë
urë me fjalë.
Valët duartrokasin me gishtërinj
prej shkume,
Përplasen, flasin, shtërngohen me njëra-tjetrën
shumë
Thonë fjalën "Vëllezër" që është
e ngrohtë valë.

Pyetësori "Librat e jetës sime"

BASHKIM HOXHA

Libri që mendoj se është i nënvlerësuar? Veçanërisht librat e autorëve shqiptarë

Libri që po lexoj ndërkohë

Përmbledhja me tregime "Të vdesësh në diell" e Ervin Nezhës. Po gjej aty një këndvështrim shumë interesant të këtij autori shqiptar, një stil konciz me mesazhe të thella të përcjella lehtësisht përmes historive njerzore. Një prurje e e re e bukur në letërsinë shqipe. Më nxiti që pas tij të lexoj librat e disa autorëve të rinj shqiptarë.

Libri që me ka ndryshuar jetën

Nuk mund të flitet për ndryshim jete, por më mirë të themi librat që më kanë formuar. Do të vecoja "Zorba" të Kazanzaqit. Jo vetëm këndvështrimi letrar, por edhe këndvështrimi për jetën i Aleksis Zorbas më ka bërë të mendojë thellë edhe përtej letërsisë. Po kështu "Neverinë " e Sartrit dhe "I Huaji" të Kamysë si dhe Kadarenë i kam lexuar ndoshta në kohën e duhur.

Libri që do të doja të kisha shkruar

Jam në kërkim të librave të nominuar për cmimin Manbooker Prize International. Sigurisht fituesin e këtij cmimi do të desha ta lexoja. Eshtë një ritual që e bëj cdo vit.

Libri i fundit që më ka bërë të qaj

Ndoshta jeta ka bërë të vetën duke më bërë të pandjeshëm, por kam harruar se kur kam qarë për herë të fundit nga një libër. Dikur, shumë, shumë i ri, kam qarë me Don Kishotin. Tani mbrrij vetëm tek trishtimi. Trishtimin e fundit e kam pasur me "Një fije shkrepse, një fije shprese" të Ag Apollonit.

Libri i fundit që më bën të qesh

Një libër shumë i bukur i Stefan Capalikut "Cdo njeri cmendet në mënyrën e tij", vecanërisht pjesa e parë. Për mendijmin tim, është një ndër librat më të bukur të letërisë shqipe.

Libri që më vjen trup që s'e kam lexuar akoma

Ka shumë libra. Biblën dhe Kuranin i kam lexuar në mënyrë fragmentare. Mirë do të ishte t'i kisha lexuar të plota.

Librat që kam dhuruar

Miqve të ngushtë sigurisht u kam dhuruar botimet e mia. Përgjithësisht nuk kam dhuruar libra të të tjerëve.

Libri me të cilin dua të mbahem mend

Para disa vitesh më mbanin mend prej Hotel ballkan. Ka kohë që më përmendin Kronikat e mjegullës. Kanë filluar të më përmendin Duatrokitësit. Unë nuk di t'i ndaj. Të gjithë janë librat e mi, ku unë kam shprehur njësoj veten. Nuk kam ndonjë përzgjedhje timen.

Libri që më bën të ndihem mirë

Ndoshta Don Kishoti. E lexoj herë pas here. Ka ikur koha kur më trishtonte dhe kur isha fare i ri më ka bërë të qajë. Tani, sa herë e lexoj më krijon një gjendje të mirë lehtësuese në përballjet e përditëshme me jetën.

Libri që mendoj se është i nënvleftësuar

Ka shumë libra të tillë. Vecanërisht librat e autorëve shqiptarë meritojnë më shumë vemendje. Mosvlerësimi vjen nga moslexim. Po të lexohen do të gjejnë vlerësimin e duhur.

RENESANCA E ZEZË

Ese nga Rexhep Ferri

1.

Për famën njerëzore, në kujtesën tonë, është një lexim.
Njerëzit me pozita shtetërore ëndërrojnë edhe ditën.
Më mirë se natën.
Natën i tremb frika ngapak.
Terri ua prish gjumin.
Çka është më e rëndësishme në jetë: të jesh i pasur, apo të jetosh e të vdesësh me fytyrë?
Kjo jetë nuk ka hapësirë tjetër.
Kur e dijmë dhe nuk e dijmë njeriu a ka vlerë tjetër?
Ka qenë pak i lumtur, por nuk e di a është ende i tillë.
Për të zbardhur fotografinë dokumentare, njeriu nuk e kupton historinë më pak se kaq.
Për ta shpëtuar jetën, për ta ruajtur fytyrën, çka është më e rëndësishme në jetë.
Kur liria nuk ka hapësirë lirie.
Mund të kërkojmë e të mos gjejmë pse jemi e ku shkojmë.
Për të përfunduar mirë, nuk di çfarë të them.
Asgjë nuk ka kuptim.
Jeta është kuptim.

2.

Në Sheshin e Qytetit çdo ditë kërcet tupani.
-O milet!
Të shohim, apo jo?
Sytë i kemi.
Çdo gjë ka marrë fund!...
Copat e qiellit të shtatë po na shoqërojnë.
Ato ende luftojnë për liri.
Ajo liri nuk është liria që e kemi pritur.
Mospërgjegjësinë nuk e kap asnjë ligj.
Deshëm apo nuk deshëm, maskës së zezë bizantine për Ballkanin e evropianizimin, veshët e gomarit i dalin.
Kjo meritë është krenaria e atyre që nuk janë askund.
Borgjezinë e pasluftës që nuk ishte askushi duhet ta kemi parasysh.
Duhet ta kemi parasysh këtë nivel kaq të lartë të ëndrrës mashtruese që nuk e kemi pasur kurrë.
Mes budallenjve jetojmë me dëshira të çmendura.
Vetëm hapësira e durimit përpiqet ta kuptojë fundin.
Dy mijë vjet ia kemi futur gjumit.
Harresa është lezeti i gjumit.
E dimë mirë se Zoti nuk i përdor këto fjalë.
Ai është i madh.
Kërkon fjalë.
Dhe, e dyta, deri sot hapësira trishtuese flet se si na i kanë marrë me dhunë pesë krahinat e atdheut.
Me nëntëdhjetë e nëntë për qind humbje.
Ku do të na çojë rrëfimi?
-Jeta është lëvizje, - ka thënë Aristoteli.

3.

Fytyra e njeriut me maskë çka paraqet?
Përsëritja është në shërbim të frikës.
Sot nuk dihet çka është rrenë e çka është e vërtetë.
Në këtë pikë nuk ka ndalesa të tjera.
Përtej vetvetes nuk shkohet.
Njerëzit nuk e prishin me pak qetësinë.
Dhe, nuk e teprojnë më shumë se shumë.
Nga përvoja fisnike e harrojmë poshtërsinë.
Shpesh ky qëndrim kushton e kushton.
Jeta është jetë e jo leckë.
Pse të mësohemi e të jetojmë me vetminë.
Urrejtjet shpesh po ia zënë vendin njëra tjetrës.
Njeriu nuk më frikohet nga ndërgjegjja.
Mospajtimi është luftë e humbur.
Ku është e ardhmja.
Le të dihet.
Ideali estetik nuk ekziston.

4.

Kemi shumë nevojë për lirinë.
Hapësirën e saj kurrë nuk e patëm të njohur.
Një njeri, patriot-mashtrues tha:
- Kush është i zoti le të del e të thotë: kështu nuk shkon!
Gjatë çdo lufte e pas çdo lufte asnjëherë s'do ta harrojmë se mashtrimi është një çmenduri, e bukur.
Pa dyshim: mashtrim.
Me një dritë artificiale harruam krejt çka kemi ditur për historinë.
Falë Zotit, mbetëm të gjallë.
Me frymën e kohës i kishim të qeshurën dhe seriozitetin.
Dy jetë të ndryshme në një kujtim.
Bëhuni të padukshëm.
Të paprekshëm.
Jeta nuk kuptohet me fjalë.
Sytë i kemi që të shohim e që të korrigjojmë dëshirat e natës pa gjumë.

5.

Nga po fryn era e çka po presim, nuk e dijmë.
Njëra nga pyetjet mund të jetë kush po na prinë dhe ku po shkojmë.
Kështu nuk shkon.
Asnjëherë jetën nuk e kemi përjetuar seriozisht.
Pse nuk ndihemi mirë me njëri-tjetrin, jeta kurrë nuk ka qenë fajtore.
Me dyshimet e zeza.
Me simbole të rralla.
Njeriu i pafytyrë, me merita e pa ndershme mburret.
Nëse rrugaçëria është vlerë çka mund të presim nga rrugaçëria.
Fytyrës çdo ditë e më shumë po ia qesim maskën fytyrës.
Si ta drejtojmë e si të sjellemi kur na ofrohen njerëzit sojli me maskë.
Pas një rishikimi rreth vetes u ndala.
Shikova hënën.
Ajo qeshi.
Errësira foli për sjelljet e njerëzve.
Zjarri që na priste në terr për një fjalë goje i mbylli sytë.
Në mes të natës, reagimet i kishim të trembura.
Për renesancën e zezë për renesancën e zezë.

6.

Një burim i energjisë artifikicale është shija e kohës së ardhshme.
Me sytë e pabesë.
Ata që i njohim dhe ata që nuk i njohim, zërin e fjalës e pyesim: çka të bëjmë me dashurinë?
Lojërat nuk kanë kufijë.
As drita artificiale nuk ka bukuri natyrale.
Mos u përpiqni ta kaloni kufirin.
Çfarë do të bëhet nuk e di.
Koha po ndryshon.
Për mirë, apo për të keq.
Nuk e di a do ta njohim dhe a do ta kuptojmë se sa kemi qenë naiv.
Mos merrni zjarr.
Bota do të vazhdojë si më parë.
Ne nuk e shohim veten se po ndryshojmë. Me buzëqeshje, duke qarë e duke u qeshur, nuk e kishe kornizën e kujtimit.

7.

Kush është trim le ta dijë: a ka apo s'ka Zot!
Duartrokitjet kujdesen që të mos shkojmë më larg.
-Fol! – tha një i pafytyrë.
-Çka të them? – e pyeta.
-Kush jemi?
-Afroma veshin!
-I treti është gjuetari!
Bota është e ndarë në të gjallë e në të vdekur.
Historia nuk gabon.
Flet.
Hesht.
Harron.
S'mbeti gjë: as nga fjala komb, as nga fjala mbret, as nga fjala kryeqytet.
Hasan Jevgu çdo ditë i bie tupanit dhe kërcen vetë.
S'ka Zot.
Ka mbret!...
Ka Zot...

NGA KRONIKA E NJË GAZETE

Tregim nga Qazim Shehu

Në kronikën e zezë të një të përditshmeje, lexova se, Tani, shoku im i fëmijërisë, ishte vrarë. Kishte zbritur në qytet si përkrahës i partisë opozitare dhe qe përleshur me policinë U ndjeva ngushtë dhe më erdhi keq. Po s'e kisha dëgjuar më parë këtë ngjarje?Unë i marr rregullisht gazetat, por më shumë lexoj lajmet kulturore, opinionet, intervistat. Dhe kjo kishte pak kohë që kishte ndodhur. Duhej të shkoja patjeter për ngushëllim.la njihja mirë të atin... Me shpirt ndër dhëmbë, rriti tre djem e dy vajza. Të shkoj sot apo nesër, duke pasur një barrë hallesh të përditshme, kjo punë u zgjat ca.

Një ditë mora mundimin duke ndierë detyrimin dhe u nisa drejt qytetit tim. Kur zbrita në qendër të qytetit të vogël, kërkova me sy ndonjë krahinar të pyesja për ngjarjen, po çuditërisht, sikur të më fshiheshin, nuk pashë njeri. Edhe vetë, më vonë, nuk e quajta të udhës të pyesja më për demonstratën e madhe apo për Tanin e vrarë. M`u krijua një rëndesë shpirtërore edhe pse i kisha kaluar çastet e rënda të fillimit,që vinte e më shtonte një keqardhje të kuptueshme. Të vritet njeriu për partitë, është një çmenduri, kur dihet se ato janë si bajga e lopës e ndarë më dysh, siç thotë një analist injohur. Megjithatë, Tani e kishte pësuar, ndoshta edhe rastësisht. Nganjëherë njeriun e kap edhe vala, duke bërë soditësin. Eh, i shkreti Tan, psherëtiva…

Këto mendoja, ndërsa kisha mbështetur ballin në xhamin e furgonit dhe shikoja peizazhet e qeta malore që ndërroheshin me shpejtësinë e ecjes së makinës. Kur zbrita në qendër të komunës qëndrova një çast në këmbë, vura dorën si strehë në ballë dhe pashë në largësi. I ngjeshur me horizontin, ishte edhe fshati im. Do të udhëtoja dy apo tri orë me këmbë. Më tepër se lodhja ,më vriste e më shtangte pak në shpirt, ideja e rrugës si mërzi. Duke u tërhequr nga një dëshirë e padukshme, u futa në një klub aty afër. Mbase takoja ndonjë banor të fshatit tim dhe e bënim rrugën bashkë. Lokali ishte plot me djem të rinj, që pinin birrë. Kishin ardhë për festat e Krishtlindjeve nga emigracioni. Të veshur me rroba të shtrenjta, tek- tuk e shpërdoronin gjuhën shqipe, duke e gërvishtur me fjalë të huaja. Në qafë u ndrisnin zinxhirët prej floriri, përfund të cilave varej kryqi si modë .U ula në një tavolinë dhe porosita kafe. Nuk vonoi kur i zoti i klubit, që mbante një bllok të vogël e laps, herë të mbërthyer në buzë e herë në vesh, më solli një birrë të madhe.

-Çne!- thashë, duke e shoqëruar fjalën me gjestin e habisë.

-E ke nga ata çunat.

Tre djem me mjekër të zezë, të prerë spic, më panë.

-Të bëftë mire!- tha njeri.

-Faleminderit.

-Pije mos ki dert, sot kanë qerasur gjithë kalimtarët,- më tha pronari i lokalit.- Janë çunat e fshatit. Kanë dhjetë vjet në Itali.

Po pija birrën ngadalë duke medituar. I zoti i lokalit u ul pranë tavolinës dhe më zgjati një cigare me dashamirësi.

-Lokal të bukur paske ndërtuar,- thashë, më tepër, për të zgjatur bisedën.

-Çunat, mre jahu! Çne unë!…Me pensionin e kooperativës do ta bëja? Po shyqyr zotit, s'duhet me u qa.

Dikush e thirri dhe ai u ngrit me rrëmbim. Mblodhi kanaçet e boshatisura të birrës, shpejtoi t'i hidhte në një kosh dhe, pa e ulur ritmin e ecjes, u çoi tri birra të tjera.

-Edhe dy birra për ju.

-Jo!- thashë unë, -pa e pirë ju një nga unë...

-Jo, mor lal, s'bëhet llaf. Hap edhe pesë konserva, Sefer, se nuk pihet thatë...

-Jo, jo, - tha njëri,- s'i ha konservat.

Por, Seferi, kështu duhej të quhej i zoti i lokalit, i kishte hapur ndërkohë. Ndjeja një si bezdi që kisha hyrë aty, por ata po me sajdisnin, kështu që bezdia u harrua pas një çasti. Muzgu ishte parashutuar pa e kuptuar, por duhej të pija edhe birrën tjetër e të haja konservën. Ndryshe djemtë do të fyheshin. Por edhe natën mund të udhëtoja. S'e vrisja mendjen për këtë. Në çantë kisha një elektrik dore.

Në lokal hyri një fshatar.

-Erdhe prapë ti, Tafë?-i foli Seferi.

-Po, o Sefë. Të solla lekët e veresijes. Sot mora pensionin...

Seferi i mori lekët nga duart, duke e pyetur:

-A i ke numëruar mirë?

-Me allahilexhane...

Plaku qëndroi në këmbë, priti që Seferi t'i numëronte, por kur pa se ai i futi paratë në xhep, bëri një prapakthehu të ngadaltë dhe nisi të dilte nga dera. Por tre djemtë e thirrën:

-Hej, xhaxha, pije diçka nga ne!

Plaku vuri dorën si strehë mbi ballë, sikur ai zë t`i dukej si tallje.

-Ç`na shihni ashtu, s'jemi hajdutë!

I gatshëm si gjithmonë, Seferi i solli birrën dhe ia la në dorë. Fshatari eci drejt banakut, vendosi birrën mbi të duke thënë:

-Nuk mundem me pi më!

Pastaj doli nga klubi dhe m'u duk se shpatullat e tij të të rrëgjura u kërrusën edhe ca.

Kur dola nga klubi, ndjeva të ftohtin e dhjetorit dhe kokën pakëz të rënduar. Pashë dhe një herë orën, horizontin, Ilogarita me mend rrugën, dhe e kuptova se më tepër se gjysmën e saj do ta bëja në errësirë. Pata një dëshirë të kthehesha sërish në klub, të pija e të pija, për të harruar vdekjen e Tanit. E kisha bërë me dhjetëra herë atë rrugë, po kurrë në një buzëmbrëmje si kjo. Natën, ditën, në vapë, zheg, acar. Ndjeja një pendim, makth, dëshirë për të mos ecur. Megjithatë, u nisa duke kapur lakadredhat e rrugës, si në një lojë me litar. Anës saj rrinin lisat e vetmuar si dëshmitarë fillikat të qindra hapave që rruga i shënonte dhe i fshinte duke i thithur në harresën e heshtur.

Kur dola në luginë, andej nga vinte lumi, pothuajse mbrëmja ishte dendësuar, për t'u bërë natë. Lumi rrëshqiste butë-butë, duke ecur ngadalë, për t'u përplasur në dy gryka të ngushta, pak më tutje, të cilat unë i lija pas shpine. Sa herë isha larë në atë lumë bashkë me shokun tim! Tani notonte mirë. Më kujtohej sesi një herë u zhyt në një guvë të thellë të lumit për të kapur një peshk, por kapi një gjarper uji. Gjarpri për pak e kafshoi. Tani e lëshoi me lebeti, u zverdh, mblodhi veten dhe u zhyt prapë, por peshkun nuk e kapi. Mua m'u duk se peshku ishte vetëm në mendjen e tij. Lumi ishte fëmijëria jonë, me moskokëçarjet, aventurat, notin, dinamizmin e brishë, që platitej shpejt.

Po ecja tani bri tij dhe më dukej se krejt trupin e kishte futur në një këllëf mitik, të cilin nuk e shihja. Herë më dukej se flinte e herë se ishte zhdukur fare, i përpirë nga një kujtesë vitesh. U ula në një gur dhe ndeza një cigare. Lumin e kisha lënë në të majtë dhe kujtimet për të ma kishin hequr stresin e vetmisë në rrugë, kur papritur shqova një vend që më tregonte se kisha hyrë në fshat. Ishte errët, gisht në sy, drita e elektrikut krijonte një brez verbues, duke e prerë errësirën pamëshirshëm. Po ngjitesha në shtegun e një kodre, shpejt e anashkalova me shpejtësi, ngaqë m'u duk se diçka po më ndiqte pas. E dija se ishte ankthi im, po emocioni ishte më i fortë se mendimi. Mos vallë ishte hija vdekëtore e Tanit. Mornica më shkuan nëpër trup.

Vonë trokita te porta e kullës së Tanit, po m'u duk se kisha gabuar. E ndriçova me dritën e elektrikut. Shtëpia e vjetër nuk ishte më. Babai i Tanit kishte ngritur një të re. Fjollat e dritës ndriçonin, një gjysmëvilë të hijshme, që bëhej më hijerëndë në errësirë, më e largët, ndoshta më e bukur dhe e pakapshme. Trokita sërish dhe po mendoja sesi do t'ia shëndoshja kryet babait të Tanit, i lodhur dhe në një platitje të rëndë ndiesish. Fati i kishte lënë edhe dy djem të tjerë. Po çdo gisht që të presësh, dhemb.

-Urdhëro, urdhëro...dëgjova një zë nga brenda.-Hajde, mire se erdhe!...;fshatari kurrë nuk e pyet të panjohurin pas dere për emrin. Ai e di se në shtëpi troket gjithmonë miku ose udhëtari i vonuar.

I ati i Tanit më njohu menjëherë.

-Pse natën, bre djalë!? Nata është e dreqit. I thonë: natën rri ku të jesh e ha çfarë të kesh...

-Po, ja...

Ngjita shkallet e katit të dytë dhe u gjenda në një dhomë të madhe me oxhak. Dhoma ishte mobiluar me kolltuqe të bukur; ai më mori çantën dhe e vuri mbi një mobilje të errët. U ul afër meje dhe më pyeti për gjithçka. Në fytyrë kishte një tis të hollë ëmbëlsie. Energjia e lëvizshme e tipareve e theksonte vrullin e tij të të shprehurit. Ndërsa unë rrija disi i stepur, duke u ndërmenduar sesi ishte e mundur qe ai ta kishte kaluar me aq lehtësi vrasjen e të birit. Dikur do t'ia thoja këtë mendim, po vetëm pasi ta shtronim fjalën e të gjeja rastin e duhur, për të mos e prekur.

Ai u ngrit, kërkoi nje shishe në morinë e ca shisheve, e pa me kujdes, kërkoi një gotë, e gjeti dhe e mbushi dhe ma vuri përballë duke më thënë:

-Pije, se je lodhur!

Ishte uiski.

-Që kur ju fshatarët e paskeni ndërruar rakinë me uiskin?- pyeta, por u pendova në çast.

-Ma ka dërguar djali prej Anglie...

Nuk dija ç'të bëja, sipas traditës duhej të më bënte një kafe, madje të hidhur, por ai ndezi televizorin.

-Është ora e lajmeve,- tha. -Unë vetëm lajmet dëgjoj...

Heshtëm ca minuta se po dëgjonim lajmet, kur në dhomë hyri Tani. Ishte veshur me një kostum bezhë, që drita e theksonte në të bardhë.

-Tan!-bërtita, ti je?!...

M`u duk se u turr drejt meje, s'ishte kështu, por fiksimi im. U ngrita dhe u ula sërish në kolltuk. Ndjehesha i pafuqishëm dhe i mpirë. Tani rrinte përballë meje, buzëqeshte lehtë dhe u përkul mbi mua me një ndienjë malli të largët, i habitur paksa, se klithma ime nuk ishte një klithmë malli,por me një ngjyrim të fortë lebetie….

Një roman që lëviz midis mitit e historisë dhe përshkruan botën e brendshme të një ëndërrtari me elemente realizmi, surrealizmi e realizmi magjik, përmes të cilave shfaqen mesazhe të thella.
Një nga personazhet e romanit është shkrimtari Ismail Kadare.

Niko Kacalidha

ËNDËRRTARI I NATËS

Fragment nga romani me të njëjtin titull

Përktheu nga origjinali greqisht Aida Karanxha

Teksa lëvizte me ngadalë, si një balenë e vogël, Petro trashaluqi, që gjithë natën kishte shestuar me ngulm rivënien në skenë, si në ëndërr, të lëvizjes së kalasë, tani po zbriste me kujdes nga lartësitë e vegimit dhe ulej në luginë. E kur gjithë të tjerët talleshin me veprat që ndërmerrte plot pasion, atë e mundonte një brengë e thellë dhe vuante, tek linte pas qytetin e murgët dhe shoqëronte mendërisht, drejt luginës, qerren e diellit, thyer më dysh nga pesha e kalasë populluar me hije, e cila nga lëvizjet e kërcëllimat e rrotave të saj, herë binte nëpër gropa e herë ngrihej prapë.

Përsiatjet dhe labirintet e mendjes e hodhën tutje, dhe tek flatronte sipër reve, i zhytur në shtrëngatat leshtore të kujtesës, diku u pengua nëpër shkurre e gëmusha plot gjemba, iu zgjidhën lidhëset e këpucëve të vjetra ushtarake, të ngrëna vende-vende, u pengua, ra me fytyrë përtokë, hapi krahët, përqafoi tokën, rrëmbeu baltën e zezë me thonj e me gishta dhe iu duk se tani ishte luftëtari i fundit, një i dështuar, një vrapues i pështirë që, në garë e sipër, frymëprerë, ishte shembur për tokë para shumë kohësh, e s'i kishte dalë koha a s'kish mundur të arrinte në pikëmbërritjen e tij, për të lajmëruar ngathënjimin e hareshëm me fjalën «e korrëm fitoren».

Edhe besonte edhe s'besonte te mrekullitë dhe dukuritë e mbinatyrshme. Shpesh herë, ato i ngjanin me përralla. Kërkonte gjetje të papara ndonjëherë dhe sajonte mrekullitë e veta ëndërrtare, herë me pamje vegimore, herë me fantazi.

E ja, ktheu prapë kokën pas, se diç vetëtiu sipër e pa një ylber që kish prurë një frymë e një rreze drite mbi qytetin e lëverdhë, hedhur si hark, si të ishte ndonjë urë e stërmadhe gotike apo hark triumfi me famë, harpë gjysmëhëne a hark ure i përmbysur në pasqyrimin e vet, një kurorë drite sipër kalasë, e në thellësi, me sfond malet gjigande, s'pa vetëtima, bubullima e tallaze, por portretin e një djaloshi varur aty sipër, me syze të zeza, që lartësohej mbi çdo majë përreth e dilte nga shkëmbinjtë e thepur e të djegur, që kishte filluar të avitej dhe sa më shumë i avitej, aq më qartë i shquheshin tiparet. Ai s'donte ta mishëronte në një bashkëudhëtar të veçantë, por sa më shumë avitej, si të kërcente nga portreti, duke u bërë prej mishi e gjaku, djaloshi merrte tjetër pamje. Kishte shtat mesatar dhe flokët e ngritura përpjetë si antena kryeneçe, të cilat ishte e qartë se i kishte, ngaqë jepte e merrte me lartësitë, malet, muret, shrëngatat tallazet, me gjithë ato madhësi, ngado që ta ktheje kokën. Sytë nuk i dukeshin, por diç fshihnin pas atyre syzeve pis të zeza. Prapëseprapë, rrinte me buzë në gas dhe, që prej fjalëve të para të bisedës së tyre, e ndjeu se kishte të bënte me një djalë të mençur. U çudit sesi i bëhej që ai qytet mbrujtur me ankth, me rrugët e përpjeta shtruar me gurë dhe kalldrëmet e tij, rrjepur nga zvarritjet dhe zinxhirat e atyre që çapiten drejt vdekjes, drithëruar nga gjykimet e pafundme, rënkimet, torturat, ekzekutimet, goditjet e fundit dhënë në lule të ballit, mbi zhavorrin e gjakosur, të ishte vendi ku i ishte rënë koka.

Këtë portret si pamje fantasmagorike që i kishte dalë përpara, askush s'ia kishte paraqitur. E tek rënkonte vazhdimisht e qahej, iu duk se ky djalosh i mençur e krenar, e njatjetoi dhe i foli : «Përshëndetje».

«Diku të kam njohur ty, more djalë», u përgjigj Petrua. «Apo më mirë ta them si në ëndërr se kam bindjen se, edhe në s'të pata njohur, pas pak kam për të mësuar se kush je».

Djaloshi i mençur e mundi me buzëqeshjen e tij dhe Petrua zuri të ndjente mirënjohje, si për praninë e tjetrit, ashtu edhe për bisedën e tij të çiltër. Kjo, sepse gjithë të tjerët, sa e shihnin dhe i kalonin përbri, e quanin për të marrë, i shmangeshin, i hapnin rrugë dhe e përqeshnin.

«Të gjithë më tallin, biri im, për pronësinë e kalasë. S'ka ngelur njeri pa më thënë se e ka të babait ; më kanosen se do më zhdukin nga faqja e dheut, në ndodhtë që ta prek e ta lëviz nga vendi».

Djali ia dha me të madhe dhe i bëri shenjë të vazhdojë, se, siç dukej, i pëlqeu fantazia e tij.

«Vazhdo rrëfimin», ia ktheu, « se është shumë tërheqës ky version donkishotesk i rrëmbimit të kalasë».

«Si të thonë? Kush je ti, mor bir», pyeti, «meqë të pëlqyeka versioni im fantastik? Mos je edhe ti ëndërrtar e sheh vegime si puna ime?»

«Ismail më thonë», iu gjegj djali « e ma ka ënda edhe mua të dëgjoj të tilla rrëfenja. Kam edhe unë fiksimet dhe neurozat e mia për mitet, malet, urat e kështjellat».

«O, shoh se po na puqet ylli», iu kthye Petrua. «Më së fundi, u gjend dikush që të kuptojë zanafillën e rrëfenjave të mia. Pa më thuaj, biri im, ç'je ti, turk a i krishterë? Të pyes se tani ky qytet ka marrë të tatëpjetën. Nga dita që ra kalaja e Argjirosë në duar të Turqve u çbë e po kthehet në besimin e tyre».

«Për ëndërrtarët, s'ka pikë rëndësie as gjenealogjia dhe as besimi", ia priti djali me syze të zeza e flokët e ngritura përpjetë. "Të parët tanë ishin të gjithë të krishterë dhe vonë e kthyen besimin,

si dhe shumë të tjerë në qytet. Si dëshmi për ç'të them është se një nga degëzimet e pemës sime gjenealogjike u shkul dhe mbajti fenë e krishterë, kurse tjetra u bë myslimane».

«Më fal, mos ma merr për keq. S'të pyes për gjë tjetër, biri im Ismail, sepse si për mua si për ty, s'ka rëndësi feja. Le të besojë ku të dojë njeriu. Nga kureshtja të pyeta se emri yt e ka prejardhjen nga Dhiata e Vjetër».

«S'ka rëndësi emri, Petro, ëndërrtar i natës», i tha.

«Mos e thuaj atë fjalë. Emri i vihet njeriut që sa del në dritë. S'ka në këtë botë njeri të paemër. Si s'paska rëndësi emri! E, që thua ti, emrat kanë kuptimin e vet. Vëri veshin fjalës që po të them, biri im, se është interesante. Bëhet fjalë për Shkrimet e Shenjta. Ti dhe unë kemi emra të shenjtë e, meqë dolëm nga Dhiata hyjnore, Zoti na ka taksur të bëjmë mrekullira».

«I gjori ti», tha nga brenda djali, «të lanë trutë e s'i vë dot fre fantazisë tënde. Pa më thuaj, si do ta marrësh kështjellën, me luftë do ta fitosh, sikundër Turqit kalanë e Argjirosë?»

«Do ta marr një natë, qoftë me mot të trazuar e stuhi dëbore, qoftë një natë pranvere me hënë. Do ta vë përpara dhe do ta shtyj deri në mes të luginës».

Një turmë kalamajsh që kalonin atypari, dëgjuan bashkëbisedimin për marrjen e kalasë e bërtitën me të madhe: «Jo, jo, askush s'ka për të na e marrë kalanë. Askush s'ka për të na e marrë qytetin. Çelësat i mbajmë ne, i kemi të fshehur e të mbyllur me shul. Askujt të mos i shkojë mendja se mund të na i vjedhi. S'kemi për t'ia dhënë askujt, as çelsat e portës së madhe të kalasë, as ato të deriçkës së vjetër. Vetëm Turqit e morrën kalanë nga deriçka, por edhe ata e hëngrën kokën e u mbyt vendi me çallma».

«Leri të flasin fëmijët», ia ktheu Ismaili, «janë të vegjël e luajnë. S'ia kanë idenë se për ç'çelësa e kemi fjalën ne të dy. Çelësat e qytetit dhe ato të portës së madhe të kalasë i mbaj vetë. E për më tepër, janë prej ari njëzet e katër karatësh dhe i mbaj të fshehur në sëndukun e vjetër aristokratik të gjyshit tim. E kam urdhër të prerë të mos t'ia dorëzoj askujt, se është mbushur vendi me kusarë e, po të duan, mund të na i vjedhin brenda një nate shtëpitë prej guri. Por do ta bëj një përjashtim për ty, se je njeri i ndershëm. S'je dredharak. Po t'i dorëzoj, se unë nuk e kam vendin këtu. Do të nisem për në vise të largëta që më presin. Mos ia u vër veshin të tjerëve që rrinë e thonë se do prishet bota po e fute në dorë kalanë tonë. Merri që të dyja. Vërtet, pse s'i merr të dyja, ëndërrtar i natës, meqë do të të duhen? Bëje tënden edhe kalanë, edhe qytetin. Kjo kështjellë e ky qytet s'janë prej lënde, s'është baltë, s'është ujë, s'është gëlqere, s'është gur. Është mit që buron nga thellësia e mjegullës dhe afsh që del nga fryma e shpirtit tonë. Shpirtrat janë të të gjithëve. Edhe tuajat, edhe tonat. Sa e sa erdhën e shkelën këtu, por s'mundën ta shkulin legjendën që del nga skurpujt e mjegullës dhe të shpirtit tonë. A mund të shkulet fryma dhe tempulli i shpirtit tonë? Jo, s'shkulen dot. As legjenda e Argjirosë».

«More biri im, edhe unë i bëj punët dhe sprovat e mia duke qëndruar pas frymës, tallazit dhe stuhisë. E që të të tregoj të vërtetën, të betohem mbi këtë baltë ku shkelim, se të gjitha vegimet i shoh përmes mjegullës, pa ditur se ç'do më sjellë e nesërmja dhe ku do më shpien planet e mia, ç'kalime, ç'monopate e ç'shtigje dhish do marrin. E tek më shfaqet vegimi i një ure që hidhet mbi det, teksa përsiat natyrën dhe rri e mendoj lëvizjet e ardhshme, ja tek m' u fanepset një kështjellë mbushur me fantazma e shumë e shumë të tjera, të cilat dorëzania e punës time nuk më lë t'i shpreh. Kam bërë be të mos e tradhëtoj kurrë orën e shenjtë të krijimit. Përndryshe, kanë për ta humbur shenjtërinë e tyre të fshehtat e laboratorit tim. Gjithsesi jam si të isha pas një tymi a mjegullie dhe s'e di as vetë ku po shkoj -ku të më nxjerrë udha vete- ku të më nxjerrë fryma e shpirtit dhe mjegulla e mitit shkoj dhe kërcej gur më gur, sidomos nga nata në natë. E vazhdoj gërmimet dhe veprat e mia. Nata është pjesa më e qartë e trurit tim, ndihmësi më i mirë».

«Po t'i dorëzoj, o njeri mendjehollë, ja ku po t'i hedh para këmbëve, bëj ç'të duash me to. Edhe të deriçkës, edhe të portës së madhe të kalasë ; çelësat e gjithë qytetit».

«E kam kuptuar, biri im, se je i mençur dhe pak i shkarë. Shembull për t'u ndjekur. Të punon truri për gjithçka. Po ama këtu e ke gabim. S'jam unë njeriu mendjehollë. Ku ta gjeja ta kisha mendjen aq pjellore sa ç'e kishte mendjeholli. Mos më thuaj më mendjehollë. Petro Kryemjeshtri të më thuash. Ku unë e ku Odisea. Përsa i përket kalasë, s'kam për ta plaçkitur, se është prikë e sime motre, Argjirosë. Unë vetëm do ta shtyj nga pas dhe do ta zbres në fushë që të shohë edhe ajo diell me sy. Dëgjo se kush është mendjeholli e ç'thotë Homeri për Odisenë :

Rrëfemë, o muzë, bëmat e burrit mendjehollë
që Trojën si plaçkiti, të shenjtën kështjellë
për shumë vjet u end, dhe pa dhéra pambarim e popuj
dhe zakone, vuajti dhe hoqi si askush më parë
që dallgëve t'iu shpëtonte dhe shokët gjallë t'i kthente.



«Ti s'qenke vetëm si të kesh dalë nga pena e Servantesit, more i uruar. Qenke edhe homerik. Qenke vegimtar i paparë. S'ma priste mendja kurrë se do të shfaqej një tip homerik e do të zinte të recitonte Odisenë në këtë qytet të gurtë. Besoj tek ty, mekaniku e arkitekti im. Je i lirë të bësh ç'të të dojë zemra me kalanë. Je nën mbrojtjen time e askush s'do të guxojë të të prekë. S'ua kam frikën as rrëmbimeve, as kuajve të hamendësuar të Trojës, as të tjerave se do t'i marrësh e do t'i çosh përtej. Qofsh dhe vetë Odisea. Ai pati peripeci në det, ndërsa ti kërkon tokë dhe baltë».

«Homeriku duhet të jesh ti, mor bir. I vetmi që më kuptoi në gjithë këtë qytet. Por ende s'i ke marrë vesh shestimet e mia. O sa po më zhurmon koka nga hallet. S'kam vetëm kalanë. Kam një sërë veprash për të përfunduar : urën mbi det, ujërat dhe kanalet nëntokësore, përbindëshat e gjallë dhe të vrarë».

«Mund të bësh ç'të duash me çelësat e portës së kalasë dhe të qytetit. Të hysh e të kërkosh ku të duash brenda në thellësirë. Në korridoret e ngushta e nëpër bodrume. Mjafton t'i vlerësosh. Të bësh diçka më të mirë. A mund të shkruash një Odise? A mund të ndërtosh një Partenon? A mund të ngresh Kullën e Eifelit? Kam besim tek ty, meqë mendjen e paske me vegime. Nëse më duhesh ndonjë ditë, do të të gjej e do të t'i kërkoj prapë çelësat e qytetit».

«O, ti që më dhurove me kaq bujari çelësat e qytetit, prano falenderimet e mia. Por, për të mirën tënde, që të mos të të padisin bashkëqytetarët e tu, duhet të më japësh një kopje. Origjinalin mbaje për veten».

«S'kanë rëndësi çelësat, por qenia. E kjo është e fshehur brenda meje. Origjinalin e ruaj përbrenda e askush s'mund të ma vjedhi. Kudo që të shkoj, do ta kem me vete, strukur në gji. Qytetin dhe kalanë i kam të ruajura në vetvete e ç'lashë këtu ta jap bujarisht ta bësh ç'të duash. Sidomos kalanë. Të gëzojë edhe ajo një ditë të bardhë nën diell, në mes të luginës, se u myk këtu brenda, mes luftrash.

«Ja tek ramë dakort, djalë i mençur e ta dish se s'jam as kusar, as dhunues varresh, as merrem me sende të vjedhura. Çdo gjë do të bëhet hapur. E gjithçka gjë do ketë për qëllim përparimin e kësaj kalaje».

«Merri të gjitha, epiku im, tragjiku e komiku im i marrë. Shtoju a vlerat. Vetëm të pamësuarit tremben nga naivët që shohin ëndrra me sy hapur dhe nga vjedhësit e pafajshëm. E ku vidhet qyteti! Kalaja dhe qyteti janë të të gjithëve. Do t'i shohësh dikur kur të dalin sheshit. Të gjitha këto i kam të ruajtura përbrenda, të mbajtura shënim me hollësi dhe të regjistruara. Ndonjë ditë, kur të ma dojë puna, do t'i shfaq me personazhe e me pamje dhe do të kuptosh se s'të gënjeva kur të thashë se askush s'mund ta vjedhë qenien time, se është e gjitha brenda meje. Kam edhe unë të çmendurit e të mençurit e mi. Të dhurova kalanë dhe qytetin që të merresh me ato si t'i kesh trashëguar nga yt atë, me idenë që t'i shpëtosh nga papastërtitë dhe myku që as unë s'kam për t'i fshehur, mes sa e sa bëmave të tyre. Eja ta shtyjmë bashkë kalanë, se ndoshta arrin më shpejt në pikëmbërritjen e vet».

«Njëri në të djathtë e tjetri në të mëngjër, nga pas, që të mos na rrëshqasë», u hodh Petrua.

«Jo, jo», ia ktheu djali i mençur, «më mirë të mos ngatërohemi e të mos pengojmë shoku-shokun, duke ngatërruar kofshët se na kapin rrotat pastaj. Ti shtyje kalanë për veten tënde drejt diellit të luginës sate. Unë do ta shtyj kalanë time drejt lartësive të mia. Sidoqoftë, që të dy shkojmë drejt diellit për të gjetur shpëtimin, apo jo? Nga ana tjetër, ne s'do të ngremë emblema. Nëpër këto kala të marra s'është nevoja të ngrihen emblema. Në kohën e rrethimeve sigurisht ishte e nevojshme të ngriheshin emblema. Por tani, në pamjen e tyre tragjiko-komike e grafike, s'iu duhen më flamuj, as të bardhë, as të kuq, as të zinj, as të kaltërt».

«Ik ti biri im, shko ku të duash e merru me ç'të të dojë zemra. Mos mendo se unë do të rri këtu mes therrtoreve e paçeve. Do të iki larg dhe nga larg do të jem me mendje në këtë qytet të çuditshëm prej guri. E unë, biri im, meqë mora lejen tënde, jam perandori i fandaksur dhe zyrtar i kalasë, por të më falësh që s'po i përmbahem pikë për pikë trofeve me simbole që i njeh gjithë bota. Unë kam një mik të mirë, Lefterin, i cili bashkë me Nanon, që është shoku im tjetër i ngushtë, kapërdijmë shpejt e shpejt dhe pa humbur asnjë fije kohë, supën e peshkut përherë në të njëjtën taverně dhe, pasi merremi vesh me shikime të shpejta, secili vrapon në postin e vet, ai në breg të detit me kavaletën e dorës, me pinelet e ngjyrat e tij, ndërsa unë te stoli me mendimet e mia dhe qelitë e mia murgjërore. Do t'i përgjërohem të më vizatojë, mbi vel të bardhë, një qiell pa re, një det, një kala, një perëndim dielli të kuqërremtë dhe një dorë dhé, që t'i var si emblemën time mbi kala».

Ismail Kadare

KUSHËRIRI I ENGJËJVE

Sprovë

Sprova "Kushëriri i engjëjve" është shkruar në Marbella të Spanjës, më 1991dhe përbën pjesën e parë të një libri të botuar nga Qendra e Baletit Europian, kushtuar balerinit dhe koreografit të madh francez me zanafillë shqiptare, Angjelin Preljocaj.

Midis këshillave që u japin grave gjatë kohës së shtatzënisë është harmonia e lëvizjeve, shmangia e zhvendosjeve brutale, e hedhjes, e kapërcimit, si dhe paqja shpirtërore, që lidhet, siç thonë mjekët, me shëndetin shpirtëror të fëmijës së ardhshëm.

Kur Lizë Preljocaj, nëna e Angjelin Preljocajt, e kishte në bark Angjelinin e vogël, ajo mund t'u jetë përmbajtur mjaft këshillave të mjekëve ose të grave që luanin rolin e mjekëve në raste të tilla në vendet ballkanike, por një natë ajo bëri diçka të kundërt me çdo lloj këshille e higjiene të një gruaje shtatzënë. Një natë, pra, të vitit 1956, ajo, bashkë me të shoqin, kapërcyen fshehtazi kufirin e shtetit shqiptar.

Në qoftë se kalimi fshehtazi i kufirit të një shteti diktatorial është, gjithsesi, një aventurë e tmerrshme, dyfish e tillë ka qenë kjo në kufirin shqiptar. Ai ka qenë një kufi tragjik, ku qindra njerëz kanë lënë kokën, të grirë nga plumbat, të mbytur nga ujët e zi, ose të ngrirë nga acari.

Ecje me orë të tëra nëpër terr (nata e arratisjes zgjidhej përherë sa më e errët), këmbë që dridhen nga lodhja, tmerri i diktimit prej rojave, torturë e së panjohurës: arritëm, s'arritëm (shumë njerëz janë marrë më qafë në metrat e fundit të rrugës, ngaqë para kohe janë gëzuar, duke kujtuar se kanë kapërcyer matanë, në kohën që ende ndodheshin në tokën shqiptare), të gjitha këto, të shoqëruara nga lehja e qenve, nga ankthi, i ka përjetuar, ashtu si qindra të tjerë, Lizë Preljocaj. E bashkë me atë ankth të pakrahasueshëm me asnjë tjetër, në ato orë të rënda ajo, si gjithë arratiaket, ka ndier, herë pas here, ëndrrën në mos të fluturonte, të ecte sa më shpejt, me sa më pak zhurmë, mundësisht të mos shkelte mbi tokë, të rrëshqiste e lehtë si pupla, si zogu, për të mundur kështu që të kapërcente nga një realitet në tjetrin, shkurt, midis atij ankthi, ajo ka ndier dëshirën të ecte *ndryshe*.

Meqenëse, siç thonë, gjatë kohës së shtatzënësisë gjithçka e nënës kalon te foshnja, ndoshta në ato çaste plot trysni, më fort se në një trashëgimi gjenetike, Angjelinit, që ende ishte në bark të nënës, i kaloi kjo dëshirë, ky kumt, kjo ëndërr: të ecte, të lëvizte *ndryshe*.

Por një ecje *ndryshe* s'është veç vallja.

Kumti i erdhi foshnjës nga jashtë, në një mënyrë tragjike. Dhe, ndoshta, nëpër të gjitha skenat e botës, ku ai vallëzon ose ndërton spektaklin e vallëzimit, pa e ditur as vetë, s'bën gjë tjetër veçse i bindet atij kumti, domethënë ripërtërit kaosin e asaj nate, atë makth e atë lëvizje misterioze nëpër terr, ku vdekja të ndjek e ti përpiqesh t'i ikësh, për të dalë në zonën e dritës.

II

Ngritja e njeriut mbi dy këmbë, kjo shkëputje e tij madhështore nga bota e kafshëve dhe lëvizja e tij ndryshe, quhet, me të drejtë, si shkalla e parë e ngjitjes së këtij princi të planetit drejt fronit ku ai u vendos, për të mos u rrëzuar më.

Kur miliona nxënës nëpër shkolla mësojnë evolucionin e trupit njerëzor, kur shikojnë sidomos skicat ku tregohet si ecte njeriu primitiv, si shpina e tij e kërrusur u ngrit dalëngadalë nëpër shekuj, gjersa arriti në gjendjen e sotme vertikale, shumë prej tyre, me fantazinë e ndezur fëminore, bëjnë pyetjen: e sikur njeriu të ngjitej edhe më lart? Me fjalë të tjera: sikur njeriu të fluturonte?

Meqenëse fantazitë fëminore qëndrojnë shpesh në bazë të shumë akteve të mëvonshme të njeriut, edhe ëndrra e fluturimit ka pasur zhvillimin e saj. Ajo ka qenë në dy kahje. E para, ëndrra që njeriu të fluturonte vetë. E dyta, të fluturonte me një mjet.

Qysh në kohërat më të lashta, pra, edhe atëherë kur njeriu e kishte fantazinë më të pafré, ai e ka përjashtuar fluturimin e trupit njerëzor. Fluturonin hyjnitë, shtrigat, fantazmat, erinitë, por kurrsesi njerëzit. Për sa i përket fluturimit me mjet, ky, ndonëse nuk këshillohej, s'përjashtohej. Miti i Dedalit, shestuesit të krahëve fluturues, dhe Ikarit, birit të tij, i cili kokëshkretë siç qe, guxoi më shumë se ç'duhej, ndaj dhe u vra, njëlloj si pilotët e sotëm që provojnë avionët e rinj, ishte një paralajmërim për të mos u ngritur. Ndërkaq, qilimi fluturues, i pranishëm në përrallat e shumë popujve, dëshmonte se, pavarësisht nga paralajmërimi grek, njerëzit s'do të hiqnin dorë nga kjo ëndërr.

Kurse fluturimi i trupit njerëzor mbeti përherë i huaj për njeriun. As në ëndërr, njeriu nuk fluturonte dot gjatë. Kjo tregon se ai e ka hequr përfundimisht shpresën nga kjo dëshirë. Në këtë frenim të mençur të tij, natyra vetë, me sa duket, ka luajtur një rol jo të paktë. Si për t'i kujtuar njeriut se ngritja mbi dy këmbët e prapme ishte një gjë madhështore, por ngritja e mëtejshme, domethënë fluturimi nuk ishte e thënë se do të ishte një përsosje e tij, ajo kishte krijuar, ndërkaq, gjithfarë gjallesash, shumica pa vlerë, madje të padenja, që fluturonin, si: zogjtë, mizat, madje kandrrat.

Vrojtimi i këtyre gjallesave ia zbehu njeriut dëshirën për fluturim. Madje, më të mençurit prej tyre, i ka bërë të mendojnë se, ndoshta, njerëzimi nuk do të ishte ai që është sot, për të mos thënë se do të ishte krejt i pazhvilluar, sikur njeriu të fluturonte. Një gjykim i tillë mund të duket në fillim paradoksal, por, po ta mendosh gjakftohtësisht, do të vish në përfundimin se fluturimi i njerëzve do ta bënte shumë të vështirë përqendrimin e tyre për të punuar, për të ndërtuar ngrehina, shtete, ligje, shkurt, atë që quhet shoqëri njerëzore. Një shpërqendrim dhe një shpërndarje e pafund dhe e përhershme e njeriut nëpër hapësirë, do ta bënte të lehtë dhe pa peshë gjithçka e, në radhë të parë, trurin e tij.

Pra, natyra e ka bërë njeriun midis tokës dhe qiellit. Drama e tij është zhvilluar e do të zhvillohet gjithmonë në këtë zonë, dhe kjo është jo kufizimi, por madhështia e tij.

Ç'janë këto fantazira, këto hamendje për fluturimin, për mosfluturimin, për gjysmëfluturimin! Është e drejtë të bëhet një ndërhyrje e tillë, sidomos pas orës 20.30 të mbrëmjes (domethënë pas orës kur shumica e TV-ve të botës japin lajmet). Mirëpo kjo ndërhyrje ka lidhje me një tjetër... Mendoni një krijesë, që nuk e di ç'është vallja, të shikojë një grumbull njerëzish që vallëzojnë. Ai mund të ndërhyjë, të pyesë: ç'bëni kështu? A jeni të çmendur që po lëvizni në këtë mënyrë të panatyrshme?

Dhe ju, në qoftë se do të arrini ta ndërprisni atë lëvizje dhe të kërkoni shpjegime për të, vështirë se do të merrni një përgjigje. Pyetjes suaj *ç'po bëni?, përse e bëni këtë?*, shumica do t'i përgjigjen: *për qejf!*

Shumë pak prej tyre do të rreken të japin një shpjegim më të thellë e, edhe më pak, do të mund të thonë, për shembull, se kjo shtysë për të lëvizur kështu, *ndryshe*, ka lidhje me diçka të brendshme, diçka të ndryrë brenda trupit të tyre të vdekshëm, të përkohshëm dhe të mërzitshëm.

Ata do të parapëlqejnë të vazhdojnë vallen, sesa të shpjegohen. Sepse është vërtet vështirë të shpjegosh arsyen e vërtetë përse njeriu vallëzon. Të thuash se njeriu brenda trupit të tij ka vrarë një copë fluturim, një copë qiell, dhe ai qiell kërkon herë pas here të shfaqet, të dëshmojë, kjo, ndonëse tingëllon poetike, mund të mos jetë bindëse.

Ndoshta, shpjegimi duhet kërkuar, si për çdo gjë, nga zona më të sigurta, nga jeta e përditshme, nga toka.

III

Në një kafene të Parisit jemi ulur e po bisedojmë ne të dy, njerëz të ndryshëm, unë shkrimtar, që përpiqem të dëshmoj me anë të shkrimit, domethënë me anë të shkronjave të alfabetit, atë ç'kam në kokë, dhe Angjelin Preljocaj, koreograf, që bën të njëjtën gjë me anë të një alfabeti tjetër, gjithsesi të çuditshëm.

Ne jemi që të dy shqiptarë dhe, ndonëse ai s'ka qenë asnjë ditë në Shqipëri dhe në punën e tij s'ka fare nevojë as për gjuhën shqipe e, aq më pak, për shkronjat shqipe, kurse unë s'mund të bëj pa to asnjë ditë, asnjë orë, dalëngadalë ne zbulojmë se në enigmën e punës sonë, në mërzinë, në harenë, në katastrofat e saj, ka mjaft gjëra të përbashkëta.

Natyrisht, kjo nuk kuptohet menjëherë. Në fillim jemi tepër, tepër larg, thua se notojmë nëpër galaktikë dhe zërat tanë mezi arrijnë te njëri-tjetri. Ne kemi të dy një vend që na ka lindur, një kombësi dhe, ndonëse ai vend është shtresuar rëndshëm te të dy, kjo nuk mjafton për t'u marrë vesh plotësisht. Marrëveshja vjen ngadalë, harmonikisht.

Ne flasim për raportet e shpirtit dhe të trupit, për dy pikëpamjet e skajshme, njëra në favor të shpirtit e tjetra të trupit dhe, ndonëse përpiqemi të mos përdorim citime, nuk i qëndrojmë dot joshjes për të përmendur kalimthi përbuzjen e Platonit për vallen dhe sidomos për valltarët, që i merrte për të lajthitur, që rendin pas hijeve. Ne kujtojmë fjalët e famshme të Spinozës: *Askush nuk e di se ç'mund t'i shkrepë trupit*, të cilat kanë një finesë të jashtëzakonshme. (Ne jemi mësuar me shprehjen: *i shkrepi në kokë*, por shprehja *i shkrepi në trup*, s'gjendet në asnjë gjuhë.) Pas kësaj, ne themi vetë fjalë që ngjajnë si citime (ose, ndoshta, janë vërtet të tilla, por që ua kemi harruar autorin). Ne shfaqim keqardhjen, për shembull, që Homeri, ndërsa s'ka harruar të japë përshkrimin e hollësishëm të shqytit të Akilit, nuk ka dhënë, për fat të keq, ndonjë përshkrim valleje.

Kur biseda jonë vjen te ngjarjet e ditës, te rrënimi i perandorisë komuniste dhe, pa dyshim, te rënia e diktaturës në Shqipëri, si pjesë e kataklizmës së përgjithshme, befas në mendjen time shkrep ideja se e gjithë kjo, më mirë dhe më saktë se në letërsi, në pikturë, madje në gazetari, mund të jepet në valle. Era e lirisë, e pluralizmit, valëvitja e turmave, sulmi kundër idhujve e shtatoreve të tyre, sprapsja, sulmi i përsëritur, rrënimi i idhujve etj., etj., të gjitha këto ngjajnë me lëvizjen e gjithësisë.

Ai është në një mendje me mua, natyrisht që është në një mendje me mua, dhe më shikon me sy mirënjohës. Kalimthi ai përmend puçin e fundit të dështuar në Bashkimin Sovjetik dhe mua më vjen sinqerisht keq që nuk u kujtova të them i pari se edhe ky puç, pikërisht ky puç, sidomos ky puç, më saktë se në gjithçka (duke përfshirë këtu edhe dosjet e hetimeve), mund të jepet me anë të valles.

Ndërsa brenda vetes kërkoj shembuj të tjerë për t'u bindur se vallja, në kundërshtim me ftohtësinë që mund të kenë ndaj saj disa nga filozofët, është e plotfuqishme, më kujtohet, befas, një shembull i lumtur, diçka krejtësisht e kundërt, në dukje, me furtunën epike, që shembi kampin socialist.

Një stuhi, këtë herë e brendshme, që ndodh brendapërbrenda zemrës së një njeriu dhe pastaj turret përjashta për të përmbytur krejt universin. Në fillim, në mendje më vjen vetëm titulli *Vallja e yjeve*, pastaj krejt cikli i vjershave të Lasgush Poradecit, përfshirë në librin e tij poetik me të njëjtin titull.

Për fat, ai nuk e di historinë e fillesës së këtyre vjershave, kurse unë e kam mësuar rastësisht, në një nga pushimet e mia të verës në qytetin turistik të Pogradecit, më 1960-ën. Sipas vendësve ngjarja ka ndodhur në vitet '20 dhe, ndonëse e kam shkruar një herë në një libër, më pëlqen ta përsëris.

Në vitet '20, pra, poeti shqiptar solli në Shqipëri, nga Vjena ose nga Budapesti, një vajzë holandeze. Jetoi me të ca kohë, por një ditë, vajza, për arsye që s'dihen, u largua fshehtazi nga katundi ku kishin shkuar për verim. Ajo mori aeroplanin në qytetin provincial të Korçës dhe fluturoi për Tiranë. Poeti, i zemëruar, e ndoqi me aeroplanin tjetër, të pasdites, por vajza, ndërkaq, kishte mundur të largohej për në Romë. Poeti, dyfish i zemëruar, e ndoqi gjer në Budapest, ndoshta gjer në Kopenhagen, por ai nuk e arriti dot në asnjë nga aeroportet. Ishte përherë vonë dhe, kështu, e humbi përjetë të dashurën.

Pas kthimit në Shqipëri, kjo ndjekje nëpër aeroporte u kthye në trurin e tij në një ndjekje yjesh, që nuk e arrijnë dot kurrë njëri-tjetrin. Kështu, trishtimi i tij, duke u bymyer në përmasa kozmike, krijoi një nga librat më të bukur poetikë në letërsinë shqipe.

Pas kësaj, është e natyrshme që ne të besojmë për marrëdhëniet e valles me gjuhën, më saktë, me fjalët që shoqëronin, zakonisht, vallet e vjetra. Ai mendon se fjalët e dobësojnë vallen, se ato janë bërë shoqëruese të valles nga e keqja, në mungesë të muzikës, në zonat e humbura ku s'ka vegla muzikore dhe orkestra. Unë, ndonëse nuk i mendoj dot kurrë fjalët si dobësuese të diçkaje, parapëlqej të hesht. Për herë të fundit, ndoshta, ne citojmë dikë tjetër, dhe ky është Jose Gil: "Kur gjuhët pushojnë së qeni vepruese, duhen kërkuar të çara të tjera. Njeriu, me sa duket, gjen vallen, trupin që flet".

Ne bisedojmë për të fshehtat e krijimit dhe ai thotë se koreografi, gjatë procesit të krijimit, torturohet më tepër, shumë më tepër se shkrimtari. Ti, përveç anktheve të tua të brendshme, s'ke asnjë ankth tjetër, më shpjegon ai. Gjuha është në mendjen tënde, shkronjat e alfabetit janë aty, dhe janë të bindura, dhe s'mungojnë kurrë. Kurse alfabeti im janë valltarët. Janë ata me të cilët unë do të thur elipset e mia, figurat, idetë, ekstazën, tmerrin, gjithçka. Ti mund të shkosh kudo, dhe atelienë tënde, dhe veglat e tua, domethënë gjuhën, dhe shkronjat i ke me vete, kurse unë duhet të zhvendosem me gjithë këta njerëz të gjallë, që janë alfabeti im. Por edhe në qoftë se nuk zhvendosem, prapëseprapë s'jam i qetë. A e mendon dot ti, që gjatë kohës së të shkruarit disa nga shkronjat, ose vetëm një prej tyre, ta zëmë shkronja *k*, të mos jetë aty, të mos vijë, të mungojë?

E, pra, me mua kjo ndodh. Valltarët mund të mungojnë dhe jo vetëm kaq, mund të sëmuren, të mos vijnë më kurrë.

Ai e çon edhe më larg mendimin. Alfabeti i tij i gjallë njerëzor ka gjithë mrekullinë, po edhe përkohshmërinë që ka qenia njerëzore. Ata mbartin gjithë thesarin e tij. Dhe herë pas here, herë njëri, herë tjetri, ata s'vijnë më. Sëmuren, plaken, më në fund, vdesin. Një alfabet, një pjesë e shkronjave të së cilit janë shuar. Duhen gjetur të tjera për të mbajtur gjallë atë *tymnajë të çmendur*, siç do ta quante padrejtësisht Platoni këtë krijim sublim të njerëzimit: vallen.

Valltarët janë plakur e kanë ikur njëri pas tjetrit nga kjo botë, kurse ti, koreografi plak, me sy të fikur, ndjek valltarët e rinj, brezin e tyre të tretë ose të katërt, ata që përpiqen të mbajnë gjallë në këtë botë furtunën që u ngjiz dikur në kokën e në trupin tënd. Nganjëherë, kushedi pse, jo pa një ndjenjë faji, mendon se sa shumë energji dhe rini është flijuar për të mbajtur gjallë atë *erë të çmendur* (mendoni torturën shpirtërore të shkrimtarit, sikur ta dinte se po i lodhte fjalët e gjuhës së tij).

Edhe pak dhe ti do të ikësh, gjithashtu, nga kjo botë dhe *tymnaja jote*, e pashkruar, e pangulitur asgjëkund, do të zhvendoset si një ëndërr nga një tru në tjetrin, nga një trup në tjetrin.

Ka pasur disa poetë që e kanë dëshiruar këtë gjë për vjershat e tyre. Në fund të fundit, shpesherë, midis krijuesve gjenden të tillë që, ashtu si në bursë, do të donin t'i konvertonin vlerat e tyre në të tjera. Disa piktura të kthyera në një roman, një dramë e kthyer në shtatore bronzi, dy vjersha të këmbyera në një *nature morte*. Në këtë bursë, vallja, kjo *eky* e kohës sonë, do të ishte, pa dyshim, mjaft e parapëlqyer.

IV

Angjelin Preljocaj ka lindur dhe është rritur në një vend demokratik. Megjithatë, me kalimin e viteve, hija e diktaturës, nën të cilën kanë jetuar prindërit e tij, ka nisur ta shqetësojë ndërgjegjen e tij qysh herët.

Herët e ka kuptuar se s'mund të shpjegohen shumë gjëra të tij pa atë zonë të largët, që zhytet në mjegull të fisit të vet. Është një lloj shtese, një lloj përtejjete që bën shenjë që larg, që thërret, që gulçon, që kërkon të drejtën e saj.

Kështu, ndonëse duket sikur as unë, as ai nuk dëshirojmë të flasim për diçka të trishtueshme, biseda jonë vete nga vete dhe kthehet te tirania.

Më shumë se te tirania shpirtërore, ajo vërtitet rreth tiranisë në përgjithësi.

Si janë lëvizjet e njerëzve në një vend diktatorial? A ndryshojnë vërtet me kalimin e viteve (a keqësohen më shumë, ashtu si gjithçka tjetër, a ka shpresë për shërimin e tyre), apo ky s'është veçse një spekulim poetik?

Kjo është ende e hulumtuar mirë. Që ka pasur përherë një ndryshim në ecjen, në krejt lëvizjen e njerëzve të shtresave të ndryshme, në ecjen e sundimtarëve dhe të të sunduarve, të Zotit e të robit, të princit e të rebelit apo konformistit, kjo është një gjë e njohur. Ajo që nuk njihet është se kur nis së pari ky ndryshim, në ç'vit apo në ç'stinë të tiranisë, në ç'moshë të njeriut, së fundi, dhe kjo është një ndër enigmat kryesore: ku nis ndryshimi? Në jetën e përditshme, për të kaluar pastaj në presidiumin e mitingut apo në skenën ku vallëzohet, apo që nga presidiumi ose që nga skena, si një urdhër i pashkruar, zbret në rrugë?

Dihet se nga lëvizjet e përditshme të trupit njerëzor gjer te vallja, nuk është veçse një hap. Nga mijëra lëvizjet banale të trupit të vet, si një shkëputje, si një hedhje ose si një ëndërr, njeriu përzgjedh disa për t'i treguar të shtunave në sheshin e katundit apo në skenë.

Që prej shekujsh është bërë pyetja: përse vallëzohet? Ç'i shtyn njerëzit e shekujve, të racave, të regjimeve të ndryshme ta bëjnë atë përzgjedhje lëvizjesh, me fjalë të tjera: të vallëzojnë? Janë të pakënaqur nga shkronjat dhe i quajnë të pamjaftueshme për të shprehur atë që kanë në shpirt? Pa dyshim që është kështu, aq më tepër që njerëzit kanë vazhduar të vallëzojnë edhe pasi janë shpikur shkronjat. Janë të

pakënaqur nga ngjyrat e nga tingujt e muzikës dhe i quajnë të paplotë njëlloj si shkronjat? Pa dyshim që është kështu, ndonëse që të dyja, edhe ngjyrat, edhe muzika, janë më të lashta se shkronjat dhe më universale se ato.

S'ka dyshim se vallja është më e vjetër se tatuazhet, se daullja, dhe se hieroglifet apo shkronjat kuneiforme, por kjo nuk shpjegon arsyen e të qenit të saj. Fakti që ajo nuk u zhduk pas zhvillimit të muzikës, të pikturës e të librave dëshmon se njeriu ka nevojë për të, njëlloj si në kohërat primitive. Madje, mund të thuhet se thirrja e këtij arti është, ndoshta, më e fuqishme dhe më tragjike se të tjerat.

Që njeriu, pasi ka pikturuar me dorë, pasi ka kënduar me gojë dhe pasi ka shkruar, duke vënë në lëvizje trurin, papritur i lë mënjanë të gjitha këto dhe ndien nevojën që, për të dëshmuar diçka, të vërë në veprim gjithë trupin e vet, kjo është vërtet një gjë tepër e veçantë. Të thërrasësh në ndihmë trupin, këtë hamall, këtë varr, këtë burg të shpirtit (për të përmendur vetëm disa nga cilësimet e tij), pra, të thërrasësh në ndihmë pjesën tënde më prozaike, më të përbaltshme, më të vdekshme, për të shprehur hovzimet qiellore të shpirtit, kjo është më se paradoksale.

Por, ndoshta, pikërisht në këtë paradoks, në këtë kundërti, në këtë pamundësi dramatike qëndrojnë edhe pesha dhe tragjizmi i valles.

Dikujt mund t'i duket se epiteti *tragjik* i shkon më pak se gjithçkaje valles. Por mjafton të kuptojmë se nën diktaturat më të zeza njerëzit vazhdojnë të vallëzojnë, për t'u bindur se vallja i shkon festës po aq sa zisë.

Pyetjen e përgjithshme: *përse vallëzohet?* mund ta fillojmë, ndoshta, në mënyrën më të saktë: përse vallëzohet në diktaturë? Përgjigjja është e thjeshtë: njeriu vazhdon të vallëzojë nën një regjim tiranik, përderisa ai vazhdon të mbetet njeri. Njeriu vallëzon i shtyrë nga një shtysë misterioze ende e pashpjegueshme. Përderisa është vërtetuar se ai vallëzon i shtyrë po aq nga gëzimi, sa edhe nga brenga, pra, përderisa hyn në valle i shtyrë prej shkaqeve më të kundërta, kjo mjafton për të kuptuar se është e kotë të gjendet një shpjegim i saktë i vallëzimit.

Njeriu ngrihet në valle për t'u bërë tjetër. Ai bën një përpjekje për të kaluar nga një gjendje në tjetrën, ai ndërron lëvizjet e zakonshme me lëvizje më të ngadalta ose më të shpejta, prej vetes së vet ai nxjerr një shëmbëllim, një pasqyrim, një refleks të vetvetes, një hije si ato të përrallave, një lloj ylberi, një lloj dyzimi ose fantazme, që edhe i ngjet, edhe nuk i ngjet atij vetë. Kështu, i ndryshuar, me tjetër peshë e tjetër ritëm, ai shfaqet për një kohë të shkurtër (aq sa vazhdon vallja), për t'u kthyer prapë andej nga erdhi: nga balta e rëndë e jetës së përditshme njerëzore.

Nga kjo pikëpamje, vallja mund të quhet fare mirë një çlirim, një kapërcim sipër humnerës, një engjëllzim a hyjnizim i njeriut.

V

Dihet se të gjitha diktaturat, në përpjekjet e tyre për të pranguar njeriun, kanë qenë përherë syçelëta për të shtypur të gjitha shfaqjet e lirisë. Por as egjiptianët e as babilonasit, as persët e as otomanët, as juntat amerikano-latine e as nazistët nuk kanë qenë aq të zellshëm e seriozë në mposhtjen totale të njeriut, sa ç'kanë qenë diktaturat komuniste në shekullin XX. Si asnjëherë tjetër, në historinë e njerëzimit, u bënë përpjekje për të ndryshuar rrënjësisht, domethënë për të rrënuar mendimin e lirë, artin dhe letërsinë, vetë njeriun. Për herë të parë, qysh nga kohërat mitologjike, njerëzimi u gjend realisht përpara rrezikut të zëvendësimit të tij me një njerëzim të ri, të bjerrur.

Me gojën e tyre, liderët komunistë, që nga Lenini te Fidel Kastro, jo vetëm që e shpallën krimin e tyre, por e quajtën mburrjen e tyre më të madhe. Ata shpallën rrënimin e vlerave, ndryshimin e letërsisë, të arteve, të gjithçkaje që pengonte për prishjen e njeriut.

Në këtë sulm, vallja do të kishte edhe ajo fatin e saj të zi. Sado që mund të dukej se s'kishte lidhje me politikën, sado që mund të ngulte këmbë se kishte të bënte me jetën ose vdekjen, në përgjithësi, ashtu si lëvizjet e dashurisë, ashtu si përpëlitjet në prag të mbarimit, vallja do t'i nënshtrohej sëpatës së egër totalitare njëlloj si librat, njëlloj si piktura. Egërsia, urrejtja, lufta e klasave, këto mokra pa të cilat nuk ushqehej dot tirania, do ta pushtonin dalëngadalë si një sëmundje vallen, do të përpiqeshin ta ngrinin, ta paralizonin, gjersa ta ndryshonin në atë farë shkalle, saqë të mos njihej më.

Të gjitha diktaturat pikasin te vallja një shenjë të keqe: ridëshmimin e njerëzores te njeriu. Do të donin ta zhduknin fare atë rrezik, por, ndërkaq, e dinë se një gjë e zhdukur mund të rikthehet, madje, më e fuqishme se më parë. Mënyra më e mirë për ta bërë të parrezikshme është ta ndryshosh, t'i prishësh racën, genin, me fjalë të tjera, ta përçudnosh.

Me letërsinë dhe artet e tjera duket sikur puna është më e thjeshtë: ushtrimi i terrorit mbi një grusht njerëzish që merren me to: shkrimtarë, piktorë, muzikantë, e bën më të kontrollueshëm rrezikun. Kurse çështja e valles është e ndërlikuar, për shkak të ndërhyrjes në të të trupit njerëzor, të miliona trupave njerëzorë që përzihen në këtë art. Për ta nënshtruar më mirë, diktatura bën një ndarje të parë: ajo e ndan vallen e skenës nga vallëzimi në përgjithësi. Në skenë e ka më lehtë të vendosë diktatin e saj: përjashtohet vallja moderne (në mendësinë e saj ajo ka lidhje me rebelimin, anarkinë, vallëzimin e shtrigave në mesjetë, herezinë dhe disidencën). Pranohet vallja klasike, ngaqë ajo u kujton sunduesve të rinj qëndrueshmërinë e shtetit, prarimin e lozhave, përjetësinë e tyre në pushtet.

Këtë gjë bëri Stalini në Bashkimin Sovjetik. Këtë bëri dhe Mao Ce Duni në gjysmën e parë të sundimit të tij. Më pas Maoja shkoi më larg. Në prag të revolucionit kulturor, kur ishte i interesuar për troshitjen e shtetit, gjëja e parë që bëri ishte ndalimi i valles klasike në skenë.

Për sa i përket vallëzimit të njerëzve, edhe këtu u bë një zgjedhje: u lejua vallëzimi popullor dhe një pjesë e vallëzimit *korrekt* (tango, fokstrot etj.), por u përjashtua rreptësisht vallëzimi modern.

Më 1967-ën, Kina shkoi më larg: bashkë me vallëzimin klasik në skenë, e ndaloi krejtësisht vallëzimin e njerëzve. Akoma më larg shkoi Kamboxhia: të rinjtë që mund të gjendeshin duke vallëzuar, pushkatoheshin!

Në Shqipëri, fati i valles e i vallëzimit ndoqi, përveç të tjerash, ritmin e plakjes së udhëheqësve të partisë ose, më saktë, të plakjes së diktatorit Enver Hoxha. Vallëzimi pothuajse u ndalua në Tiranë, për herë të parë, në kohën e valës së re të terrorit e të spastrimeve më 1967-ën. Më 1972-in, goditja e infarktit që pësoi diktatori, pas së cilës një kohë të gjatë ai lëvizte duke u mbështetur mbi një shkop, përveç valës së re të terrorit, i dha edhe një goditje fatale valles. Ishte hera e parë që Komiteti i Partisë së Tiranës u bëri thirrje komunistëve që të mos vallëzohej as nëpër shtëpi, përveç rasteve të dasmave.

Për të mbushur boshin që krijohet nga dëbimi i valles, diktatura shton festat masive: festivalet kombëtare, manifestimet sportivo-artistike, gjithfarë olimpiadash të fëmijëve, të të rinjve, të grave, të veteranëve, të ushtarakëve. Diktatura, pasi ka thirrur në ndihmë poetët, për t'i bërë himn asaj, kompozitorët, për t'i kushtuar kantata e oratorio, piktorët e skulptorët, për t'i bërë fytyrën, thërret edhe koreografët, që ta zbavitin pak.

Shkrimtarët ose piktorët konformistë, në përpjekjet e tyre për të krijuar *artin e ri të realizmit socialist*, qëmtonin në *jetën socialiste* subjekte, motive dhe imtësi, me anë të së cilave rrekeshin të mbrunin veprat e tyre. Subjekte e motive *të përshtatshme* (domethënë të neveritshme), kishte mjaft, ashtu siç kishte personazhe e heronj të tillë, kështu që shkrimtarëve konformistë, për arsye të mendjes së kufizuar, të servilizmit ose të budallallëkut, u dukej normale t'i futnin ato në veprat e tyre. (Në të vërtetë, qëllonte shpesh që ato që krijonin vetë ishin edhe më të neveritshme se realiteti.) Në këtë rast del e njëjta pyetje për koreografët: a gjenin ata në jetën socialiste *lëvizje të reja?*, mbi të cilat të mbështeteshin për të servirur shfaqjet e tyre pompoze, sidomos në rastet e përvjetorëve të revolucioneve?

Edhe kjo është ende e pahulumtuar. Por, nëse është i paqartë ndryshimi i lëvizjes (i ecjes) së komunistëve të zellshëm prej njerëzve apolitikë dhe prej njerëzve të pakënaqur, diçka më e dallueshme shfaqet midis lëvizjes së të rinjve konformistë dhe të atyre jokonformistë. Në këtë rast, dallimi vështirësohet përsëri, ngaqë te jokonformistët një pjesë të madhe e zënë të rinjtë që ndjekin modën dhe që e konsiderojnë modëndjekjen si një protestë të mjaftueshme kundër regjimit. Ndërkaq, midis të rinjve që lëvizin në mënyrë *klasike* mund të gjenden shpesh edhe disidentë nga më kryeneçët.

Megjithatë, në regjimet totalitare ka një shtresë të shoqërisë që, gjithsesi, ka lëvizje krejt të tjera dhe që e dallojnë kryekëput prej pjesës tjetër të popullit. Këta janë funksionarët e lartë partiakë ose shtetërorë, anëtarët e Byrosë Politike dhe një pjesë e zyrtarëve partiakë ose të Policisë së Fshehtë nëpër rrethe. Karakteristikë e parë e lëvizjeve të tyre është njëfarë ngathtësie solemne, shoqëruar me një shprehje të ngrirë në fytyrë, e cila është midis buzëqeshjes dhe vrenjtjes, dhe bën të njëjtin efekt në të dyja rastet.

Është me interes të vërehet se ndryshe nga dinamizmi histerik i lëvizjes së nazistëve, lëvizjet e komunistëve janë kryesisht të ngadalta. Ky ritëm i ngrirë vjen, me sa duket, nga lindja aziatike. Ndërsa dy hyjnitë e para të komunizmit, Marksi dhe Engelsi, përfytyrohen jashtë çdo lloj lëvizjeje, është një kureshti e madhe përse nga hyjnitë e tjera të marksizmit vetëm Lenini ka pasur një lloj dinamizmi në lëvizje, por një dinamizëm që është më tepër qesharak dhe që karakterizohet prej gjuhës popullore si e *njeriut që s'i rri... trupi në vend.* Të tjerët, duke filluar nga Stalini e gjer te Mao Ce Duni, zgjodhën përfundimisht plogështinë aziatike. Te diktatori shqiptar, Enver Hoxha, mund të gjesh të dyja llojet e ritmeve: në vitet e para të sundimit, ritmi i lëvizjeve të tij ngjante me atë të Musolinit, për të kaluar më pas në stilin e përgjithshëm të të gjithë zyrtarëve komunistë.

Një zyrtar i lartë komunist, që zë vend në presidium për të hapur një festë solemne ose për të zbuluar një komplot, është njëlloj i ngathët dhe bën të njëjtat lëvizje dhe flet me atë që ka përbri në të njëjtën mënyrë. Një solemnitet i pështirë, festiv ose i përzishëm i vë vulën çdo gjesti të tij.

Siç shihet, kjo ngathtësi e udhëheqjes bie në kundërshtim me *dinamizmin revolucionar*, me luftën e klasave, egërsinë, mungesën e mëshirës, tërbimin dhe histerinë që kërkohet prej popullit, gjithsaherë që partia ka nevojë për të. Për të ndrequr këtë mospërputhje, regjimet diktatoriale organizojnë parada, festivale, marshime e mitingje të pafundme. Në këto manifestime koreografët vjelin gjeste dhe lëvizje për të krijuar vallen e re socialiste.

Shprehja e njohur se *trupi nuk gënjen* krijoi midis diktaturës dhe valles një konflikt të ashpër. Ta detyrosh trupin njerëzor të gënjejë, është, me sa duket, më vështirë se të detyrosh shkrimtarin të shkruajë një pamflet ose piktorin të pikturojë një hero të punës socialiste.

Megjithatë, diktatura, e cila nuk është sprapsur përpara asgjëje, nuk heq dorë as nga prishja e valles, e kësaj dëshmie misterioze mijëvjeçare të njeriut. Ajo, që ka lidhur me zinxhirë çdo shfaqje të lirisë, rreket ta lidhë edhe vallen.

VI

Angjelin Preljocaj për një kohë të gjatë nuk i dinte këto. Ndërsa rritej e bëhej i ndërgjegjshëm, në fillim turbull e pastaj përherë e më qartë, po e kuptonte se vendi ku ndodhej nuk ishte vendi i tij.

Në fillim ishte fjala... Në krye të tëhuajzimit të tij ishte gjuha. Tjetër gjuhë flitej në shtëpinë e vet e tjetër përjashta.

Kur ishte fare i vogël, ai nuk e kuptonte se këto ishin dy gjuhë të ndryshme. Më tepër i ngjante se ishte thjesht gjuha njerëzore, por që brenda mureve të shtëpisë ishte ndryshe, e sapo ai kapërcente portën, aty për aty, si me magji, kthehej në tjetër gjuhë.

Pyetje: Kur e kuptove se ajo që flitej në shtëpi ishte gjuha shqipe, e përjashta frëngjishtja?

Përgjigje: S'mund ta përcaktoj dot. Lidhet, ndoshta, me një kuptim tjetër: atë të qenit të huaj, shqiptar. Në fillim as këtë s'e dija. Domethënë e ndieja që ne ishim të *tjerë*, por se çfarë, s'e kapja dot mirë. Pastaj po e mësoja se ishim shqiptarë, por në fillim këtë e merrja më shumë si çështje fisi, s'di si ta them as vetë. Më vonë, dalëngadalë po e merrja vesh se kjo gjë ishte më e thellë se ç'dukej dhe më e pandryshueshme.

Më vonë, Angjelini i vogël do të zbulonte se nuk ishte vetëm gjuha që ndryshonte brenda mureve të shtëpisë së tij, por shumë gjëra. Jo vetëm fjalët, por dhe psherëtimat e nënës ishin ndryshe, dhe vështrimi i syve, dhe lëvizjet e saj, dhe mënyra si hynte nga porta babai.

Më pas, ai do të mësonte dalëngadalë krejt të vërtetën: Që ai ishte nga një vend që quhej Shqipëri. Që ky vend ishte larg nga Franca. Që pamja e këtij vendi, domethënë malet dhe fushat e tij ishin më shumë të ndryshme nga pamja e Francës, se ç'qe, për shembull, pamja e babait të tij nga ajo e francezëve. Së fundi, ai do të kuptonte se ky ishte një vend diktatorial, prej të cilit ata kishin ikur nëpër terr.

Pyetje: Si e përfytyrove së pari vendin e origjinës? Ose përpara se të bëhet kjo pyetje, mos duhet thënë: a të shtynte diçka të mendoje se ti vije nga një tjetër vend? A ndahej ky *land* tjetër në ndërgjegjen tënde, a dallohej, a kishte peshë?

Përgjigje: Siç thashë, herët e ndjeva se ndryshimi i vendit tim prej Francës ishte më i ndjeshëm se ndryshimi i prindërve të mi prej francezëve. Babai më dukej më i ngjashëm me ta, kurse nënës i theksohej ndryshimi, kur qëllonte të ishte me shoqet e veta shqiptare. Por shkëputja e plotë ndodhte me gjyshin. Ai ishte krejtësisht *tjetër.*

Angjelini më shpjegon gjatë këtë *tjetëri.* Gjyshi ishte i vdekur prej kohësh dhe, me sa duket, të vdekurit, ndonëse duket sikur balta i afron, nganjëherë janë më të paafrueshëm me njëritjetrin se të gjallët.

Te porta e shkollës, Angjelinit të vogël i kishte qëlluar shpesh të shihte gjyshërit që vinin e merrnin nipat. Gjyshin e vet shqiptar Angjelini s'mund ta përfytyronte veç si një njeri që s'mund të kishte asgjë të ngjashme me gjyshërit francezë. S'ishte vetëm punë veshjesh, dokesh. Ishte një gjë tjetër themelore. Gjyshi i tij ishte vrarë në mënyrë tragjike në Shqipëri, në një konflikt ndëretnik. Kishte dhe një këngë për të, një nga ato këngët e shkurtra epike që, si gurë varresh, e kanë mbushur poezinë popullore shqiptare.

Ato dhe fillimin e kanë shpesh të ngjashëm, njëlloj si formulat e riteve: *Kur krisi pushka o në X-vend* (zall, lug, kodrinë).

Por kjo *tjetër*, tek Angjelini do të mbetej thjesht një gjë e fshehtë, një gjë shpirtërore, sikur të mos lidhej me diçka tjetër. Kjo ishte trupëria e tij. Ai ndiente një tjetër mish, të tjerë muskuj. Dhe kur mishi është tjetër dhe muskujt janë të tjerë, ata do t'i detyrojnë trupit të tjera lëvizje.

Një shkallëzim i *tjetërsisë* do të vinte më pas, kur ai të hynte në universin e valles. Edhe brenda saj ai do të synonte drejt të ndryshmes: të thyente pengesat akademike, të kapërcente pragjet e padukshme, ato tabu që e përshkonin kryq e tërthor skenën dhe që syri ynë, i spektatorëve, nuk i shikonte, por që për koreografin ishin po aq të tmerrshme sa telat me gjemba!

VII

Kur Angjelin Preljocaj u magjeps së pari nga arti i të kërcyerit, nuk e kishte fort të qartë se në krejt këtë trup qiellor që quhet botë, banuesit e saj, njerëzit, kërcenin kudo. Atë e tërhoqi, së pari, vallja në skenë, pastaj mësoi se mizëria e popujve kishte mijëra vjet që hidhte valle nëpër fusha e pllaja.

Popujt kërcenin kudo e kurdo dhe, ndonëse kishte mendime të ndryshme se në ç'kohë gjunjët e tyre ndienin padurim për valle e në ç'kohë

plogështoheshin, një gjë ishte e sigurt: vallja, ashtu si jeta, s'reshtte kurrë.

Disa mendonin se në prag luftërash, domethënë zhvendosjesh të mëdha, popujt nisnin e kërcenin më shumë e më ethshëm, e të tjerë mendonin të kundërtën, domethënë që, në prag fatkeqësish, këmbët mpiheshin si nga reumatizma.

Shembujt mund të gjendeshin të shumtë nga të dyja anët. Kur Tebës i afrohej lajmësi, që do të sillte gjëmën për krimin e Edipit, thuhej se vallja nuk reshtte ditë e natë. E po ashtu më pas, në prag të kryqëzatave, e po ashtu në mbarim të viteve '30, në prag të katastrofës botërore. Të tjerë kronistë e poetë rrëfenin se si në vigjilje dramash e tërmetesh, dëshira për valle fashitej. Vërtetimi më i freskët i kësaj ishte ankthi i fundit, në të cilin u përfshi bota mbarë: lufta në Gjirin Persik. Sipas të dhënave të besueshme, tri veprimtari njerëzore pësuan, midis të tjerash, një rënie të ndjeshme: restorantet, diskotekat dhe shitja e librave. Kurse puçistët në Bashkimin Sovjetik, në gusht të vitit 1991, e shoqëruan shpalljen e puçit me një koncert të pambarim në TV, ku shumicën e vendit e zinin vallja dhe baleti klasik. Po ashtu, në Shqipëri, më 1985, kur pritej vdekja e tiranit E. Hoxha, shteti diktatorial për muaj të tërë i mbyti programet televizive me valle popullore.

Pikërisht në Shqipëri, në atdheun e largët të Angjelinit (në të vetmin në botë që kishte një shpend në flamur), kishte tre mijë vjet që vallëzohej. Ilirët, domethënë shqiptarët e hershëm, vallëzonin shumë. Një vazo e stërlashtë ilire, e cila jep pamjen e pesë grave të kapura prej dore që përcjellin të vdekurin, ka nxitur shkoqitje të ndryshme të shkencëtarëve. Ndër ta, zotëron mendimi se kapja për dore e grave, dhe sidomos fakti që vallja zhvillohet nga e majta në të djathtë, domethënë *mbrapsht*, dëshmon se ajo është valle mortore. Vazot e mëvonshme ilire të periudhës pararomake e romake, ku gjenden pamje të tjera vallesh mortore, këtë herë tepër të qarta, tregojnë se vdekja ka qenë një nga nxitëset kryesore të valles dhe kjo s'është aspak për t'u çuditur, përderisa vdekja dhe ritet e saj janë, me sa duket, edhe në zanafillën e teatrit tragjik.

Vallja, në përgjithësi, me trajtën e saj rrethore, përsërit një nga simbolet më të lashta dhe universale të njerëzimit: rrethin, domethënë simbolin e diellit, si edhe lëvizjen e tij në kupën qiellore. Vallja, e cila sillet në kah të mbrapshtë, domethënë në anën e kundërt të diellit (akrepave të orës), pra, nga e majta në të djathtë, si në vazon ilire, do të thotë vdekje.

E gjithë kjo tregon se qysh në fillimet e saj, vallja kishte në vetvete diçka që nuk e kishin artet e tjera: figurinat prej balte, melodia e fyellit, drama ose piktura. Ndryshe prej tyre, në rastin e kthimit ose kurdisjes së saj *mbrapsht,* vallja i ngjante një mekanizmi që mund të punonte në dy kahje: të mirë dhe të keqe. Ajo të kujtonte kështu *orën e mirë* dhe *orën e ligë*, kthimin e papritur të fatit, së fundi, kahjen e rrjedhjes së kohës, këtë enigmë që ka munduar dhe vazhdon të mundojë ç'prej mijëra vjetësh mendjen njerëzore.

Ballkanasit e mëvonshëm, ndonëse nuk lexonin kurrfarë librash e s'e vrisnin mendjen për kurrfarë filozofish, vinte një orë kur ndienin nevojën për një arratisje, qoftë edhe të shkurtër, nga jeta dhe ligjet e saj. Ata kapeshin, kështu, për dore, për t'u gjendur, turbull, në një zonë të ndërmjetme, në një astokasqiell, asditasnatë, asjetasvdekje.

Kishte, pra, së paku, tre mijë vjet që në Shqipëri vallëzohej njëlloj si në kohë të mirë e si në të keqe. Rrjedhimisht, vallet ishin të tilla që s'mund t'i quaje as të gëzuara, as të hidhëruara. Shumica e tyre, ashtu si njerëzit, kishin seks. Kështu, kishte valle burrërishte, valle grarishte dhe, më rrallë, valle të përziera. Vallet e burrave kishin një ritëm të përmbajtur, me goditje të shpeshta të tokës me këmbë dhe me përsëritje të mundimshme, thua se valltarët e kryenin ritin përmes një pengese të rëndë. Asnjë valle burrash shqiptarë s'mund të përfytyrohej pa goditjen e tokës. Toka ishte e gjithëpranishme në të. Zhurma e thembrave mbi tokë jepte forcën, zhurmën, bujën, gatishmërinë për aventurë. Por toka ishte, në radhë të parë, vdekja. Një pjesë e valleve flisnin për vdekjen e dhunshme, tragjike, ndaj prania e saj dëshmohej e ridëshmohej me anë të goditjes. Veç kësaj, toka ishte në bazë të shumë ndërlikimeve dhe nyjave të jetës, që nga grindja për kufijtë e kullotave, gjer te pushtimi i saj prej shtetit armik. Kështu që lidhjet e saj me vallen ishin të natyrshme. Ato ngjanin aq të dukshme, saqë quhej i natyrshëm shpjegimi poetik se goditja me thembër e tokës prej vallëzuesit të parë ishte njëlloj si kërkimi i lejes për ta nisur vallen apo jo.

Pesha e tokës kalonte kështu te vallja. Ato ishin, së shumti, dramatike. Edhe fjalët që i shoqëronin, të tilla ishin, të forta, por të sakta. Shumica e teksteve të valleve u ngjanin disa herë kronikave të vjetra e disa herë lajmeve të shtypit të përditshëm. Personazhi epik vihej në kohën dhe hapësirën e caktuar. (Për shembull: atë vit kur sulmoi serbi. Ose: te pesë puset në grykë.) Më pas tregohej veprimi i personazhit. Pastaj vdekja ose, më mirë, vrasja e tij. Mund të kishte dy rreshta për fjalët që thoshte para se të hiqte shpirt (një dëshirë të fundit, një dhiatë) dhe vallja mbyllej. Kështu që ajo i ngjante vërtet ritit mortor, që mbaronte me futjen e personazhit në tokë.

Si për të lehtësuar peshën e zezë të tokës, fustanella e burrave, kjo veshje ballkanase iliro-shqiptaro-greke, që ngjante, çuditërisht, me veshjet e keltëve, si për të lehtësuar, pra, peshën, fustanella rrotullohej e gufmohej sipër gjunjëve, si një zonë e ndërmjetme midis tokës dhe qiellit.

Kurse në vallet grarishte, ndërsa mungonte prania e tokës, theksohej lëkundja e shamisë, pra, ana qiellore e valles. Edhe fjalët që e shoqëronin ishin fare të ndryshme nga ato të ritit burrëror. Ato flisnin më shumë për largësinë, për ndarjen, për mallin.

Kishte valle që ndritnin e gjëmonin nga tingujt, ngjyrat dhe ritmi, kishte të tjera të humbëta e shkretane, si të pjella prej zonës së tejjetës. Kështu ishte, për shembull, një *Valle dyshe pleqsh*, ku vallëzuesit u ngjanin dy kërcunjve të vjetër që zhvendoseshin gjithë mund, mu në buzë të vdekjes. Kishte një valle që quhej *Bodrumçe*, domethënë që përfytyrohej se kërcehej nga të burgosurit. Të gjithë e dinin pak a shumë si ishin burgjet, e sidomos burgjet turke e shqiptare, të ngushtë e të errët, sa jo të vallëzoje, por as të lëvizje s'mundeshe dot. Megjithatë, të gjithëve u dukej normale qenia e një valleje të tillë, ngaqë normale u dukej se edhe i lidhur me zinxhirë, njeriu mund të dëshironte të hidhte valle.

Kështu, pra, kjo valle e quajtur *Bodrumçe* ose *Burgçe*, njëlloj siç quhej një gjuhë apo modë e huaj *italiançe* ose *turçe*, ishte, në të vërtetë, një lëvizje-ëndërr, një vegulli, pra, i afrohej thelbit të këtij arti më shumë se të gjitha vallet e tjera. Më pas, kur dy shekujt e fundit arti koreografik do të zhvillohej përherë e më fort, nga ky model i valles, ky art do të përfitonte, ndoshta, më shumë se nga gjithë të tjerët.

VIII

Angjelini i vogël pati një fat të veçantë, që nëna e solli një verë te kushërinjtë e vet në qytetin e Ulqinit, në brigjet e Adriatikut. Ky është një qytet i lashtë, i shkëputur nga Shqipëria dhe dhënë Jugosllavisë, ashtu siç i qenë dhënë Kosova dhe vise të tjera në Mal të Zi e Maqedoni, më 1913.

Ulqini ishte një qytet shqiptar, i mbushur me shqiptarë. Emri i tij vinte nga fjala shqipe *ulk* dhe, qysh natën e parë të mbërritjes, Angjelinit të vogël, mendja e të cilit ishte plot shqetësime e fantazi, iu duk se po dëgjonte ulërima ujqish.

Në të vërtetë, në këto zona të acaruara etnike, po të ishe i ndjeshëm, do të dëgjoje përherë ca si gulçime, ca si rënkime. Ishin kujtimet e historisë, ngaqë pikërisht në këto troje thika e saj kishte bërë prerje të tmerrshme. Dhe ato prerje dhembnin ditë e natë.

Ishte hera e parë që, përveç njerëzve të familjes së vet, Angjelini i vogël shihte shqiptarë. Gjer atëherë atij i qe dukur se shqiptarë mund të shihte veç brenda mureve të shtëpisë, e tani ata i shihte kudo: në rrugë, në treg, në breg të detit.

Disa kilometra më larg ishte Shqipëria, prej nga ata kishin ikur një natë të errët. Aty ishte Shkodra, qyteti i zanafillës së tij, me kisha të mëdha, që komunistët ende nuk i kishin mbyllur. Jo vetëm prindërit e tij, por gjithë shqiptarët e Ulqinit kishin mall për këtë qytet. Për herë të parë, Angjelini i vogël po zbulonte diçka të habitshme: kishte qytete që rrezatonin mall, ashtu siç kishte të tjera që s'rrezatonin asgjë. Shkodra i mallëngjente të gjithë, ata që e njihnin dhe ata që s'kishin shkelur kurrë. Por më e çuditshme ishte se Shkodra turbullonte jo më pak mendjet e malazezëve, banorëve të Malit të Zi, të cilët, në ditët me diell, mund të dallonin që larg vezullimin e kambanoreve të saj.

Nëna vazhdoi ta sillte Angjelinin përherë e më shpesh në *qytetin e ujkut*, Ulqinin. Në moshën dymbëdhjetëvjeçare ai kishte hyrë në shkollën e baletit të Shampinjisë, megjithatë, çdo herë e priste me gëzim lajmin e udhëtimit për në Ulqin. S'ishte vetëm gëzimi se do të rrinte ca ditë midis njerëzve të farefisit, ata që i mungonin në Francë. S'ishte, ndoshta, as afërsia e Shkodrës, e cila kishte arritur, ndërkaq, t'ia ngjiste mallin e saj dhe ku kishte pjesën tjetër të farefisit. Ishte diçka më e thellë e më misterioze, diçka po aq këmbëngulëse, sa edhe thirrja e gjakut. Ajo lidhej me magjepsjen e tij të parë dhe të fundit në jetë: vallen dhe muzikën. Ato kishin në botë shumë tempuj, por, turbull, ai e ndiente se një lidhje e fshehtë do ta tërhiqte përherë te ky vend i Ballkanit, ku grremçi i vjetër, i ndryshkur, e priste.

Tani që bënte shkollë për balet, ndryshe i shikonte në rrugë njerëzit që lëviznin. Tani po zbulonte se kishte dy lloj njerëzish në Ulqin. Një palë, ishin ata të zakonshmit, të veshur me tesha të kohës, njëlloj si në Paris, njëlloj si në Shampinji. Por një palë të tjerë, natyrisht, më të paktë, vazhdonin të visheshin tradicionalisht. Ishin këta të dytët që, përherë e më fort, po e tërhiqnin djaloshin Angjelin. Kështu ishte veshur me shekuj populli të cilit ai i përkiste. Balerini i ri, i ardhur nga Franca, hetonte i mahnitur veshjet e burrave dhe të grave që, më shumë se për në jetë, dukej se ishin qepur për në skenë. Një e bardhë alpine, e ndërprerë befasisht nga shpërthimi tronditës i së kuqes. Do të besoje se kishin shpërthyer ca lule të kuqe, ose gjaku kishte vërshuar pas goditjes së sëpatës. Mbi tirqet e bardha të burrave ishte një zigzage e zezë, që të kujtonte shenjën *rrezik vdekjeje* pranë kabinave elektrike. Te krahët e xhokes kishte ca si flatra të prera, thua se njeriu ishte përherë gati për t'u nisur drejt qiellit. Në gjithçka ndihej rreziku, fataliteti dhe përkohshmëria.

Kurse te gratë, si përherë, çdo gjë ishte më qetësuese. Por ajo që e befasonte më fort Angjelinin, në veshjen e grave, ishte fustani që ato mbanin, xhubleta. Ajo ishte në trajtë kambane të valëzuar dhe, gjatë ecjes, gjithmonë lëkundej. Ajo ishte si një valle e përhershme e varur poshtë mesit të gruas. Këmbët e gruas mund të ishin të vrara, gjysmë të ngrira, të ënjtura nga dhimbja, kurse xhubleta, ndërkaq, vallëzonte. Në trurin e Angjelinit ky vallëzim i pavarur përpiqej të lidhej me ato gjëra që ai kishte mësuar, ndërkaq, për raportet midis artit dhe qenies njerëzore. Diçka i sqarohej herë-herë, por më shumë i ikte, ndërkaq.

Ajo që pikaste më qartë ishte njëfarë ngjashmërie me veshjet antike greke. Më pas do të mësonte se veshjet e malësorëve shqiptarë, sidomos ato të grave, ngjanin me veshjet më të vjetra greke, ato kreto-mikenase. Këto veshje fare mirë mund t'u shkonin aktorëve që do të luanin *Orestia*-n e Eskilit. Më pas, ai do të mësonte se grekët e shqiptarët, ndërsa flisnin gjuhë krejtësisht të ndryshme, vallet i kishin të afërta, madje shumë nga gjestet e përditshme i kishin gati të njëllojta.

Ngjashmëria me grekët e moçëm do t'i bëhej më e qartë kur të shkonte në dasmë. Ai nuk e dinte ende mendimin e gjermanit Maksimilian Lambertz, se në dasmat shqiptare dallohet menjëherë skenari i vjetër i rrëmbimit, megjithatë s'ishte e vështirë të kapej aty për aty se në këto dasma ishte përherë i pranishëm një rrezikim. Gati gjysma e dasmave shqiptare kishin brenda një të papritur dramatike. Njerëzit e dinin këtë, ndaj ngazëllimi i tyre s'ishte kurrë banal. Këtyre dasmorëve, po t'u thoshe se mbi dasmën përgjojnë hyjnitë, ata që janë dashamirës e ata që janë dashakeqës, kjo do t'u dukej atyre gjëja më normale.

Kur pas njërit prej kthimeve nga Ulqini, Angjelini i tha së ëmës ta çonte në një dasmë franceze, ai, ndonëse e dinte se ajo do të ishte ndryshe, mbeti i tronditur nga shkalla e ndryshimit. Ishin dy botë krejt të pangjashme dhe kjo jo vetëm për shkak të veshjeve, muzikës e dokeve. Kishte diçka më të thellë që i largonte. Te dasma franceze, lumturia ishte e çliruar, e shpallur, kurse te shqiptarët, ndonëse dasma vetë ishte shumë ceremoniale, gati mbretërore, lumturia ishte ekuivoke. Madje, vështirë që kjo fjalë t'i shkonte asaj, ashtu siç ishte e vështirë të pranoje që dasma shqiptare bëhej për lumturinë e djalit dhe të vajzës. Ajo mund të bëhej për shumë arsye, por lumturia e çiftit ishte e fundit që merrej parasysh.

Çdo ditë që kalonte, Angjelini i ri bindej përherë e më fort se i përkiste një populli me fat tragjik. Por pas vajtjes në dasmë, në tempullin e gëzimit, atje ku dukej se do t'i zhbëhej kjo ndjesi, atje pikërisht edhe bindja e tij u bë përfundimtare. Ai i përkiste një populli me fat dyfish tragjik. Një popull i vonuar në histori. Një popull i ndarë më dysh, që lëngonte nën dy diktatura, njëra më e keqe se tjetra. Sa herë që në simbolet dhe shenjat e vendit të tij ai ndeshte dyfishimin, shqiponjën me dy kokë në flamur, dy brirët e dhisë në përkrenaren e Skënderbeut, vetë heroin sublim të kombit me dy emra, një të krishterë e një mysliman, Gjergj Kastriotin, kontin katolik të shndërruar në Skënderbe oriental, për t'u kthyer prapë më pas në kont katolik perëndimor, Angjelinit i vinte ndër mend dytragjedia e kombit të vet. Te kjo dytragjedi, te grremçi i rëndë i saj, donte apo s'donte ai, do të lidhte artin e vet.

IX

Angjelin Preljocaj ishte njëzet vjeç, kur u paraqit në konkursin e koreografisë. Baleti i tij quhej *Tregu i zi*, titull i çuditshëm, që lidhej jo me ndonjë treg të zi në kuptimin e mirëfilltë, por me kërkesat strikte, kalkulimet dhe prapaskenat që luheshin në kulisa për pranimin e pjesëve konkurruese nga juria. Në këtë mënyrë, përpjekja e parë e tij artistike kishte me vete edhe njëfarë manifesti.

Vetëm pasi fitoi, ai e shpjegoi titullin e saj të rrezikshëm, i cili mund t'i kushtonte shtrenjtë.

Vepra e parë e tij, baleti *Larme blanche* e kishte titullin prapë të çuditshëm. Çdonjëri që e dëgjonte në frëngjisht, pyeste: Ç'është kjo? *L'arme blanche* (arma e bardhë, domethënë thika?) apo *Larme blanche* (loti?).

Ato ishin të dyja, thika dhe loti bashkë, dhe gjithë baleti ishte ndërtuar mbi këtë ekuivok dhe mbi raportet e tyre. Përndriteshin të dyja, kryqëzoheshin e lëshonin reflekse, dhimbja e lotit dhe ftohtësia e thikës, lumturia dhe rrezikimi i saj. E ndiqnin njëra-tjetrën, nuk ndaheshin dot dhe në këtë pleksje, pa e ditur as vetë Angjelin Preljocaj kishte dhënë një copë nga ai fatalitet që kishte ndjekur dhe vazhdonte të ndiqte ende kombin e vet.

Bukuria që vret, dhimbja krenare, dialogu i vesës qiellore me lotin njerëzor, këto ishin motive të shpeshta të poezisë në vitet '30. Ishte hera e parë që ato ktheheshin në një tjetër art.

Sa më shumë e shikoje *Armë-lotin e bardhë*, aq më tepër hetoje në të gjakmarrjen ballkanase, humbjen, që kishte brenda krenarinë e kotë, dhe krenarinë, që kishte brenda vdekjen.

Por Angjelin Preljocaj ra përfundimisht në joshjen ballkanase, kur krijoi *Dasmën.* Tani ai ishte plotësisht i ndërgjegjshëm që dasma tradicionale shqiptare s'ishte veçse zbutja, vënia në skenë e rrëmbimit të dikurshëm. Gjithë skenari i vjetër ishte aty, me përjashtim të faktit që tani çdo gjë *luhej.*

Pra, dasma shqiptare rridhte nga rrëmbimi, ishte e një race me të, njëlloj si macja që rridhte nga raca e tigrit.

Motivet e mëvonshme, që e kishin pasuruar atë, kishin përherë një lidhje të drejtpërdrejtë me rrezikimin. Balerini i ri qe habitur, për shembull, kur në një nga dasmat e Ulqinit kishte dëgjuar këngën:

Njëqind krushq, njëqind dasmorë
Dhëndëri vezir mbi ta,
Venë të marrin Stambollin,
Dhëndëri vezir mbi ta.

Skena ishte me të vërtetë surrealiste. Janë krushq apo puçistë këta njerëz? Janë nisur për të marrë nusen dhe udhës, të përndezur nga pija dhe këngët, kanë ndryshuar aty për aty qëllim dhe vendosin të bëjnë rebelim, madje, të marshojnë drejt kryeqytetit perandorak? Apo në këto vargje ka thjesht një figurë poetike dhe Stamboll, domethënë kryeqytet, është nusja, apo, më saktë, seksi i saj, aq i dëshiruar prej të rinjve ballkanas, të privuar, përgjithësisht, nga shijimi i femrës? Është vështirë t'i bësh një zbërthim të saktë kësaj kënge. Ka gjasë që të jenë të dyja, edhe figuracion poetik sipas traditës së Aristofanit, kur në dasma lavdërohej seksi i femrës, si dhe i dhëndrit, por edhe hija e rrëmbimit të stërvjetër, që është shndërruar këtu në një veprim të ndaluar, të kundërligjshëm (marshim drejt kryeqytetit).

Fakti që për dasmorët shqiptarë këto vargje ende sot tingëllojnë të natyrshme, dëshmon më së miri se sa thellë është rrënjosur në kujtesën e vjetër ballkanase rrëmbimi mijëvjeçar.

X

Në kohën që ndodhnin këto, domethënë në kohën kur në trurin e Angjelin Preljocajt muzika dhe lëvizjet koreografike ndërthureshin, përkëdheleshin ose përfyteshin në një mijë lidhje e shkëputje dramatike, në vendin e tij të zanafillës, në Shqipërinë mijëvjeçare, të shndërruar, tashmë, në Republikë Popullore të Shqipërisë, po luhej një nga dramat më të mëdha që mund të përfytyronte mendja njerëzore.

Siç u përmend më lart, diktatura e egër, pasi kishte shembur kishat dhe gjithë tempujt e tjerë shpirtërorë, po përpiqej të mbyste artet, letërsinë, muzikën, ritet, së fundi, vallen. Në Kinë, Revolucioni Kulturor po bënte kërdinë. Në Shqipëri jehona e tij sa vente bëhej më kërcënuese. Rezerva europiane e kombit shqiptar, pasi ishte përpjekur t'i bënte ballë diktaturës për një çerek shekulli, po jepte shenjat e para të lodhjes. Gjithfarë shëmtirash po lulëzonin në të gjitha sferat e artit. Në letërsi, heroi i neveritshëm pozitiv, partishmëria dhe kulti i luftës së klasave po bënin kërdinë. E njëjta gjë ndodhte në kinematografi dhe në pikturë. Një ekspozitë pikture, e hapur në sheshin e *Invalidëve* në Paris, e bëri kritikën franceze të tallej me të drejtë me përçudnimin e pikturës shqiptare. Më shumë se pikturës ajo i ngjante një depoje armësh e një koleksioni modelesh mustaqesh burrërore, tendosje muskujsh e shikime optimiste të heronjve drejt së ardhmes. Muzika përpiqej të mbahej disi, ngaqë s'qe e detyruar të përdorte fjalën ose imazhin e drejtpërdrejtë, por edhe ajo po mbushej me marshe histerike dhe me një surrogato kinse muzike të lehtë, që më shumë i afrohej oratorios dhe kantatës.

Dukej se koreografia, si arti më i abstraguar e i përjetshëm, që kishte lidhje me lëvizjet memece të trupit njerëzor, do të qëndronte mënjanë së keqes. Mirëpo, për habinë e të gjithëve, ndodhi e kundërta. Ajo ishte e para që iu nënshtrua ndikimit kinez.

Skenat filluan të mbushen me ca lëvizje të papara e të pabëra ndonjëherë nga gjymtyrët e njeriut shqiptar. Dukej se shpëlarja e trurit të personazheve, si një lloj paralize u kalonte gjymtyrëve, që tendoseshin, rrotulloheshin e hakërreheshin tej masës, për të dhënë vendosmërinë e heronjve, urrejtjen e luftës së klasave dhe tërë atë shkretëtirë shpirtërore që po pllakoste jetën shqiptare.

Përse koreografia degradoi e para dhe në mënyrë katastrofike? Arsyeja ishte e thjeshtë: në shfaqje vinin udhëheqësit me gratë e, sidomos, me shijen e tyre vulgare. Të kapardisur nëpër lozhat e veçanta, këta injorantë të pashoq, pasi kishin shkatërruar ekonominë e vendit, pasi kishin mbushur burgjet me viktima dhe pasi kishin prishur atje ku kishin mundur jetën njerëzore, vinin të thanin edhe atë gëzim të paktë që mund të jepte vallëzimi njerëzor.

Vërejtjet e tyre ishin po aq të neveritshme sa shijet e tyre. A mund të kërcehej në një skenë revolucionare socialiste gjysmëzhveshur, si në skenat borgjeze? Dhe, sidomos, a mund që në një balet socialist personazhi të kapë nga mesi, ose aq më keq, nga rrëza e kofshës heroinën komuniste dhe ta ngrejë përpjetë?

Kurrsesi, jo.

Skenat nisën të mbusheshin me personazhe me kasketa punëtorësh dhe me rroba ushtarake, me femra që bënin gjeste burrash, me një histeri të pafund lëvizjesh, që jepte gjoja dinamizmin dhe optimizmin e jetës socialiste.

Angjelin Preljocaj punonte në Paris dhe mund të tallej, dhe të mos e çante kokën se ç'ndodhte matanë kufirit, ku fillonte perandoria e kuqe. Mirëpo ai, për çudi, shqetësohej nga ai ankth, ndiente rrezatimin e tij të keq dhe përpiqej ta largonte.

Ai shqetësohej, me sa dukej, mbasi në atë perandori bënte pjesë vendi i tij. Ndërsa ai krijonte valle në skenat e Europës, në tokën ku jetonte populli i tij po thaheshin, si nga një murtajë, lëvizjet shekullore, për t'u zëvendësuar nga lëvizje të vdekura.

Aty-këtu mbi djerrinë një shushurimë bari,
Ca shkëmbinj me gurmazë të shqyer.
Kjo është gjithçka
Që ka mbetur nga grahma e fundit e gjuhës.

Në hapësirë, a i sheh,
Vijnë rrotull ca rrathë të çuditshëm ajri,
Janë varret e valleve.

Ku janë baladat, eposi, kujtesa e kombit?
Qimiterin e tyre mund ta gjesh,
Aq sa të gjesh qimiterin e bubullimave.

Një thirrje i vinte që andej vazhdimisht. Një thirrje për ndihmë. S'ishin vetëm të burgosurit nëpër burgje që vuanin, s'ishin vetëm të internuarit, të rrëzuarit, të shkallmuarit. Skllavëria sa vente zbriste më thellë. Ajo donte të përjetësohej, duke u bërë natyrë e dytë e njerëzve. Diktatura përpiqej në fillim ta mpinte mendjen njerëzore, për të shkuar pastaj më larg: ta thjeshtonte atë që i qenë dashur mijëra vjet të ndërlikohej madhërisht: trurin njerëzor. Pas kësaj, ajo do të rrënonte historinë, për ta zëvendësuar me një histori të rreme, të zëvendësonte artin me një tjetër art, gjersa, ashtu si djalli, t'ia kërkonte haptazi shpirtin njeriut. Për të burgosurit interesohej Amnesty International, po kush të merrej me artin që po vdiste mu në sy të gjithë botës?

Angjelini e kishte ndier edhe më parë se kishte një vëllazëri botërore të artistëve.

Që vendi i tij bënte pjesë në atë univers të egër e shkretan, kjo ishte dhe një arsye tjetër për të që të interesohej për atë botë. Vetvetiu ndillej prej saj, turbullohej, bëhej nervoz. Kështu, ai krijoi veprën e tij *Anos hero*, që është si refleksi në një pasqyrë i botës komuniste, këtij deliri të mbrapshtë që rrezatonte që larg ankth. Bota e lirë s'mund të ishte e qetë me atë krim të shpërndarë në miliona kilometra katrore.

Përherë e më tepër, ai zhytej në misterin e valles. Një herë i dukej se e kishte kuptuar plotësisht këtë alfabet të trupit, por herë-herë ai i bëhej i huaj e i largët, si hieroglifet. Dhe sulej prapë të kapte atë që i ikte, i rrëshqiste nëpër erë.

Përherë e më tepër, ai bindej se vallja lidhej me të fshehtën universale të jetës, me ndjekjen e përjetshme të brezave njerëzorë, që vinin e iknin nga kjo botë sipas një ritmi e harmonie të epërme.

Regjimet e egra nuk e donin vallen, pikërisht për këtë. Ato qenë përpjekur t'ia mbushnin mendjen vetes dhe të tjerëve se jeta njerëzore nuk rregullohej prej kurrfarë harmonie të epërme, po prej ligjeve të shpikura prej tyre ose prej diktaturave të tyre të egra. Për to, jeta njerëzore nuk mund të përftohej veçse e gjymtuar prej luftës së klasave, prej urrejtjes, egërsisë dhe ndërprerjeve tragjike.

Por ato nuk e donin vallen sidomos për zbutjen dhe fisnikërinë që ajo e kishte të vetvetishme. Valle do të thoshte përkitje e kujdesshme e tjetrit, afrim dhe largim harmonioz, rikthim i përhershëm te njeriu. Ajo ishte një qortim i përhershëm i brutalitetit. Krahun ose shkelmin që godiste, ajo e moliste, e çarmatoste. Ajo të ftonte për marrëveshje dhe për lutje. *Lutja është e mirë për gjunjët, pra, edhe për vallen*, kishte thënë Merce Cunnigham. Por pikërisht lutjes dhe providencës, diktatorët u trembeshin më shumë se gjithçkaje.

XI

Vallja, ashtu si pija, të nxit dëshirën të flasësh për të. Në të vërtetë, ajo ka diçka të afërt me pijen: marramendjen. Në të dyja rastet, ndjesia e ikjes nga realiteti është tepër e fortë. Që të çmendurit, gjithashtu, kanë dëshirë të vallëzojnë, kjo ridëshmon afërsinë e valles me lirinë. Të çmendurit, në njëfarë mënyre, gëzojnë njëfarë lirie. Kjo bie në sy sidomos në regjimet tiranike. Në vitet 1967-1972, gjatë Revolucionit Kulturor Kinez shumë shkrimtarë e artistë kinezë, për t'i shpëtuar ndjekjes së pamëshirshme, u hoqën si të çmendur. Pati nga ata që, megjithatë, u dërguan në orizore, ashtu siç pati të tillë që pas mbarimit të lemerisë, atëherë kur deshën të hiqnin maskën, e kuptuan që ajo maskë nuk hiqej më dhe ata, në mos kishin shkalluar plotësisht, ishin aq i ngadalshëm, saqë, zakonisht, përballë plakjes sonë të rrufeshme, ai ngjan si një përtëritje.

Ndoshta, nuk është e rastit që dykahja e artit, më qartë se kudo, është dëshmuar në vallen e vazos së vjetër ilire. Angjelin Preljocaj më thotë se ai e zbuloi tërësisht tokën me ndihmën e valles. Për t'u ngjitur lart, për të kërcyer, akti i parë është mbështetja në tokë. Pra, pa lejen e tokës, domethënë të vdekjes, ti s'mund të fitosh kurrë atë liri të përkohshme.

Ti je i detyruar gjatë kërcimit të kthehesh e të rikthehesh te toka, sepse ti je njeri. Afati që ajo të jep është i shkurtër, ndaj edhe vallëzimi s'është veçse bashkimi i mijëra afateve të tilla, në secilën prej të cilave toka, njëlloj si zyrat e kontrollit të vizave nëpër aeroporte, vë vulën e saj.

XII

I tregoj Angjelin Preljocajt një çast tepër të rëndësishëm të jetës sime: vajtjen për herë të parë në kinema.

Isha tetë vjeç. Sapo kishte mbaruar lufta dhe kinemaja e vetme e qytetit, e mbyllur për një kohë të gjatë, ishte rihapur. Në afishet lajmërohej një film sovjetik *me luftë* dhe gjithë qyteti ishte si i ndërkryer. Për mua, që shkoja për herë të parë, krejt ajo ditë ishte si e përshkuar nga një ethe padurimi. Ngaqë mjaft njerëz nuk kishin qenë kurrë në kinema, përfytyrimi i tyre për atë që do të shihnin në ekran i kapërcente të gjitha caqet. Tregoheshin gjithfarë marrëzish, nga ata që s'kishin parë kurrë një film, por që, për çudi, nuk kundërshtoheshin as nga ata që kishin parë. Kjo vinte për dy arsye: ose nga përtesa për të kundërshtuar, ose ngaqë kishin vite që s'kishin qenë në kinema, kujtonin se gjatë kësaj kohe kinemaja kishte ndryshuar aq shumë, saqë ata mund të mos i dinin të rejat e fundit!

E pyeta një burrë të vjetër, që ishte përpara meje në radhën e biletave, se a ishte e vërtetë që do të shihnim njerëz të gjallë që lëviznin e që luftonin, dhe ai më tha se ishte krejtësisht e vërtetë. Do t'i shohim fare pranë, tha, ja, si unë e ti, edhe njerëzit, edhe rusët e gjermanët, dhe aeroplanët.

Do t'i shohim dhe aeroplanët krejt, krejt si prej vërteti? ngula këmbë unë.

Si prej vërteti që ç'ke me të, tha ai.

Do të na kalojnë mbi kokë?

Po, tha ai. Do të na shurdhojnë veshët, do ta shikosh.

Ishte kjo frazë e tij, kjo frazë e tij e shkaktuar, ndoshta, nga pakujdesia ose ngaqë ishte hera e parë që vinte në kinema, që shkaktoi një trazim e një zhgënjim tepër të madh tek unë gjatë gjithë kohës që vazhdoi filmi.

Zhgënjimi nisi qysh në krye, kur ekrani ku shfaqeshin pamjet m'u duk fare i zbehtë e ngjyrë hiri, në krahasim me gjithë atë që e kisha përfytyruar unë ato ditë e net të ethshme. Por zhgënjimi u bë i plotë, kur e humba çdo shpresë se aeroplanët, e pas tyre njerëzit, do të dilnin nga pëlhura e ekranit, për të fluturuar nëpër sallë mbi kokat tona.

U ktheva në shtëpi hundë e buzë. Ajo pëlhurë e hirnosur m'u duk një mashtrim, një tallje, një *pengesë* që ishte vendosur midis meje dhe botës. Ishte hera e parë që, pa e ditur ende ç'ishte arti, tani gjysmë të lojtur. Ata nuk shkruanin më, por, ndërkaq, vallëzonin...

Si të çmendurit e vërtetë, si ata që u hoqën të tillë, shpalljen e parë të lajthitjes së tyre, si të thuash, deklarimin e saj, e bënë, së shumti, me ndonjë vallëzim.

Për të kapur më mirë përmasat e diçkaje, njeriu mendon mungesën e saj. Si do të ishte bota pa vallen?

Në çastin e parë duket krejtësisht e papërfytyrueshme. Mendimi i parë që të vjen është rrotullimi i rruzullit tokësor rreth vetvetes, pra, një lloj vallëzimi i tij. Ky rrotullim nuk mund të ndërpritet. Siç thonë, bën pjesë në një valle më të madhe, në atë të galaktikës dhe galaktika vetë s'është veçse pjesëmarrëse në një tjetër vallëzim: në atë të universit. Duam apo nuk duam, ne jemi të rrethuar prej vallëzimit.

Mendja ka prirje të shkëputet shpejt nga tërheqja kozmike, kështu që biseda jonë kthehet te vazoja e vjetër ilire, ku është dëshmuar një valle me kahje të mbrapshtë.

A mundet vallja të kurdiset vetëm në kahjen e mbarë? A mund të nxirret prej saj e keqja, domethënë vdekja? Së fundi, a duhet kjo dhe, pas kësaj, vallja a mund të quhet prapë valle, apo i duhet gjetur një emërtim i ri, për shembull, *çvalle?*

Ne bisedojmë lirshëm për të gjitha këto. Në vazon e vjetër ilire ne gjejmë, përherë e më tepër, një kuptim të thellë: që arti nuk mund të jetë i njëkahshëm. Vlera artistike, ashtu si çdo vlerë tjetër, i ka në vetvete edhe jetën, edhe vdekjen. Ajo bashkë me jetëgjatësinë i ka brenda shkatërrimin, ndërprerjen. Madje, ajo që quhet përjetësi njëmendësohet vetëm nëpërmjet shkatërrimit. Veçse për vlerat e *përjetshme* shkatërrimi është para se të takohesha me të, ndeshesha me gjymtimin, domethënë kufizimin e tij. Dhe ndoshta ishte shtysa e parë, ende e turbullt, për ta kapërcyer atë pengesë, për të dalë përtej, matanë, në një zonë tjetër, që e kujtoja më të lirë dhe më të vërtetë.

Pas këtij kujtimi, merre me mend që ne do të bisedonim për marrëdhëniet e valles me fjalën, për marrëdhëniet, në përgjithësi, midis arteve. Ne do të bisedonim për të tretën, për të katërtën, për të dhjetën herë rreth lidhjeve të valles me gjuhën, me reumatizmën, me sëmundjet e tjera që, duke ia dëmtuar gjymtyrët njeriut në rini, ia shtojnë dëshirën për valle. Ne kujtojmë me këtë rast personazhin gagaç të Jukio Mishimes, ai që dogji tempullin, në romanin *Tempulli i artë*, ngaqë përsosja e bukurisë së tempullit e sfidonte gjymtimin e tij. Së fundi, do të kujtojmë, këtë herë nga vitet e shkollës, *Laokoontin* e Lesingut, ku flitet gjerësisht për marrëdhëniet e skulpturës me poezinë, e sidomos pjesën e dytë të tij, atë që nuk arriti ta shkruante, në skicat e së cilës gjenden shënime me interes të veçantë, si për shembull, krahasimi midis tmerrit të Laokoontit, ashtu siç e përshkruan Virgjili, ku vendin kryesor e zënë klithmat e tij të kobshme dhe tmerrit që ka dhënë skulptori, këtë herë jo me anë të klithmave, ngaqë klithma në skulpturë nuk mund të jepet veçse fare zbehtë, por me anë të shtrëngimit të muskujve.

Papritur, ne vëmë re se bisedat tona, ashtu si pjesa dërrmuese e bisedave njerëzore, kanë një përsëritje qerthullore, çka na krijon ndjesinë e një fataliteti të këndshëm: atë që, duam apo nuk duam ne, jemi të rrethuar prej valles.

Kur Angjelin Preljocaj më thotë se nuk ka motiv që ai të mos e shprehë me anë të valles, se ai mund të krijojë valle për shkretëtirën, për pasditen e qetë të vjeshtës, për autostradën, terrorin policor, madje për atë që ngjan si gjëja më e palëvizshme në botë, për gurin, unë e kuptoj dhe e besoj krejtësisht.

Vallja gjendet kudo dhe koreografi s'bën gjë tjetër veçse punën e magjistarit, ashtu siç përfytyrohej dikur, që e çngrin ose e çmagjeps atë që ka ngrirë një tjetër magjistar.

Me fjalë të tjera, ai e çliron vallen.

Të vjetrit e gjenin simbolin e saj në lëvizjet e yjeve e të universit, por ajo vetë, ose shëmbëllimi i saj, gjendet në të gjitha hapësirat e jetës apo të shpirtit. Ajo gjendet në marramendjen e dashurisë ose në humbjen e toruas, po aq sa shfaqet në rrotullimin e çmendur të rrotës së karrocës, që rend duke spërkatur anash baltë dhe gjak në fushën e lashtë të betejës. Ajo gjendet në fushën e orës prej bronzi, në rishfaqjen e stinëve dhe në venitjen e shpresës. Por ajo gjendet në shpërthimin e dehjes ose të guximit të marrë, në terrorin e shtetit diktatorial, në rrethin e rrezikut të fatkeqësisë apo të sëmundjes, që sa vete mbyllet rrotull teje. Ajo gjendet te cikloni i beftë, te një gjeth i verdhë që bie në parkun e ftohtë dhe te fluturimi i plumbit, që afrohet duke bërë mijëra rrotullime, ndërsa të kërkon ty dhe vetëm ty...

XIII

Në një kafene në "Saint-Germain", ne ndjekim me sy rrjedhën e kalimtarëve që s'kanë fund.

Duke lexuar një roman të vjetër kinez, më duket *Ëndrra e pallatit të kuq*, ose e kam gjetur në të, ose leximi i tij më ka nxitur idenë se gjithë sasia e ndjesive, mendimeve, fjalëve, lëvizjeve, me fjalë të tjera, krejt ai që mund të quhet thesari i përgjithshëm botëror, është pak a shumë i pandryshueshëm si sasi. Ajo që ndryshon është vetëm shpërndarja e tij te njerëzit.

I gjithë ky thesar mund të jetë i shfaqur apo i pashfaqur, njëlloj si xeherorët që diku ndodhen nën tokë, pavarësisht nëse njerëzit arrijnë t'i nxjerrin apo jo.

Duke parë turmën që mbush trotuaret, në orët e fundit të pasdites, në "Saint-Germain", ndërsa bashkë me rënien e muzgut ajo bëhet më e errët, duke ndjekur, pra, me sy ato mijëra gjymtyrë që lëvizin e lëvizin pambarimisht, padashur të lind pyetja: midis këtyre mijëra e mijëra lëvizjeve të rëndomta, si ta gjesh arin, si t'i gjesh diamantet? Me fjalë të tjera, si ta gjesh zonën hyjnore, te secila ecje e secilit njeri?

Takimi im me Angjelin Preljocajn ka marrë fund dhe unë ndjek me sy ecjen e tij drejt metrosë *Saint-Germain des Prés*.

Ai është atje, midis turmës së errët, njeriu që ka mjeshtërinë të nxjerrë prej njerëzve të tjerë ca vedra qiell dhe ca flatra hyjnish. Me fjalë të tjera: të nxjerrë vallen.

Ai zbret shkallët dhe, ndonëse i afrohet gojës së nëndheshme, që të kujton kalimet e ferrit, edhe aty, madje, ndoshta aty më shumë se kudo, ai mbetet prapë kushëri i engjëjve. Ndoshta nuk është e rastit që edhe emrin e ka të tillë: Angjelin.

Spanjë, Marbella, verë 1991

Roy Jacobsen

NJË DRITARE E RE

Tregim

E përktheu nga origjinali norvegjisht Qerim Raqi

Atë vjeshtë doja t' i ndërroja dritaren asaj shtëpie të vjetër. E hoqa të vjetrën dhe po qëndroja mu në mes një dhome të huaj duke vështruar jashtë përmes një të çare në mur.

Që larg, pashë një burrë tek vinte drejt meje nëpër arën me elb. Supi im i binte në bel. Fytyra e tij ishte fshehur nën hijen e strehës së kapelës. Dita ishte e qetë dhe e mjegulltë.

Shiu depërtonte natën përmes të çarave në mur dhe çilimi mbi dysheme ishte lagur; shtëpia tashmë ishte bërë për keqardhje.

Papritmas kishte vdekur gruaja e moshuar për të cilën punoja. Para se të arrija ta ndërroja dritaren. Meqë shtëpia nuk kishte më nevojë për shërbimet e mia atë ditë erdha vetëm për t' i marrë veglat e punës; i mblodha dhe u nisa drejtë arës , aty ku kishte ecur ajo figurë e panjohur, vazhdova deri tek anija që ishte ankoruar pranë plazhit.

Mu në mes të liqenit të errët ngrita velat, duke vështruar shtëpinë për herë të fundit. Arën, lisat, shtëpinë e vogël e të kuqe dhe bregun përtej ngjyrave vjeshtore. Aty pranë hendekut pashë ca pata që shkonin kah gjiri.

Kaluan disa ditë pa menduar në atë grua dhe për atë shtëpi. Por ato më rrinin shumë afër, ngase nuk mund të pëfqendrohesha në punën time të re.

Kështuqë një mëngjes vendosa të kthehem. Anija nuk dukej aty ku ishte ankoruar. Ishte mbushur përgjysmë me ujë dhe gjethet e vyshkura binin nëpër direkë; tani kjo ishte anija ime.

Që nga fusha e kuptova se ndërkohë dikush kishte qenë në shtëpi. Dyert ishin të mbyllura, por unë hyra përmes të çarës së murit. Pa e hulumtuar mirë punën mora veglat, ca dërrasa dhe fillova punën.

Pas disa orëve e kisha vënë dritaren e re. Ishte më e madhe se dritarja e vjetër dhe e kthjellët si uji. Mund ta shihje krejtë arën, kopshtin e vjetër veror, dhe ahet deri tek hendeku.

E pastrova dhomën dhe hyra në kuzhinë për të bërë një kafe. Befas më kaploi një njenjë e çudithshme.; dikush ka qenë këtu dhe ka hequr saksitë e luleve. Në dhomë kukëzat ishin vënë njëra pranë tjetrës me kujdes.

Çelësi ishte vënë nga ana e brendëshme e derës së kuzhinës. Dola jashtë dhe ju solla rrotull shtëpisë. Të gjitha lulet ishin hedhur grumbull në komposto. Për fat të mirë shumica sosh nuk ishin vyshkur akoma. I mblodha me kujdes, i solla në shtëpi dhe i vura në vendin e tyre, secilën në saksinë e vet. Pastaj i ujita.

Pasiqë kafja akoma nuk ishte zier, zura të kërkoja perde për dritaren e re. Në një kthinë të papafingos gjeta diçka që mund të përdorej. Në një qoshe tjetër gjeta ca shufra dhe rrathë. Ishte lehtë për t' i montuar. Perdet e dritares së re.

Mora filxhanin me kafe, u ula në një karrige pranë dritares për ta pritur burrin që ishte shfaqur në arë. Gruaja i përket një burri. Kishte rënë një mjegull e dendur dhe qielli ishte gri.

Burri nuk erdhi.

Kur u bë ftohtë shkova për t' i futur ca drurë në stufë. Era e drurëve të mështeknës ka një efekt qetësimi. Qetësia u bë edhe më e këndëshëme kur pashë tymin e oxhakëve tek ngjitej drejtë qiellit. Tani kjo ishte shtëpia ime.

Por më mungonte gruaja; dola ta kërkoja. Në murin e dhomës, mbi një tryezë ovale me lule, ishte një fotografi nga dita e martesës. Ai burri i ri mund të ishte ky burri i arës. Kurse gruaja e re ishte kjo gruaja.

Në një sirtar ishin ca stoli të kvalitetit të dobët. Bylyzykë. Vathë. Gjerdanë. Shumica e perlave ishin vjetruar, u kishte humbur shkëlqimi dhe u mungonin gurët e çmur. Të gjitha bashkë ishin vënë grumbull në një sirtar. I mblodha të gjitha dhe i vura në një arkëz që ishte zbukuruar me guaska ngjyrash të ndryshme.

Një arkëz e vjetër. Disa nga guaskat ishin prishur. Në sirtarin e poshtëm gjeta një album fotografish. Me njerëz të panjohur, të një kohe të panjohur për mua. Fëmijë, nipër e mbesa, kusherinj, miq? Shumica nga koha e fëmijërisë, por edhe nga punët e bujqësisë dhe udhëtimet.

I vështroja fotografitë aq gjatë dhe me aq kujdes saqë mund të tregoja për të gjitha fatet jetësore të personazheve aty. Po i mësoja historitë e secilit nga ta. Historitë e përditshmërisë së tyre. Rutinat. Stinët. Ngjarje të veçanta, të mëdha dhe ca tragjedi, të gjitha në bazë të veçorive dhe shprehjeve të ndryshme të fytyrave të tyre. Sy që më vështronin dhe më rrëfenin. Ata njerëz që kishin jetuar dikur; ndoshta jetojnë akoma. Dhe vështrimet e tyre ndalonin kohën e kaluar mes tyre dhe meje. Flisnim për të njëjtat gjëra.

Kur e lash mënjanë albumin, kishte filluar të errësohej. Në dhomën e vogël, me ngjyrë të verdhë, kishte ca stoli të lira dhe jo shumë të vjetruara. Piktura të bëra pa kujdes. Kujtimi i një fillimi të ndrojtur të një kohe në mirëqenie. Një barometer jashtë funksionit. Gjësende të vogla prej bakri. Filxhana me fotografi pejsazhesh nga natyra.

Kallaj, plastikë e zezë dhe rozë. Në të gjitha raftet dhe vitrinat. Peshq të vegjël të qepur në pëlhurë. Punëdore, një gjel i punuar me bitumen, një kasolle pranë liqenit gri, nje burrë pranë një zjarri të kuq. Një peshk prej druri si varëse për peshqir. Një gotë me emra vendesh të zhdukura. Një buqetë me lule plastike, e pluhurosur. Një orë muri me tik- taket që punonin akoma.

Shkoja mobilje më mobilje, dollap më dollap, i shikoja sendet e vjetra, i prekja me dorë, i studjoja dhe i krahasoja me fotografinë e gruas.

Nuk lija asgjë anash.

Në një gotë të vogël mesingu gjeta një çelës. Çelësin e orës së murit. Mora një karrige, hypa në të dhe e hapa orën. Ishte një orë shumë e vjetër. Çelësi përshtatej mirë në vrimë, e lëviza çelësin. Mendoja se po i bëja një shërbim vetë jetës duke mos u ndalur.

Një dollap në korridor ishte plotë me dhurata krishtlindjesh, të grumbulluara për shumë vite. Disa mund të ishin aty për dhjetë vite. Të gjitha ishin të hapura, por pakot e dhuratave ishin paluar me kujdes. Me siguri ajo vetëm i kishte shikuar njëherë se çfarë kishte në to dhe i kishfe lënë pastaj mënjanë.

Aty ishin katër komplete për kripë dhe piper. Tri kutia për sheqer, dy nga të njëjtat. Katër komplete lugësh të çajit. Poaq kuti thikash dhe pirunësh. Ca gota. Një vazo as e mirë as e shëmtuar. Dy ngrohëse vezësh. Një llampë e vogël me ngjyrë të kuqe. Gjësende të përdorura, asnjë gjë nga higjiena personale, vetëm detyrime të vogla harrestare.

Nuk pash libra në atë shtëpi. As ndonjë gazetë. Por aty ishte një radio dhe një televizor i vjetër me antenën e ngjitur në mur.

Në dhomë kishte thasë, kartonë, kutia, sirtarë njëri mbi tjetrin. Ishte e mbushur me rroba dhe rraqe, thëngjill, drurë dhe patate. Ashtu e brishti siç ishte ajo duhej t' i kishte të gjitha afër. Pashë rrobat, filxhanat, pjatat që i kishte në frigorifer. E pashë si lante enët, duart e saj tek mirrnin copa druri që i fuste në shporet. Pashë pikturat në mur, si i kishte vendosur gjësendet. Orenditë. Një njollë të gjelbër në vaskë. Një shami në shpinën e një karrige. Pashë shprehitë e saj, ditët e saj, jetën e saj.

Në dhomë gjendej një piano e përdorur mirë. Një psaltar i përdorur mirë ishte mbi ulësen e pianos. Shtëpia kishte poaq ëndërra dhe orë vetmie si meloditë e pianos.

U ula për të ekzekutuar ca akorde. Për ëndrrën e asaj gruaje të moshuar për jetën e amshueshme. Muret pëshpërisnin lehtë dhe dëgjova zërin e saj të kujdesshëm:

Zoti është Zot edhe nëse të gjitha vendet mbeten të shkreta.

Zoti është Zot edhe nëse të gjithë burrat vdesin. ..

Pastaj u ulëm secili në karrigen e vet pranë dritares së re. Ishte errësuar dhe ne nuk ndezëm qirinj. Por i mbanim dorën njëri- tjerit duke pritur atë burrin që ishte shfaqur në arë. Pas pak ne e pamë atë duke ardhur drejt nesh, që larg.

Kallinjtë e grurit i binin deri në bel. Fytyra e tij ishte fshehur nga hija e strehës së kapelës. Ndjeva dorën e saj tek dridhej lehtas.

Në atë çast unë u ngrita, e putha me kujdes në faqe dhe dola jashtë. Anija qëndronte e ankoruar aty tek plazhi. Mu në mes të liqenit të errët ngrita velat dhe po vështroja atë shtëpi për të herë të fundit.



Clarence Day

BABAI KËRKON TË QEPË NJË KOMÇË

Tregim

Përktheu nga origjinali Aristidh Shqevi

Sipas pikëpamjes së babait, komçat ishin problemi më i madh që ai kishte. Këmishët dhe çorapet e grisura nga të gjitha anët mund të visheshin përsëri, por të brendshmet me komça të këputura, kurrë. Shpejtësia me të cilën ai vishej, dukej sikur ia hiqte besimin komçave dhe i detyronte ato t'i largoheshin atij. Për më tepër, ato këputeshin fare papritur në situata krejt të papërshtatshme.

Në të tilla raste, sigurisht, ai kërkonte ndihmë, por këtë ama e donte menjëherë. Ai shfaqej tek dera e dhomës së mamasë me një jelek në dorë dhe një komçë të pabesë në tjetrën, duke ngulmuar që ajo të qepej aty në çast; sa herë që ajo përgjigjej se në atë çast nuk kishte mundësi, babai indinjohej tamam sikur të kishte qenë duke u mbytur dhe një notar i skuadrës së shpëtimit ta kishte njoftuar se do t'i vinte në ndihmë vetëm të nesërmen.

Kur indinjata shkonte aq larg sa t'ia rrëmbente dhe gjykimin, me një zë të ashpër ai shtonte: 'Shumë mirë atëherë, komçën do ta qep vetë,' dhe pastaj vihej në kërkim të gjilpërës dhe fijes. Mamaja e dinte shumë mirë se ç'do të thoshe kjo. Ajo i lutej atij që ta linte jelekun në shportën e saj të punës për ta qepur atë të nesërmen. Babai këmbëngulte në të tijën. Për më tepër, mendimi i forcohej nëse rastiste që vështrimi i tij ta haste shportën e ta konstatonte aty pirgun e madh të çorapeve, të cilat, plot pezmatim, prisnin radhën të lëna në harresë.

'Kam plot një muaj që i kërkoj çorapet me topa bojë qielli,' shpërtheu ai gjithë inat një mbrëmje para se të uleshim për të ngrënë darkë. 'Nuk bëhet asgjë për burrin në këtë shtëpi. Edhe komçat më duhet t'i qep vetë. Ku janë gjilpëra dhe fija?'

Mamaja ia jepte mjetet e punës pa dëshirë. Ai ecte me hap të rregullt në mes të dhomës, zinte vend buzë divanit dhe bëhej kati për punë. Ndriçimi i llambës me gaz ishte më i mirë pranë tavolinës së shkrimit, por për shkak të mungesës së vendit të bollshëm, atij nuk i pëlqente që të ulej në karrige. Mbi divan, pranë vetes, vendoste gërshërët, jelekun dhe rrokelin e fijes, njomte gishtërinjtë, mbante gjilpërën lart në pozicion ballor dhe mundohej t'ia kalonte fijen përmes.

Si çdo komandant, babai kërkonte që bindja të ishte e menjëhershme, lëre pastaj që donte të kishte të bënte gjithmonë me njerëz kompetentë. Gjilpëra e pabindur dhe kokëfortësia e pandreqshme e fijes e detyruan të shante. Ai e la gjilpërën të zhytur në divan me qëllim që të njomte gishtërinjtë, dhe u përpoq ta drejtonte fijen përsëri. Kur u mat për ta marrë gjilpërën, pa se ajo ishte zhdukur. Kërkoi me dorë rreth e rrotull. U ngrit në këmbë, duke shtrënguar fort fijen e perit, dhe u kthye prapa ballë për ballë divanit për të parë se ku mund të ishte fshehur ajo, por gjatë kthimit, rrokeli i fijes kërceu në dysheme, u rrokullis dhe u çmbështoll.

Krizat e epilepsisë ishin bërë shkak që bashkëshortët e dy shoqeve të mamasë të shkonin në botën tjetër. Ndaj ajo trembej së tepërmi kur mendonte se e njëjta gjë mund t'i ndodhte edhe babait. Me të dëgjuar britmat e tij, mamaja sulej në dhomë. Ai ndodhej aty, i shtrirë sa gjerë e gjatë në dysheme, ashtu siç në të vërtetë ajo e priste. Duke u munduar ta kalonte kokën nën divan, ai çirrej me të madhe, fytyra i merrte një përflakje të veçantë dhe sytë i përskuqeshin aq shumë, saqë mamaja tmerrohej. Lutjet për ta ndalur vetëm sa e bënin më epileptik. Thoshte se do të ishte i mallkuar nëse ndalej. Në atë moment ngrihej në këmbë me rrokelin e fijes në dorë, flokët të shpupuritur, dhe pamjen triumfuese. Mamaja vraponte për të marrë një gjilpërë të re. Ajo ia kalonte fijen dhe, më në fund, ai fillonte qepjen.

Babai e qepte komçën furishëm, me ngulje e shkulje. Nëna thoshte se nuk mund të duronte duke parë, por edhe të largohej nga dhoma e kishte po aq të vështirë. Ajo qëndronte duke vështruar, në një gjendje hipnoze e tmerri dhe me një dëshirë munduese për ta qepur vetë komçën. Njëri-tjetrit i flisnin të acaruar. Pikërisht në ato momente ndodhi e pashmangshmja: gjilpëra doli me forcë përmbi jelek dhe ndeshi në komçë. Babai e shtyu atë me më tepër forcë dhe, për pasojë, ajo shpërtheu përmes birës duke u ngulur drejt e në gishtin e tij.

Ai u hodh përpjetë tek ulëriti me të madhe. Të shpoheshe në këtë mënyrë nuk ishte vetëm e dhimbshme, por njëkohësisht dhe fyerje. Ai u kthye nga unë, kaloi me hap të rregullt nëpër qilim dhe, duke shtrënguar gishtin fort, i zemëruar tha: 'Faji është i sat' ëme.'

W. Somerset Maugham

TAKIMI NË SAMARRA

(*bazuar në një legjendë të vjetër arabe*)

Autori i këtij rrëfimi në gjuhën origjinale arabe është anonim. Shkrimtari i parë që e përfshiu këtë legjendë të vjetër në njërën prej veprave të tij ishte W. Somerest Maugham, dhe pikërisht në volumin e titulluar *The Appointment in Samarra*, botuar në vitin 1933. Edhe autorë të tjerë e kanë përfshirë këtë legjendë në veprat e tyre. Jeffrey Archer e përfshin në vëllimin e tij me tregime *To Cut a Long Story Short,* Harper Collins (2000). Në vitin 1934, John O'Hara botoi romanin *The Appointment in Samarra*, një roman ky që nuk ka të bëj me legjendën arabe, por që në të vërtetë, përshkruan jetën e tregtarit të makinave Julian English, rrjedha e jetës së të cilit merr një drejtim të paparashikuar nga momenti kur ai i përplas dikujt në fytyrë një gotë me uiski.

Vdekja rrëfen: *Na ishte njëherë një tregtar nga Bagdadi, i cili e dërgoi shërbëtorin e tij për të blerë ushqime në treg; brenda një kohe të shkurtër, shërbëtori, me çehre të zbehur nga frika dhe duke u dridhur si pupël, u kthye tek tregtari dhe tha: Zotëri, pak më parë teksa ndodhesha në treg, një grua më shtyu me bërryl në mes të turmës, dhe kur u ktheva, pashë se ishte vetë Vdekja ajo që më kishte shtyrë. Ajo më vështroi duke bërë dhe një gjest kërcënues; atëherë, a ma jepni kalin tuaj që ta shaloj e të largohem nga ky qytet për t'iu shmangur fatit tim? Do të shkoj në Samarra, aty ku Vdekja nuk ka për të më gjetur. Tregtari ia plotësoi kërkesën, shërbëtori hipi mbi kalë, e shpoi me mamuze në dy pjesët anësore të barkut dhe u largua me shpejtësinë më të madhe që kali mund të galoponte. Menjëherë më pas, tregtari zbriti në treg dhe më vuri re tek qëndroja në mes të turmës; ai m'u afrua dhe më pyeti, Përse i bëre gjest kërcënues shërbëtorit tim që në çastin kur e pe sot në mëngjes? Nuk ishte gjest kërcënues, thashë unë, por ai ishte thjesht një britmë habie. U çudita që e pashë në Bagdad, sepse sonte kisha lënë takim me të, në Samarra.*



FJODOR DOSTOJEVSKI

"Ana Karenina" si fakt i një rëndësie të veçantë

Përgatiti dhe përktheu nga origjinali Bujar Hudhri

Dhe ja, pikërisht atëbotë, domethënë këtë pranverë, rastisi një mbrëmje të takoj në rrugë një nga shkrimtarët e mi më të dashur. Rrallë takohem me të, një herë në disa muaj, dhe gjithmonë rastësisht, pothuaj në rrugë. Është nga anëtarët më të shquar të atyre pesë apo gjashtë beletristëve tanë, të cilët së bashku është pranuar, s'di pse, të quhen "plejadë"[1]. Të paktën, kritika, fill pas publikut, i ka ndarë veçan, para gjithë beletristëve të tjerë, – dhe kjo ndodh prej kaq kohësh, – megjithatë po kjo pesëshe, "plejada", nuk po zgjerohet. Më pëlqen të takohem me këtë romancierin tim të këndshëm e të dashur dhe dua t'i provoj, mes të tjerash, se nuk e besoj dhe assesi nuk dua ta besoj që, siç thotë, është plakur dhe që s'ka për të shkruar më. Nga kuvendimi i shkurtër me të, kurdoherë marr me vete ndonjë fjalë cazë delikate dhe largshikuese. Këtë herë kishim se çfarë të bisedonim, tashmë kishte filluar lufta. Por ai në çast zuri të fliste drejt e për "Ana Kareninën". Unë vetë po ashtu sapo e kisha lexuar pjesën e shtatë, me të cilën përfundonte romani i botuar në revistën "Russkij vjestnik". Bashkëbiseduesi im në dukje nuk është ndonjë tip që entuziazmohet kollaj. Këtë herë më befasoi me forcën dhe këmbënguljen e zjarrtë të mendimit të tij për "Ana Kareninën".

- Kjo është një gjë e padëgjuar, e klasit të parë. Cili nga shkrimtarët tanë mund të matet me të? Po në Europë, cili mund të paraqesë qoftë diçka që t'i ngjajë?[2] A kanë pasur ata, në gjithë letërsitë e tyre, gjithë këto vitet e fundit, apo shumë kohë më përpara, një vepër e cila mund t'i rrijë në krah?

Ajo çka më habiste, kryesorja, në këtë verdikt, të cilin e ndaja edhe vetë krejtësisht, ishte aluzioni për Europën, çka u vinte për shtat pikërisht atyre problemeve dhe çoroditjeve, të cilat shfaqeshin vetiu atëherë për shumëkënd. Ky libër mori para syve të mi përmasat e një fakti, që mund t'i përgjigjej për ne Europës, atij fakti të kërkuar, me të cilin do të mund t'i tërhiqnim vëmendjen Europës. Kuptohet, t'i bërtasim duke qeshur, se kjo s'është veçse letërsi, një aksh roman, se është qesharake ta teprosh dhe me një roman të dalësh në Europë. E di që do të nisin të bërtasin dhe të qeshin, por mos u shqetësoni, nuk po e teproj dhe po e shoh esëll: e di edhe vetë, hëpërhë është veçse një roman, që kjo është veçse një pikë e asaj që duhet, por kryesorja këtu për mua, kjo pikë tashmë është, na është dhënë, ekziston vërtet, përnjëmend, dhe për këtë arsye, në qoftë se ajo ekziston tashmë, në qoftë se gjeniu rus mundi të lindte këtë fakt, atëherë kjo do të thotë se është i fuqishëm, mund të krijojë, mund të japë *të tijën*, mund të fillojë fjalën *e vet* vetjake dhe ta shpjerë deri në fund, kur të vijnë kohërat dhe stinët. Përveç kësaj, kjo është ku e ku më tepër se vetëm një pikë. Oh, as këtu nuk po e teproj: e di fare mirë që jo vetëm te ndonjë anëtar i kësaj plejade, por edhe në të gjithë plejadën nuk do të gjeni, le të flasim pa doreza, atë çka quhet forcë gjeniale, krijuese. Gjeni të padiskutueshëm, me "fjalë të re" të padiskutueshme në krejt letërsinë tonë, kanë qenë vetëm tre: Lomonosovi, Pushkini dhe pjesërisht Gogoli[3]. E gjithë kjo plejadë (dhe autori i "Ana Kareninës", po ashtu) doli drejt e nga Pushkini, një nga njerëzit më madhështorë rusë, por ende i pakuptuar dhe i pashpjeguar. Te Pushkini kemi dy mendime kryesore – dhe të dyja përmbajnë në vetvete prototipin e gjithë rolit të ardhshëm të Rusisë dhe gjithë qëllimit të ardhshëm të Rusisë, mbase dhe krejt fatit tonë të ardhshëm. Mendimi i parë: *përbotshmëria* e Rusisë, përgjegjshmëria e saj dhe afria e vërtetë, e padiskutueshme dhe e thellë, e gjeniut të saj me gjenitë e të gjitha kohërave dhe popujve të botës. Ky mendim është shprehur prej Pushkinit jo si një udhëzim, mësim apo teori, jo si një ëndërrim apo profeci, por është i realizuar *prej tij me vepra*, i fiksuar përjetësisht në krijimet e tij origjinale dhe i dëshmuar prej tyre. Ai është njeri i botës së lashtë, ai është edhe gjerman, ai është edhe anglez, që e ndien thellësisht gjeninë e tij, nostalgjinë e shpresës të tij ("Gosti në kohët e kolerës"), ai është edhe poet i Lindjes[4]. Gjithë këtyre popujve ai u tregoi dhe u deklaroi se gjeniu rus i njeh ata, i ka kuptuar, i ka takuar si farefis i tyre, që ai mund të *rimishërohet* në ta me gjithë plotërinë, se vetëm shpirtit rus i është dhënë kjo përbotshmëri, i është dhënë përcaktimi në të ardhmen për të arritur dhe për të bashkuar gjithë dallimet e kombësive dhe t'ua heqë atyre kundërshtitë. Mendimi tjetër i Pushkinit është kthimi i tij te populli dhe shpresa unikalisht te forca e tij, amaneti i tij, se vetëm në popull dhe vetëm në popull do ta gjejmë pacenueshëm gjithë gjeniun tonë rus dhe vetëdijen e rolit të tij. Dhe këtë, po ashtu, Pushkini jo vetëm e udhëzoi, por ishte i pari që e kreu në të vërtetë. Vetëm prej tij ka nisur te ne kthesa e vetëdijshme te populli, e pamendueshme para tij me vetë reformat e Pjetrit. E gjithë plejada jonë e tanishme ka punuar vetëm sipas udhëzimeve të tij[5], *asgjë të re* nuk ka thënë pas Pushkinit. Të gjitha zanafillat ishin tek ai, udhëzuar prej tij. Por ama ajo e ka përpunuar vetë një pjesë të vogël të udhëzimeve të tij. Megjithatë, ajo çfarë kanë bërë është përpunuar prej tyre me të tillë pasuri forcash, me të tillë thellësi dhe qartësi, sa Pushkini, natyrisht, do t'i pranonte. "Ana Karenina", natyrisht, nuk është diçka e re për nga idetë, nuk është e padëgjuar deri më tani te ne. Në vend të saj, natyrisht, mund ta çonim Europën drejt e te burimi, që do të thotë te vetë Pushkini si dëshmia më e qartë, më solide dhe më e padiskutueshme e pavarësisë së gjeniut rus dhe e së drejtës së tij që në të ardhmen të ketë rëndësinë më të madhe botërore, gjithënjerëzore dhe gjithëbashkuese. (Eh, sado t'u tregojmë ne atyre, për një kohë të gjatë tanët nuk kanë për t'i lexuar në Europë, por edhe nëse do të nisin t'i lexojnë, për një kohë të gjatë nuk kanë për t'i kuptuar apo për t'i vlerësuar. Por edhe për t'i vlerësuar jo se nuk munden, jo se u mungojnë aftësitë, por sepse për ata ne jemi një botë krejt tjetër, thua se kemi ardhur nga hëna, kështu që edhe ekzistencën tonë e kanë vështirë ta pranojnë. I di të gjitha këto dhe kur flas për "aludimin për Europën", këtë e bëj vetëm në kuptimin e bindjes sonë në të drejtën tonë para Europës për pavarësinë tonë.) Aq më tepër që "Ana Karenina" është përkryerje si vepër arti, që pikërisht në kohën e duhur na thotë se asgjë nga letërsitë europiane të kohës sonë nuk ka të ngjarë që mund të krahasohet me të, dhe së dyti, edhe për nga idetë është diçka jona tashmë, e gjakut tonë dhe pikërisht ajo që

përbën të veçantën tonë përballë botës europiane, që përbën tashmë "fjalën e re" kombëtare ose, të paktën, fillesën e saj – të tillë fjalë e cila pikërisht nuk dëgjohet në Europë dhe e cila është kaq e domosdoshme për të, pa marrë parasysh gjithë krenarinë e saj. Nuk po filloj të bëj kritikë letrare dhe po them vetëm një fjalë të shkurtër: "Tek 'Ana Karenina' nxirret në pah faji dhe krimi njerëzor. Njerëzit shfaqen në kushte jonormale. E keqja ekziston përpara tyre. Të përfshirë nga qerthulli i gënjeshtrës, njerëzit kryejnë krime dhe shkatërrohen pashmangshëm; siç duket, një mendim nga temat më të dashura dhe më të hershme europiane. Por, megjithatë, si zgjidhet ky problem në Europë? Gjithkund atje zgjidhet në dy mënyra. Zgjidhja e parë: ligji është i dhënë, i shkruar, i formuluar, i hartuar në mijëvjeçarë. E keqja dhe e mira është përcaktuar, peshuar, përmasat dhe shkallët janë përcaktuar historikisht nga të urtët e njerëzimit, me një punë të palodhur mbi shpirtin njerëzor dhe përpunimin e lartë shkencor mbi shkallën e forcës njëjtësuese të njerëzimit në bashkësi. Urdhërohen ta ndjekim verbërisht këtë kod të përpunuar. Kush nuk e ndjek, kush e shkel atë, e paguan me liri, pasuri, jetë, e paguan deri më një e çnjerëzisht. Unë e di, - thotë vetë qytetërimi i tyre, - që kjo është dhe verbëri, dhe çnjerëzore, dhe e pamundur, meqenëse është e pamundur që të përpunosh një formulë përfundimtare të njerëzimit në mes të rrugës së tij, por meqenëse mënyrë tjetër nuk ka, i duhet përmbajtur asaj që është shkruar dhe t'i mbahesh germë për germë dhe panjerëzishëm; në mos qoftë kjo, do të jetë edhe më keq. Me gjithë jonormalitetin dhe absurditetin e organizimit të atij që ne e quajmë civilizimin tonë të madh europian, aq më pak le të jenë shëndoshë e mirë forcat e shpirtit njerëzor, le të lëkundet besimi në shoqëri, që ajo po shkon drejt përsosjes, le të mos guxojë të mendojë që ideali i së bukurës dhe sublimes është zvetënuar, që po shtrembërohet dhe shkatërrohet koncepti i së mirës dhe së keqes, që normaliteti këmbehet pandërprerë me rregulla të ngurta. Që thjeshtësia dhe natyrshmëria zhduken, të mbytura nga gënjeshtra që zmadhohet pandërprerë!"

Zgjidhja tjetër është e kundërta: "Meqenëse shoqëria është organizuar anormalisht, atëherë është e pamundur të marrësh përgjigje nga njësi njerëzore për pasojat. Nga kjo del, krimineli është i papërgjegjshëm, dhe krimi sikur nuk ekziston. Që t'u japësh fund krimeve dhe fajësisë njerëzore, duhet t'i jepet fund anormalitetit të shoqërisë dhe mënyrës se si është organizuar ajo. Të shërosh rendin ekzistues të gjërave kërkon kohë, por nuk ka shpresë, as ilaçe gjenden, atëherë i bie të shkatërrosh gjithë shoqërinë dhe të zhdukësh rendin e vjetër si me fshesë. Pastaj të nisësh gjithçka të re, në fillesa të tjera, ende të panjohura, që gjithsesi nuk mund të jenë më keq se rendi i tanishëm, përkundrazi, ngërthen në vetvete shanse të tjera suksesi. Shpresa kryesore te shkenca." Dhe ja, zgjidhja e dytë: presin mizërinë e ardhshme të

turmave, ndërkohë mbulojnë botën me gjak. Zgjidhje të tjera për fajësinë dhe kriminalitetin e botës njerëzore europianoperëndimore nuk shfaqen.

Po ashtu në vështrimin e autorit rus të fajësisë dhe krimit të njerëzve shihet që asnjë mizëri, asnjë triumf i "shtresës së katërt", kurrfarë zhdukjeje varfërie, asnjë organizim i punës nuk do ta shpëtojë njerëzimin nga anormaliteti dhe si rrjedhojë, nga faji apo krimi. Është shprehur kjo në përpunimin e fortë psikologjik të shpirtit njerëzor, me thellësi dhe forcë të tmerrshme, me realizimin e paraqitjes artistike si kurrë më parë te ne. Qartësisht dhe kuptueshëm deri në tejdukshmëri, se e keqja fshihet më thellë se hamendësojnë shëronjësit socialistë, se në asnjë organizim të shoqërisë nuk i shmangesh së keqes, që shpirti njerëzor mbetet po ai, se anormaliteti dhe mëkati burojnë prej atij vetë, se, më në fund, ligjet e shpirtit njerëzor ende janë kaq të panjohura, kaq të pastudiuara prej shkencës, kaq të papërcaktuara dhe kaq misterioze, se nuk ka dhe nuk mund të ketë ende as shëronjës, madje nuk mund të ketë edhe gjyqe *të fundit*, por është Ai, i cili thotë: "Për mua shpagimi dhe unë do të shpaguaj." Vetëm Ai e di *gjithë* misterin e kësaj bote dhe fatin përfundimtar të njeriut. Njeriu hëpërhë nuk mund të zgjidhë asgjë me krenarinë e pagabueshmërisë së tij, ende nuk ka ardhur koha dhe ora. Vetë gjyqtari njeri duhet të dijë për veten, që ai nuk është gjyqtari përfundimtar, që ai vetë është mëkatar, që peshorja dhe masa në duart e tij do të jenë një absurditet, në qoftë se ai vetë, ndërkohë që mban në duar peshoren dhe masën, nuk gjunjëzohet para ligjit ende të pazgjidhur të misterit dhe nuk vrapon tek e vetmja dalje – Mëshira dhe Dashuria. Dhe që të mos bjerë në dëshpërim nga moskuptimi i rrugëve dhe fateve të tij, nga bindja në pashmangshmërinë misterioze dhe fatale të së keqes, pikërisht njeriut i tregohet rrugëdalja. Kjo është e shënuar në mënyrë gjeniale nga poeti në një skenë gjeniale në pjesën e parafundit, në skenën ku heroina e romanit është shtrirë e sëmurë për vdekje, kur kriminelët dhe armiqtë befas shndërrohen në qenie sublime, në vëllezër që falin njëri-tjetrin, në qenie të cilat me këtë falje reciproke heqin nga vetja gënjeshtrën, fajin dhe krimin, dhe ndërkaq edhe një herë justifikojnë veten me vetëdijen e plotë se e kishin këtë të drejtë. Por pastaj, në fund të romanit, në tablonë e zymtë dhe të tmerrshme të rënies së shpirtit njerëzor[6], të ndjekur hap pas hapi, në paraqitjen e asaj gjendjeje të tmerrshme, kur e keqja, pasi ka zotëruar qenien e njeriut, ngrin çdo lëvizje të tij, paralizon çdo forcë kundërshtimi, çdo mendim, çdo dëshirë për luftë me errësirën që i bie në shpirt dhe me vetëdije, me parapëlqim, me pasionin e shpagimit të pranuar prej shpirtit në vend të dritës – në këtë tablo – ka kaq këshilla për gjyqtarin njeri, për të mbajtur masën dhe peshoren, që, natyrisht, ai klith, i trembur dhe i çoroditur: "Jo, jo kurdoherë shpagimi më përket mua dhe jo kurdoherë unë do të shpaguhem", dhe të mos e akuzojë çnjerëzisht kriminelin e zhytur në errësirë, pse ai shpërfilli daljen e treguar mot e jetë me dritë dhe tashmë *me vetëdije* nuk e ka pranuar.

Nëse kemi vepra letrare të kësaj force mendimi dhe këtij realizimi, atëherë përse të mos kemi si rrjedhojë edhe shkencën *tonë* dhe zgjidhjet tona ekonomike, sociale, përse nuk na e njeh Europa pavarësinë, në fjalën *tonë vetjake*, ja një pyetje që lind vetiu. E pamundur të mos hamendësosh mendimin qesharak, që natyra na paska pajisur vetëm me aftësi letrare. E gjithë tjetra është çështje historie, rrethane, kushtëzim kohe. Kështu do të duhej të kishin arsyetuar, të paktën, europianët tanë, derisa të arsyetojnë europianët europianë...

1. Bëhet fjalë për shkrimtarin I. A. Gonçarov, me të cilin, në vitet shtatëdhjetë të shek. XIX, Dostojevski takohej rrallë por përzemërsisht.
2. Në thelb, një mendim të tillë, analog me të Gonçarovit, për romanin e Tolstoit e kishte shprehur disa kohë më parë A. S. Suvorin, në artikullin e tij (""Ana Karenina" dhe rëndësia e saj shoqërore": "Nga ne, pleqtë, vetëm një Tolsto ende mund të shkruajë" – më tha një ditë njëri nga shkrimtarët më të talentuar rusë, i cili padrejtësisht po e varros veten kaq herët" (Novoe vremja, 1877, 13 (25) maj, Nr. 432)
3. Diçka të ngjashme, por në lidhje me "Lufta dhe paqja", Dostojevski i pohonte në një letër N. N. Strahovit (24 mars (5 prill) 1870): "... Ju shpreheni, që Tolstoi është i barabartë me të gjithë ata që quhen letërsia jonë e madhe. Kjo nuk mund të thuhet assesi! Pushkini, Lomonosovi janë gjeni. Të dalësh me "Arapin e Pjetrit të Madh" dhe me Bjelkinin, do të thotë, padiskutim të dalësh me fjalën e re gjeniale, e cila deri në atë kohë nuk gjendej askund dhe nuk ishte thënë kurrë. Ndërsa të shfaqesh me "Lufta dhe paqja", do të thotë, të shfaqesh pas kësaj fjale të re, të thënë nga Pushkini tashmë dhe kjo në çdo rast, sado larg dhe lart të shkojë Tolstoi në zhvillimin e asaj që është thënë për të parën herë, përpara tij, nga gjeniu i fjalës së re."
4. Kjo karakteristikë e Pushkinit rrjedh pjesërisht nga fjalët e Gogolit, i cili ka shkruar për poezinë e Pushkinit në artikullin "Ku është në fund të fundit thelbi i poezisë ruse..." ""Në Spanjë ai është spanjoll, me grekun-grek, në Kaukaz-një malësor i lirë, në kuptimin më të plotë kësaj fjale..."
5. Nënkuptohet, pasuesit e Pushkinit dhe vazhduesit e çështjes së tij: Turgeniev, Gonçarov, Ostrovskij, Tolstoi dhe Nekrasov.
6. Bëhet fjalë për "përfundimin", do me thënë "pajtimin" e Kareninit me Vronskin te krevati i Anës së sëmurë, që ndodh në pjesën e katërt të romanit "Ana Karenina"



Tharja e kënetës së Maliqit

dhe ndërtimi i regjimit komunist në periferi të Shqipërisë

Artan R. Hoxha

Onufri